UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 10 PRILL 2003

T R A N S K R I P T

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE 10. 04. 2003. GOD.

PRILL - APRIL
2003

Verzioni angleze me mbizotru
Engleska verzija
preovladava
English version prevails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i proçesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Shqyrtimi i Raportit për përsonat e humbur dhe të kindapuar
3. Shqyrtimi i Raportit për gjendjen në gjyqësin e Kosovës
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Koperativat bujqësore
5. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e disa anëtarëve të Komisioneve parlamentare
6. Mendimi i komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me mocionin e deputetit Arsim Bajrami
7. Parashtrimi i pyetjeve
8. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 17 Prill 2003:
   - 8.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lëndën arkivore dhe arkivat
   - 8.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtëshme në Kosovë (2002/3)

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

"Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtresa të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to ".
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

Verzioni anglez me mbizotru
Engleska verzija
preovladava
English version prevails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице
2. Разматрање препоруке за отета и нестала лица
3. Разматрање извештаја о стању правосуђа на Косову
4. Прво разматрање Нацрт закона о пољопривредним Кооперативама
5. Разматрање предлога о именовању појединих чланова Скупштинских комисија
6. Мишљење комисије питања правосуђа, законодавства и Уставног оквира, У вези са предлогом посланика Арсим Бајрами
7. Постављање питања
8. Предлог дневног реда за пленарну седницу 17 Априла 2003:
   - 8.1 Друго разматрање Нацрт закона о архивској грађи и архивама
   - 8.2 Друго разматрање Нацрт закона за успостављање Пореза на Непокретну имовину на Косову (2003/3)

Опомена : *Питања упућена Влади за усмене одговоре*

"Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се очекује одговор" (Правило 21.2 са Привремени пословник)

Verzioni angleze me mbizotru
Engleska verzija
preovladava
English version prevails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting
2. Review on the report of missing and kidnapped persons
3. Review of the Report regarding Kosovo's judicial system
4. First reading of the Draft Law on Agricultural cooperatives
5. Review on the proposal regarding the nomination of some members in the parliamentary comities
6. Opinion of the committee on judicial, legislation and Constitutional Framework concerned on the motion of the deputy Arsim Bajrami
7. Questions
8. Proposal for agenda of 17 April 2003 for Plenary Meeting:
   - 8.1 Second reading of the Draft Law on Archiving Subject and Archives
   - 8.2 Second reading of the Draft Law on Impose of the Tax on Immovable Property in Kosovo (2003/3)

Note: *Questions to the Government for oral answer*

"Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered" (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

T R AN S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË

Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI, KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.

BASHKËKRYESUES XHAVIT HALITI, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes, kolegë deputetë. Mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt plenare.

Lus deputetët e "Povratak-ut" që të ulen në vendin e vet dhe të mos humbim kohë e të fillojmë.

Materialet e nevojshme për këtë seancë plenare janë shpërndarë me kohë. Bile disa veprime janë bërë, siç e ka zakon zoti Hydajet Hyseni, me shpejtësi turbo, megjithatë janë në Parlament.

Unë do të doja të ju lus për një mirëkuptim lidhur me ndryshim të vendit të pikave të rendit të ditës dhe t'ju informoj se pika e katërtë nuk mund të shqyrtohet fare: **Shqyrtimi i parë i Projektligjti për kooperativat bujqësore** sepse sponzori i këtij Ligji nuk është i pranishëm në sallë. Mungon ministri i bujqësisë dhe i pylltarisë dhe ne këtë do ta bëjmë në një moment kur të jetë i pranishëm ministri Bogdanoviq a s'di si quhet.

Do t'ju lutja pra edhe për një ndryshim të rendit të ditës dhe si pikë e parë e rendit të ditës për shqyrtim të jetë: **Shqyrtimi i Raportit për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës, sepse zoti Kadi,** zëvendës... është i limitizuar në kohë. Është pikë shumë e rëndësishme e rendit të ditës, prandaj besoj se kam pëlqimindhe mirëkuptimin për këtë dhe pastaj vazhdojmë me

pikat tjera të rendit të ditës. Mendoj se s'kemi nevojë të deklarohemi, sepse të gjithë e miratojmë këtë propozim.

Prandaj, hap debatin mbi **Shqyrtimin e Raportit mbi gjendjen në gjyqësinë e Kosovës.**

Më parë të theksoj se për Procesverbalin e seancës së kaluar, le të shkojë ashtu siç jemi marrë vesh, kurse ata që kanë vërejtje në Procesverbal, t'i bëjnë ato me shkrim dhe të plotësohen për të gjitha pikat.

Fjalën hyrëse lidhur me Raportin do ta paraqesë zonja Kelmendi, apo zoti Arsim Bajrami, kryetar i Komisionit.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuar kryetar, të nderuar kolegë,

Pika të cilën sot po e diskutojmë është ndër pikat ndoshta më të rëndësishmet që nga fillimi i punës së këtij Kuvendi. Ne javën e kaluar kishim debatin për punën e Qeverisë së Kosovës, sot po diskutojmë punën e gjyqësisë apo gjendjen e gjyqësisë në Kosovë që është një nga debatet, po them edhe një herë, ndër më të rëndësishmet. Aq më parë kur, nëse mund të flasim deridiku për një funksionim të pushtetit ligjdhënës dhe atij ekzekutiv, është shumë e diskutueshme sa mund të flasim për funksionimin e pavarur të sistemit të gjyqësisë.

Sistemi aktual i gjyqësisë është i përcjellur me shumë kundërthënie juridike dhe kundërthënie faktike të cilat e vënë në pyetje ka apo nuk ka në Kosovë një sistem të një gjyqësie të pavarur. Aq më parë kur nuk mund të themi akoma se ka filluar të funksionojë një sistem i gjyqësisë në shërbim të shtetit të së drejtës dhe në shërbim të mbrojtjes së lirive dhe të të drejtave të njeriut.

Në diskutimin tim, unë do të përgëzoj Grupin punues që ka hartuar një raport shumë të plotë, dokumentar po ashtu, përgëzoj edhe Ministrinë e Shërbimeve Publike që na ka dhënë mjaft fakte për gjendjen në sistemin e gjyqësisë. Do të ndalem në dy pjesë në diskutimin tim dhe fillimisht do të përmendim problemet kryesore që mendoj se janë karakteristike për gjendjen e gjyqësisë sot në Kosovë dhe në fund do të propozoj masat që duhet ndërmarrë në të ardhmen institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, Parlamenti dhe Qeveria në mënyrë që të avancohet dhe të fillojë ndërtimi i një koncepti të gjyqësisë së pavarur.

Do të veçoja pesë probleme akute apo aktuale me të cilat ndeshet sistemi i gjyqësisë në Kosovë.

Mendoj se problemi i parë dhe ndër themelorët, është mungesa e ligjeve të Kosovës me të cilat do të punonin gjyqet e Kosovës.

Fatkeqësisht gjykatat e Kosovës, sistemi gjyqësor në Kosovë, nuk po vepron me ligjet e Kosovës, me ligjet e reja, me ligjet demokratike, me ligje do të thoja edhe evropiane, çfarë po ndërton dhe çfarë po prodhon Parlamenti i Kosovës. Ndoshta faktor për këtë është i ashtuquajturi ligj i aplikueshëm, i cili është përcaktuar menjëherë pas luftës në mungesë të vakumit juridik. Në aspektin juridik, vazhdimi i aplikimit të ligjit të aplikueshëm, paraqet një absurd dhe anakronizëm juridik, për shkak se në Kosovë po vazhdojnë të aplikohen ligjet e shtetit, i cili edhe juridikisht por edhe faktikisht, është shprbërë, që paraqet një absurd juridik dhe të panjohur në praktikën ndërkombëtare. Ndërkaq, për shkak të ngadalësisë së procesit ligjdhënës në këtë Parlament, për...

(Ndërhym kryesuesi: Arsim, më ngadalë për shkak të përkthimit, të lutem. Është me rëndësi).

shkak të ngadalësisë së menaxhimit të kompetencave që janë përcaktuar me Kornizën kushtetuese, ne nuk kemi mundur me shpejtësinë e dëshiruar të krijojmë sistemin juridik në mënyrë që gjykatave tona t'u mundësojmë që ato të punojnë në bazë të ligjeve të Kosovës.

Po të krahasosh praktikat ndërkombëtare gjyqësore, do të mund të konkludoja se gati askund nuk është më vështirë të jeshë gjykatës se sa në Kosovë. Për shkak se gjykatësi ynë sfidohet me atë se cilin ligj duhet ta zbatojë dhe gjykatësit tanë vendimet dhe aktgjykimet i mbështesin në referencën – në emër të popullit. Shtrohet pyetja – këto ligje që tani zbatohen, që janë të zbatueshme, a janë ligje që kanë legjitimitetin e popullit të Kosovës dhe legjitimitetin e këtij Kuvendi? Mendoj se ka ardhur koha që këtu të bëhet një kthesë dhe ne definitivisht të kërkojmë nga Përfaqësuesi Special që të ndërrojë ligjin e aplikueshëm dhe gjykatat e prokuroritë tona të fillojnë të punojnë ekskluzivisht në bazë të ligjeve që miraton ky Kuvend dhe do të thoja përkohësisht edhe në bazë të legjislacionit ndërkombëtar, derisa ne ta krijojmë legjislacionin plotësisht tonin.

Mendoj se problemi i dytë, me të cilin sot po ballafaqohet sistemi i gjyqësisë në Kosovë, është politika kadrovike. Pra, kush është bartës i funksioneve gjyqësore?! Fatkeqësisht, këtu kemi mjaft fërkime, ka pasur edhe ky Parlament fërkime me Përfaqësuesin Special, për shkak se ky Parlament dëshiron që të ka të drejtë dhe dëshiron që të ketë një qasje më të madhe në zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët janë edhe përfaqësues të popullit.

Ju i dini fërkimet që kemi patur. Në fakt, ne nuk kemi arritur që në sistemin e gjyqësisë të zgjedhim njerëz të ri, të edukuar në frymën e konceptit të zbatimit të ligjit, në frymën e sundimit të ligjit. Sot sistemi i gjyqësisë në Kosovë, kryesisht mbulohet me kuadra të para viteve të 90-ta edhe pse ne pas viteve të 90-ta kemi mjaft juristë të përgatitur, juristë të përgatitur me një legjislacion të ri, pra jo me një legjislacion të vjetër dhe në këtë drejtim nuk ia kemi arritur që të freskojmë gjyqësinë me kuadro të reja. Bile, për aq më tepër, ka pasur edhe raste eklatante dhe ekstreme kur Përfaqësuesi Special ka zgjedhur gjyqtarë dhe prokurorë që drejtpërdrejtë ka qenë i involvuar në praktikat diskriminuese, përkundër faktit se ky Parlament dhe mekanizmat e tij punues kanë kundërshtuar një procedurë të tillë.

Problemi i tretë, është dilema se a kemi apo s'kemi sot gjyqësi të pavarur. Ajo që po atribon shtetet e transicionit, ajo që po sfidon shtetet poskomuniste, është ndërtimi i një sistemi të gjyqësisë së pavarur, një gjyqësie që do të jetë në shërbim të popullit dhe në shërbim të ligjit dhe jo në shërbim të politikave të caktuara.

Fatkeqësisht, akoma nuk mund të flasim për një gjyqësi të pavarur në Kosovë. Do të thoja, gjyqësia akoma vazhdon recidivat e sistemeve moniste dhe akoma vazhdon të ndikohet politikisht me mekanizmat e kontrollit politik. Fillimisht kontrollin e parë politik mbi gjyqësinë në Kosovë po e ushtron UNMMIK-u, i cili edhe po dikton zgjidhjet kadrovike në gjyqësinë e Kosovës. Pastaj, mendoj se akoma kemi elemente të ndikimeve politike.

Kosova ka nevojë për gjyqësi plotësisht të paanshme dhe të pavarur në raport me ekzekutivin dhe legjislativin por në raport edhe me ndikimet politike.

Fatkeqësisht kemi pasur edhe raste ekstreme të shkeljes së pavarësisë së gjyqësisë. Ju kujtohen rastet e ashtuquajtura - urdhëra administrativ që ceken edhe në Raportin e Grupit punues. Praktika që nuk janë të njohura në shtetet demokratike?! Kemi pasur raste eklatante kur gjykatat me vendim të formës së prerë kanë pruar një vendim gjyqësor, pra e kanë gjykuar një çështje që ne juristët e quajmë çështje res judikata, por ka pasur ndërhyrje administrative ekzekutive që nuk është tipar i shteteve demokratike dhe i sistemeve çfrarë duhet. Kështu që, mendoj se një nga sfidat me të cilat do të ballafaqohen institucionet e Kosovës janë që vërtetë të hartojnë një vizion të kjartë se çfarë gjyqësie i duhet Kosovës.Ajo që atribon shtetin e Kosovës është gjyqësia e paanshme, gjyqësia që do t'i bindet vetëm ligjit, vetëm lirive e të drejtave të njeriut dhe vetëm standardeve ndërkombëtare.

Mendoj se një dukuri tjetër, që duhet të veçohet, e që nuk thuhet shprehimisht por që është prezente në veprimin dhe funksionimin e gjyqësisë në Kosovë në të gjitha segmentet.Kur them gjyqësisë, gjithmonë duhet t'i kuptoni të gjitha segmentet e gjyqësisë, pra edhe prokuroritë edhe sistemin e gjykatave të rregullta. Është edhe një politikë që po ndiqet, që nuk thuhet shprehimisht politikë e vendosjes së një balanci, balanci midis atyre që kanë bërë këtu krime dhe gjenocid dhe atyre që kanë qenë viktimë. Edhe pse kjo shprehimisht nuk thuhet askund, po ta analizoni gjendjen e të burgosurve, gjendjen e të akuzuarve, nxirret konkludim se megjithatë kemi elemente të një politike të tillë, pra të vendosjes së balancave dhe ekuilibreve midis viktimës së gjenocidit e terrorit dhe atyre që kanë bërë këtu gjenocid dhe terror.

Dhe, çështja e katërtë, që është aktuale dhe që pengon Kosovën ta ketë një gjyqësi çfarë i duhet, padyshim është gjendja materiale dhe kadrovike e gjyqësisë. Ju në Raportin që ka hartuar Grupi punues do të shifni se me çfarë probleme materiale dhe kadrovike ballafaqohet gjyqësia. Akoma sistemi i gjyqësisë nuk është mbushë me kuadro të nevojshme. Gjendja materiale, po ashtu, është e disfavorshme. Gjyqtarët tanë marrin paga të ulëta, kanë problemin e sigurisë, kanë edhe probleme tjera dhe, në këtë drejtim, ky Kuvend dhe ne, duhet seriozisht t'i qasemi, në qoftë se kërkojmë një gjyqësi të pavarur, sigurimit të një bazë materiale.

Duke qenë se gjyqësia ballafaqohet me këto probleme, mendoj se është e domosdoshme që Kuvendi në hap me kohën të merret me çështjen e gjyqësisë për shkak se ai ka të drejtë këtë ta bëjë edhe në frymën e Kornizës kushtetuese, në frymën e Kreut 5, pika 3, sepse atyre institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes iu njihen mjaft kompetenca, të cilat fatkeqësisht nuk janë ushtruar. Pra, "jo kompetencat... jo duhet të transferohen" por në fakt kompetencat duhet të ushtrohen. Ato janë transferuar në momentin kur ne kemi filluar me punuar me Kornizë kushtetuese dhe mendoj se është plotësisht qasje e gabuar që UNMIK-u neve këto të na i prezentojë si kompetenca të transferuara. Është fjala për kompetencat që janë vonuar në të ushtruar. Transferimi i kompetencave duhet të bëhet në çështje tjera dhe në segmente tjera të sistemit të gjyqësisë.

Mendoj se ka disa hapa që duhet të ndërmerrë UNMIK-u, Qeveria e Kosovës dhe Parlamenti i Kosovës për të përshpejtuar dhe për të përmirësuar këtë gjendje jo të favorshme në sistemin e gjyqësisë.

Unë do të veçoja katër çështje më të rëndësishme dhe besoj se në diskutimet që do të pasojnë do të ketë propozime tjera.

Natyrisht, sfida e parë jona dhe e UNMIK-ut, është që të krijojmë legjislacionin vendor. Do të thoja – legjislacionin e Kosovës. Është shumë inkurajues fakti që ne, pas dy jave, apo pas një jave, do të fillojmë debatin për kodin penal, kodin e procedurës penale dhe ligjet tjera që janë përgatitur. Kjo është shumë inkurajuese edhe pse e vonuar. Ne duhet të kërkojmë, si Parlament, që sa më shpejt të nxirren ligjet sistemore, ligjet materiale dhe procedurale që do t'u mundësojnë gjykatësve dhe prokurorëve tanë që t'i zbatojnë ligjet e Kosovës. Të ndërpritet praktika anakronike juridike që një shtet të zbatojë ligjet e një shteti që nuk ekziston, pra,ligjet e ish republikës socialiste federative të jugosllavisë. Fatkeqësisht, këto ligje me të madhe po zbatohen në Kosovë. Dhe, fatkeqësisht gjyqtarët tanë çdo ditë ndeshen me këto ligje. Ata bëjnë një eksivim juridik, duke mos i përmendur recidivisht por duke u thirrur në të ashtuquajturin ligj aplikativ. Ka ardhur koha që këtu të bëhet një reformë dhe këtu të bëhet një transfer substancial i kompetencave që ky legjislacion të pushojë së vepruari dhe Kuvendi i Kosovës, në bashkëpunim me Përfaqësuesin Special, ta mbushë këtë vakum juridik dhe gjyqet tona të punojnë me ligje tona.

Propozoj që pas miratimit të këtyre dy kodeve, që do t'i kemi shumë shpejt në procedurë, Kuvendi i Kosovës, në bashkëpunim me mekanizmat e vet të fillojë të përgatisë legjislacionin civil dhe legjislacionin për pronësinë në mënyrë që të sigurojmë bazën e plotë juridike me të cilat gjyqet tona do të punojnë.

Mendoj se kjo është detyrë jona. Kemi mjaft ekspertë që janë të përgatitur dhe ne duhet t'i hapim dyert për ekspertë. Kam nganjëherë përshtypje se nuk jemi sa duhet të hapur për ekspertë, meqenëse ekspertët tanë më lehtë po i merr UNMIK-u se sa ne. Ata janë të disponuar me ardhë te ne, por më duket se s'kemi qenë aq të hapur me ofertat tona, jo vetëm si Kuvend, por mendoj edhe si Qeveri.

Çështja e dytë. Me qëllim që të përshpejtohet ndërtimi i gjyqësisë së pavarur dhe të avancohet koncepti i ndërtimit të shtetit të së drejtës, është i domosdoshëm në këtë fazë – jo

më vonë, të bëhet transferi substancial i përgjegjësive në sferën e gjyqësisë. Ka ardhur koha që Kosova të ketë një autoritet ekzekutiv, i cili do të menaxhonte sistemin e gjyqësisë së Kosovës, pra të formohet ministria e drejtësisë si një autoritet ekzekutiv. Mendoj se kjo është plotësisht e mundshme dhe kjo nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244, as me Kornizën kushtetuese, për shkak se këto dy akte obligojnë Përfaqësuesin Special dhe UNMIK-un që ta përgatisin Kosovën në pikëpamje institucionale për fazën e tretë të zbatimit të Rezolutës 1244, pra për zgjidhjen e statusit final të Kosovës.

Vlerësoj se deri në fund të vitit Kosova duhet të themelojë ministrinë e drejtësisë dhe të marrë kompetnecat e plota në këtë sferë.

Pika e tretë. Ne kemi trashëguar një sistem ekzistues të gjyqësisë. Pra, sistemi që ka qenë para rrënimit kundërkushtetues të pozitës së Kosovës. Kemi ato gjykata që kemi pasur në periudhën 1974-1990, kur është rrënuar në mënyrë kundërkushtetuese pozita e Kosovës, e garantuar atëherë me legjislacionin në fuqi. Për këto dhjetë vitet e fundit, sidomos pas hyrjes së UNMIK-ut, nuk kemi debat se a është ky sistem i gjyqësisë çfarë e kemi sot funksional. A është kompatibil me shtetet demokratike?! Unë mendoj se duhet të bëjmë korreksione në sistemin e gjyqësisë. Megjithatë, ky sistem është një sistem tipik socialist që e kemi trashëguar dhe ne duhet të marrim modele të shteteve në transicion, sidomos modelin kroat, slloven dhe modelin e Shqipërisë, që është një model shumë i avancuar në mënyrë që të kemi një sistem funksional të gjyqësisë, do të thoja, të kemi gjyqësi në dy instanca. Në këtë drejtim, duhet të fillojnë menjëherë përgatitjet për hartimin e ligjit për sistemin e gjykatave të rregullta.

Çështja e katërtë. Çështja e katërtë ka të bëjë me gjykatën kushtetuese të Kosovës dhe me problemet që veç janë paraqitur në Kosovë rreth kësaj gjykate. Siç e dini Kosova nuk ka një gjykatë kushtetuese. Padrejtësisht, nuk ka! Edhe pse kishte edhe në kohën kur s'ishte shtet. Kishte prej periudhës 69 deri 90. Ne kemi probleme. Ne kanë filluar të na arrijnë lëndët që kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Ne kemi një kolegj, pranë Gjykatës Supreme, i cili nuk po mund të punojë për shkak se nuk është themeluar. Ai, është paraparë me Kornizën Kushtetuese si kolegj për mbrojtjen e Kornizës Kushtetuese, por nuk është themeluar. Kolegji nuk është organ gjyqësor. Juristët duhet ta dijnë, është më tepër një organ konstitucional i cili merret me rastet specifike. Ju e dini se ne kemi disa lëndë te ky kolegj. Unë kam takaur kryetaren e Gjykatës Supreme, por edhe gjyaqtarët e kësaj Gjykate, ata po sfidohen se si të procedojnë, me qenë se nuk ekziston baza juridike në bazë të të cilave do të fillojë procesi i kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Mendoj se në procesin e transferit të përgjegjësive për të cilin shumë po flitet, e pak po kuptohet drejt, duhet të bëhet përpjekje që Kosova ta ketë gjykatën kushtetuese. Ta ketë gjykatën kushtetuese dhe të fillojë edhe ky segment i funksionimit të shtetit.

Dhe, çështja e pestë, që mendoj se mund të jetë një nga rekomandimet që edhe propozohet në Raportin e Grupit punues, është që gjyqësia të fillojë dalëngadalë të pavarësohet, plotësisht nga UNMIK-u, duke u dhënë besim gjyqtarëve vendor. Nuk jemi kundër gjyqtarëve ndërkombëtar, ata janë të mirëpritur me përvojat dhe praktikat e tyre, por duhet të rikthehet besimi i gjyaqtarëve në gjyqësinë e Kosovës dhe duhet të fillojë një proces në të cilin

Kuvendi ka me pasë ndikim më të madh. Me Kornizë Kushtetuese, ky Kuvend dhe ekzekutivi, kanë kompetenca më të mëdha për të ndikuar në zgjedhjen e gjyqtarëve dhe në kualifikimet e tyre. Fatkeqësisht të gjitha këto kompetenca po i ushtron UNMIK-u. Ai po i zgjedh dhe propozon gjyaqtarët, neve vetëm po na i japë për ta bërë aminin. Njëkohsisht ai edhe po i licencon, edhe pse, po ta lexoni me vëmendje Kornizën kushtetuese, do të shifni se këto janë kompetenca plotësisht të institucioneve të Kosovës. Fatkeqësisht ne nuk po jemi të aftë t'i menaxhojmë këto kompetenca dhe pastaj po krijojmë iluzione se diçka po marrim të re, po marrim diçka të re dhe po fitojmë diçka nga UNMIK-u.

Mendoj se kjo problematikë e gjyqësisë, kërkon që Kuvendi i Kosovës, jo vetëm sot, por në proces të merret me çështjen e gjyqësisë dhe krahas pushteteve tjera vërtet të bëjmë përpjekje për ta instaluar sa më shpejt konceptin e shtetit të së drejtës dhe konceptin e një gjyqësie të pavarur. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Për të marrë fjalën në debat, është paraqitur Zylfije Hundozi. Le të bëhet gati ... S'po e shof se je i paraqitur. Mirë, profesor më fal atëherë.

ZYLFIJE HUNDOZI:

Ne si Grup i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, përkrahim rekomandimet e Grupit punues për punën e ardhshme në gjyqësinë e Kosovës. Njëherit desha të shtoj diçka edhe nga profesioni im dhe atë me çka po përballemi përditë ne. Ajo që sot edhe e rëndon sot mjaft situatën në gjyqësinë e Kosovës është edhe mungesa dhe mosdefinimi i qartë i vlerësimit dhe e trajtimit të personave që konsiderohen të papërgjegjshëm në momentin e kryerjes së veprës penale. Për veprat penale të bëra, këta persona trajtohen në klinikën e neuropsikiatrisë, e cila tash është shndërruar në burg. Në këtë klinikë nuk ka kushte as për pacientët, të cilët trajtohen aty dhe vetë prezenca e forcave policore në klinikë dhe përrreth saj zgjon asociacione negative të pacientëve psiqik, përvojat e hidhura dhjetëvjeçare të prezencës së policisë së atëhershme në çdo skutë të këtij vendi. Por, vendqëndrimi i personave të papërgjegjshëm, nuk është i vetmi problem. Nga ana e gjyqit nuk ekziston kërkesë e posaçme që të vlerësohet në mënyrë konziliare gjendja mendore e tyre, por ashtu si i konvenon secilit gjykatës, e gjend psikiatrin me të cilin bashkëpon më së miri dhe kryen punën më lehtë. Kështu është hapur rruga për vlerësime subjektive të situatës dhe gjendjes mendore të kryerësit të veprës penale në momentin e krimit si dhe keqpërdorimi i situatës së krijaur që dëmton gjyqësinë dhe drejtësinë e Kosovës.

Propozimi juaj për krijimin e një institucioni të posaçëm për vlerësimin e gjendjes mendore dhe trajtimin e personave që konsiderohen të papërgjegjshëm është mëse i qëlluar. Mirëpo, për krijimin e një institucioni të tillë do të duhej kohë e gjatë dhe vullnet i madh, kështu që gjer në realizimin e kësaj ideje, propozoj që çështja e trajtimit dhe vlerësimit se a kemi të bëjmë me persona të papërgjegjshëm apo jo, të hyjmë në rekomandimin e këtij Raporti, e kjo është - urgjentisht të ndërrohet mënyra e qasjes ndaj këtyre personave, duke kërkuar gjyqi që

të bëhet, nën një: ekspertizë konziliare nga ana e psikiatërve, psikologut dhe punëtorit social; të bëhet edukimi sa më i shpejtë i personelit që do t'i trajtojë këta persona, duke përfshirë edukimin e psikiatërve forenzik; që të jetë një njësi speciale në burgjet e Kosovës ku do të mbahen personat e papërgjegjshëm, ndërsa konzoliumi i psikiatërve do të japë mendimin meritor profesional. Në rast të superekspertizave, konzoliumi të përbëhet nga neuropsikiatër me thrirje shkencore. Në të ardhmen të ndërtohet një institucion forenzik, në kuadër të burgjeve ku do të bëhet vlerësimi i papërgjegjësisë në momentin e kryerjes së veprës penale të këtyre personave dhe trajtimin e mëtejmë.

Me zbatimin e këtyre propozimeve, keqpërdorimet në këtë lëmi do të jenë minimale. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoja Nekibe Kelmendi, le të bëhet gati Gani Koci. Po ju kërkoj falje Nekibe, nuk keni qenë e regjistruar.

NEKIBE KELMENDI:

Deputetë të nderuar,

Meqë Kryesia e këtij Kuvendi e ka ngarkuar Komisionin për çështje të legjislacionit, çështjet gjyqësore dhe Kornizë Kushtetuese të hartojë një raport të tillë, Komisioni gjithashtu më ka ngarkuar mua, që me një Grup punues, të hartojmë këtë Raport dhe më ka dhënë detyrë, po edhe barrë të rëndë që të jam bartëse e hartimit të këtij Raporti.

Për të hartuar një raport të tillë, së pari t'ju them se kam gjetur mbështetje ligjore në Kreun e 5-të, pika 5.3 të Kornizës së përkohshme për vetëqeverisjen e Kosovës, në të cilën janë të përcaktuara përgjegjësitë e institucioneve të vetëqeverisjes që i kanë institucionet në fushën e çështjeve juridike. Nuk dua t'i numëroj të gjitha, sepse ju i keni prej pikës 5.3, apo neni 5.3 deri te neni 5.4.

Për të hartuar një raport sa më të gjerë, po edhe sa më përmbajtësor, ne si Komision kemi mbajtë takime me përgjegjësit e institucioneve gjyqësore të Kosovës, pra me udhëheqësit e gjykatave të Kosovës, duke filluar prej Gjykatës Supreme dhe gjykatat e qarqeve, të cilat e dijnë më së miri problematikën edhe të gjykatave komunale; pastaj me përgjegjësit e prokurorive, duke filluar prej Prokurorisë së Kosovës dhe të pesë qarqeve të Kosovës; kemi biseduar edhe me përgjegjësit ndërkombëtar të Shërbimit Korrektues të Kosovës, por edhe nga përvoja ime që kam patur si bashkëdrejtuese e Departamentit Administrativ të Drejtësisë dhe kështu jam përpjekur që juve deputetë të nderuar t'ua jap një pasqyrë të gjendjes në të kaluarën dhe gjendjes aktuale në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Fillimisht t'ju them se periudha e pasluftës, e dini në çfarë gjendje e ka gjetur Kosovën dhe sistemin gjyqësor në këtë kontekst, që do të thotë se ishte një gjyqësi e shkatërruar dhe fillimisht u ngritën, t'i quaj kushtimisht, gjykatat emergjente sa për të mos pasë vakum por edhe sa për ta mënjanuar kaosin që zakonisht krijohet pas konflikteve në secilin vend të botës.

Aktualisht, funksionojnë të gjitha gjykatat, prokuroritë dhe gjykatat për kundërvajtje por edhe të gjitha shërbimet korrektuese që kanë ekzistuar deri në mars të vitit 1989, me përjashtim të gjykatës ekonomike të qarkut në Gjakovë dhe të dy prokurorive, atë të Podujevës dhe atë të Rahovecit, të cilat kanë ekzistuar në atë vit. Arsyeja pse nuk janë themeluar edhe këto tri institucione gjyqësore, ka qëndraur në atë se Buxheti i Kosovës është i varfër dhe nuk ka mundësi të përballojë që të ndërtohen apo të ngriten edhe këto tri institucione. Jemi të ballafaquar që nga përfundimi i luftës e deri me ditën e sotme me funksionimin e gjyqësisë paralele në Kosovë. Kur e them këtë, kam parasysh se janë duke funksionuar disa institucione gjyqësore, sidomos gjykatat komunale si në Leposaviq, Zubin-Potok, pastaj Ferizaj, Lypjan, Gjilan e tjera, të cilat gjykata po funksionojnë në emër të gjykatave komunale të Kosovës por që ato po funksionojnë diku fshehtas ose jashtë Kosovës, në ndonjë komunë të përafërtë ose në enklavat e Kosovës, të krijuara me popullatë serbe që për fat të keq nuk po mundemi akoma të gjejmë zgjidhje se si të dalim nga to. Kur e them këtë, unë kam edhe prova, prova se vërtetë kështu po veprohet dhe prova e fundit është e 3 dhjetorit 2002 ku një gjykatë e Gjilanit, diku në Serbi, sigurisht në Vranjë, që është më afër, bjen një vendim gjyqësor e tjera, e tjera.

Gjendja e objekteve të gjykatave, sikur që keni parë edhe në raport, ka qenë jashtëzakonisht e keqe, sepse kanë qenë gjykatat e shkatërruara, por edhe të plaçkitura të gjitha mjetet e punës dhe kur kanë ardhur gjyqtarët tanë, dhe më besoni, kur kam shkuar t'i vizitoj gjykatat deri radiatorët kanë qenë të shkulur prej gjykatave. Por, falë donacioneve të shteteve perëndimore, sidomos Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, Kanadasë, Holandës, Finlandës, Zvicrës si dhe të Bashkësisë Evropiane sot mund të them me plotë përgjegjësi se për 300% ka ndryshuar gjendja e objekteve në sistemin gjyqësor të Kosovës, ndonëse në aspektin hapësiror akoma nuk i plotësojnë kushtet këto objekte.

Gjendja në shrëbimin korrektues të Kosovës. Ju e dini se Dubrava, jo vetëm si objekt që është shkatërruar por është bërë edhe gjenocid ndaj të burgosurve aty, sepse janë vrarë të burgosurit, ju lutem, që kërkund në botë nuk ndodhë – afër 200 janë vrarë dhe gjendja e atij shërbimi korrektues ka qenë mizerabël. Mirëpo, fillimisht ekspertët e Britanisë së Madhe, me donacionet e veta, ekspertët e Kanadasë, të Holandës e të Zvicrës kanë bërë çmos që pakngapak kapaciteti i Burgut të Dubravës të rritet, të ndërtohen objektet dhe sot mund të them se gati është i rindërtuar ai kompleks. Mirëpo, mendoj se me burgjet e qarqeve, gjendja qëndron ndryshe, sepse ato janë të pakta përnga kapaciteti, janë deridiku të renovuara mirëpo kushtet nën të cilat ato ndodhin dhe vjetërsia, amortizimi i tepërt i tyre, pastaj zgjidhjet e tejkaluara shumë të vjetruara arçitektonike nuk i plotësojnë kushtet për t'u trajtuar si burgje të qarqeve dhe nuk janë aq të përshtatshme për të qëndruar njerëzit gjatë procedurës së hetuesisë.

Profesori i nderuar foli për ligjet e aplikueshme në Kosovë. Nuk do t'ju lodhja më tepër lidhur me këtë.

U fol edhe për gjendjen kadrovike me theks të veçantë se janë emëruar gjykatës që kanë punuar në sistemin gjyqësor të Kosovës para viteve të 90-ta dhe se duhet që politika kadrovike të shkojë në atë drejtim që të inkuadrohen kuadro të reja.

Ju lutem, së pari dua t'ju them se ne nuk kemi mund të krijojmë kuadro të reja gjyqësore gjatë viteve të 90-ta për t'i përfshirë ato kuadro në institucionet e sotme gjyqësore. Pse? Sepse si etnikum, kemi qenë të nxjerrur jashtë ligjit, e në këtë kontekst kemi qenë të nxjerrur edhe jashtë ligjit për t'u aftësuar për të ushtruar funksionin e prokurorit dhe të gjyqtarit. Thënë shkurt, nuk kemi pasë mundësi t'i nënshtrohemi provimit të judikaturës për të aftësuar kuadro të reja për gjyqësorin.

Nga ana tjetër, kriteriumet, sipas rregulloreve të UNMIK-ut dhe ligjit të aplikueshëm, janë të atilla që nuk lejojnë që kuadro të reja menjëherë të kyçen pa një përvojë paraprake. Ju lutem, në gjykata vendoset për fatin e njeriut, për lirinë e njeriut, për të drejtat e njeriut dhe duhet të punojnë ekspertë që kanë një përvojë. Por mos harroni, nëse aludohet se po punuakan në gjykata njerëzit që kanë punuar para viteve të 90-ta, në secilin segment të jetës ne kemi njerëz që kanë punuar në vitet e 90-ta ose para viteve të 90-ta dhe edhe sot punojnë. Pse të veçohen gjykatat. Ata duhet t'i vlerësojmë asisoj nëse punojnë si duhet, nëse rrespektojnë pavarësinë e vet, sepse sikur që rrespektojnë pavarësinë e gjyqësorit kanë rrespektuar edhe pavarësinë e vendit, të shtetit. Prandaj, në atë aspekt unë nuk do të bëja ndonjë vërejtje, por është e dëshirueshme dhe e preferueshme dhe kjo pritet që në të ardhmen të inkuadrohen dhe të zgjidhen kuadro të reja të cilat janë duke u shkolluar dhe fatbardhësisht është bërë edhe reforma në Fakultetin Juridik, kështu që posa të aftësohen ato kuadro të reja, këto të vjetrat nuk mund ta ndalin procesin e vjetërsimit, as nuk mund ta ndalin kohën dhe do të shkojnë, sigurisht do të largohen, do të vijnë kuadro të reja dhe synimi ynë është që rinisë t'i mbetet e ardhmja e pse jo t'i mbetet e ardhmja edhe e gjyqësorit.

Për paga foli gjithashtu profesori i nderuar dhe unë mendoj se nuk do të kemi një gjyqësi të pavarur po nuk pat puxhet të pavarur për gjyqësorin. Ju lutem shumë, po marr një shembull shumë të thjeshtë, ndoshta edhe banal, por është i përditshëm. Thehet një xham i një gjykate, qoftë për shkak të erës ose prej ndonjë guri që gjuan ndokush, ose diçka tjetër – a duhet të shkohet në administratën ndërkombëtare në komunë të kërkohet, me një byrokraci, deri sa të ndërrohet ai xham? Pse mos t'i kenë gjykatat buxhetet e veta dhe fundja ato mbledhin edhe taksa po edhe me buxhetin e veçantë të gjykatave sigurohet edhe pavarësia e gjykatave, sepse edhe ky është një segment që siguron pavarësinë e gjykatave.

U shtrua pyetja – nëse cenohet pavarësia e gjykatave në Kosovë. Ju them me plot përgjegjësi se është cenuar pavarësia e gjykatave në Kosovë, jo për fajin e vendorëve. Kur flas për këtë kam edhe prova konkrete sepse, sikur që u cek, janë caktuar paraburgime edhe në bazë të një urdhëri administrativ, pra një vendimi jashtëgjyqësor që me parimet për pavarësinë e gjyqësorit nuk guxon të ndodhë kjo, po nuk guxon të ndodhë as sipas Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Është bërë një përpjekje që t'i shmanget drejtpërsëdrejti këtij interferimi apo këtij implikimi në punët e pavarësisë së gjyqësorit përmes një

Rregulloreje të UNMIK-ut Nr. 2001/18 më duket se ashtu është ajo rregullore. Mirëpo, ajo Rregullore çka thotë? Thotë, të formohet një komision për shqyrtimin e paraburgimeve jashtë gjyqësorit, të bazuara në urdhëra ekzekutive. Prapëseprapë, bazë për caktimin e paraburgimit është urdhëri ekzekutiv, por që ngritet një institucion administrativ, pra jogjyqësor që ta vlerësojë bazueshmërinë e atij urdhëri ekzekutiv. Më besoni, jam fanatike e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit. Me urdhëra të tillë ekzekutiv, unë nuk do të pranoja kurrë të punoja në sistemin gjyqësor të Kosovës. Kjo nuk duhet të na ndodhë në të arëdhmen dhe kjo nuk garanton ndarje të mirëfilltë të pushteteve, sepse nuk dihet atëherë cili është pushteti gjyqësor që duhet të jetë plotësisht i ndarë nga pushteti ekzekutiv dhe nga pushteti legjislativ.

Unë kam këtu shumë prova për këto cenime. Vetë personalisht e kam kontestuar edhe Rregulloren Nr. 2000/64, e cila gjithashtu cenon pavarësinë e gjyqësisë kosovare. Për këtë i jam drejtaur edhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës – Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut në Strasburg më 27 prill 2000, por kurrë përgjigje nuk kam marrë. Ani, edhe nëse nuk marrë përgjigje unë mbaj qëndrimin tim se disa rregullore vërtetë cenojnë pavarësinë e gjyqësorit.

Dhe, krejt për fund. Unë në bazë të kësaj që si Komision a si Grup punues kemi punuar, kam dhënë edhe rekomandimet dhe besoj se nuk ka nevojë këto rekomandime t'i përsëris. Njëri prej tyre gati-gati është veç duke u realizuar por një domosdoshmëri është që të kemi ligje, nën një. Nën dy, që të nxirret gazeta zyrtare e Kosovës, ku do të publikohen ligjet, sepse është rregull që ligji të hyjë në fuqi pas publikimit. Mbase kjo do t'u ndihmonte shumë edhe gjykatave, edhe prokurorive, pra edhe gjithë sistemit gjyqësor që të ecin në hap me ligje që nxjerr Parlamenti i Kosovës në mënyrë që edhe të dijnë se cilat ligje po nxirren, e jo unë si individ të grumbulloj këtu të gjitha ligjet që i ka nxjerrë Parlamenti i Kosovës dhe t'ua dërgoj gjykatave për t'i zbatuar, natyrisht, ato ligje të cilat nuk kanë embargo prej Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara.

Jam e gatshme të përgjigjem në të gjitha pyetjet që do t'më shtrohen dhe jam e gatshme të replikoj edhe me të gjithë ata që gjejnë diçka se nuk qëndron nga kjo që kam thënë në këtë Raport, por jo në emër timin por të Grupit punues dhe në emrin tuaj, deputetë të nderuar. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Edhe një herë kërkoj falje personale për vonesë. Para se të procedojmë, një sqarim. Dëgjuam dy fjalë hyrëse, shumë të detajizuara, shumë të argumentuara. Dëgjuam fjalën e kryetarit të Komisionit për çështje legjislative dhe kushtetuese dhe koordinatorën për hartimin e Raportit. Të tjerët, ju lutem, të kornizohen në kohë, sipas Rregullores, sepse ka shumë të paraqitur dhe të mos i bëhet ndokujt e padrejtë. Pra, të gjithë ata që jeni paraqitur, rrumbullaksoni fjalën për kohë të lejuar dhe të mundshme. Fjalën e ka Gani Koci, meqë e kam shënuar. Le të bëhet gati anëtari i Kryesisë Bajram Kosumi.

GANI KOCI:

I nderuar zoti kryetar, i nderuar përfaqësues i UNMIK-ut për çështje të drejtësisë, të nderuar kolegë,

Raporti është një bazë e mirë mbi të cilën, vërtet ky Kuvend do të duhej të merrte qëndrime të caktuara. Qëndrimi im është se drejtësia në Kosovë, në vazhdimësi, ka qenë pikë më e dobët e pushtetit okupues dje dhe ajo vazhdon të jetë një pikë tepër e dobët edhe sot. Vazhdon të jetë pikë e dobët edhe sot për faktin se kanë mbetur shumë lidhje me të djeshmen që ishte më shumë se e politizuar.

Zakonisht drejtësia mbështetet në tri shtylla të veta: në hetuesi; në prokurori dhe në gjyqësi. Hetuesia në të kaluarën zakonisht është mbështet në dhunë; në dëshmitarë të rrejshëm; në mashtrime e shpërblime. As sot nuk ka ndonjë dallim të dukshëm. Ndoshta sot është hequr dhuna, por jo edhe angazhimet tjera sidomos për t'i eliminuar veprimtarët e caktuar.

Hetuesia sot koincidon bukur shumë me metoda të hetuesisë së UDB-ës, bile në shumë raste shërbehet me dosje dhe denoncime të agjentëve të saj në Kosovë dhe jashtë Kosovës. As prokuroria e këtyre viteve në shoqërinë kosovare nuk ka bërë ndonjë përparim cilësor. Deri dje kishim shumë aktakuza politike mbi bazën e të cilave shpalleshin po ashtu gjykime politike me dënime drakonike. Prokuroria, edhe sot vazhdon rrugëtimin e saj të inskenimit dhe të politizimit të turpshëm. Gjyqësia ka fatin të ngritet mbi dy shtylla të para dhe ka vështirë të ngritet mbi to e të merr aktgjykimet e qëndrueshme dhe të pranueshme për opinionin kosovar. Opinioni kosovar gjatë këtyre viteve ka përcjellur dështime të njëpasnjëshme të gjyqësisë ndërkombëtare dhe vendore në Kosovë. Dhe, përveç se i ka ardhur keq për ata që janë goditur nga padrejtësia, më shumë i është dhimbsur drejtësia. Gjyqësia kosovare sikur është ngritur mbi bazën e marrëveshjeve të mëshehta për të ruajtur strukturat e vjetra të padrejtësisë.

Zonja dhe zotërinj,

Gjatë këtyre viteve është folur, dëgjuar e shkruar shumë për krimin e organizuar, për kontrabandën e korrupcionin, për trafiqet e ndaluara, të prostitucioneve e sëmundjeve tjera të shoqërisë kosovare. Sa aktakuza dhe sa procese gjyqësore u zhvilluan në Kosovë kundër bartësve të këtyre dukurive? Gjyqësia kosovare e ndërkombëtare në Kosovë duhet ta njoftojë Kuvendin e Kosovës se: – cilat janë rezultatet e hetuesisë dhe të gjyqësisë së rastit të Shaban Manajt, të Ismet Rracit, të deputetit Ismajl Hajdarajt, të Tahir Zemajt dhe rasteve të tjera të ngjashme. Cila është e vërteta e këtyre rasteve? Pse patë shumë zhurmë mediale dhe thirrje për hakmarrje kanunore? Kush përfitoi dhe kush humbi nga kjo zhurmë? Kush dhe pse merrte rolin e hetuesit, të prokurorit e të gjyqtarit? Pse asnjë fjalë për vrasjet e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? A ishin këto rastësi? Çka tregoi rasti Drini? Pse u viktimizua Salih Veseli? A mund zoti Zhan Kadi, meqë është prezent këtu, të përgjigjet në pyetjen se – a ka hasur diku në teorinë dhe praktikën penale gjyqësore të derisotme të flitet për tentimnxitjen, si një lloj vepre penale? Pastaj, cila është vlera e betimit të dëshmitarëve para gjykatorës? A duhet të ndëshkohen dëshmitarët që dëshmojnë rrejshëm? Sa kishte të tillë?

Pse gjyqësia në Kosovë ka ndjekur vetëm një drejtim? Cili ishte qëllimi? Pse dhe kush i amnistoi shërbimet sekrete serbe nga krimet e organizaura politike në Kosovë? Kush e bën lojën e këtyre shërbimeve sot në Kosovë? Për të gjitha këto kërkohet përgjigje nga organet e drejtësisë. Sllogani "askush mbi ligjin" mori vetëm një drejtim – drejtimin e një lufte shtrigash kundër ish pjesëtarëve të UÇK-ës. Kur jemi këtu, dua të shtoj edhe këtë. Në Kosovë nuk është mbajtur asnjë gjyq për tradhti të lartë. E, kishte tradhti të tillë. Nuk është mbajtur asnjë gjyq për rrezikim të luftës për liri të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E, kishte rrezikim të tillë. Nuk është mbajtur asnjë gjyq për bashkëpunim me okupatorin serb. E, kishte aq shumë të tillë. Nuk është mbajtur asnjë gjyq për veprimtari subversive antikombëtare. E, kishte veprimtari të tillë. Në Kosovë janë nëpërkëmbër lapidarët dhe përmendoret e dëshmorëve, janë rrëzuar varrezat e tyre dhe gjyqësia kosovare nuk ka ndërmarrë asgjë për dënimin e këtyre rasteve. Opinioni kosovar sot di vetëm për proceset kundër bartësve kryesor të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Është thënë "tolerancë zero për krimin, kontrabandën, korrupcionin". Sa vjedhje, sa keqpërdorime, sa të korruptuar e shkaktarë të avarive dhe asnjë përgjegjësi. Ku është drejtësia dhe sistemi gjyqësor në këto raste? Dështimi i drejtësisë në Kosovë nuk mund të arsyetohet me kushtet materiale dhe objektive nën të cilat ajo vepron. Dështimi i drejtësisë në Kosovë konsiston në faktin se i tërë sistemi gjyqësor është ngritur mbi bazën e sistemit të kaluar, duke filluar që nga aplikimi i ligjeve të ish jugosllavisë dhe Serbisë deri te përfshirja në këtë sistem e kuadrove të kompromituara në të kaluarën.

Sa për ilustrim po përmendi vetëm një fakt. Në Këshillin Prokural dhe Gjyqësor ka njerëz që në të kaluarën kanë shpallur dhe vërtetuar aktgjykime politike dënimet e të cilave maten me shekuj. Deshtimi i drejtësisë në Kosovë konsiston në faktin se ajo nuk është e pavarur dhe nuk rrespekton standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Me këtë rast kujtoni aplikimin e urdhërit ekzekutiv dhe pasojat e atij urdhëri. Drejtësia dështon kur në emër të saj bëhet padrejtësi. Kjo tash në Kosovë ka ndodhë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Bajram Kosumi. Lus të gjithë që të rrespektohet koha. Le të bëhet gati Dragisha Kërstoviq.

BAJRAM KOSUMI:

I nderuar kryetar,

Ne përkrahim rekomandimet që i ka bërë Grupi, por mendoj se ky Kuvend duhet të mirret edhe me pasojat që ka krijuar një sistem i tillë gjyqësor në Kosovë, i krijaur në periudhën e pasluftës.

Ne, për shkak të rrënimit të pozitës kushtetuese të Kosovës dhe për shkak të rrënimit të tërisëshëm të sistemit të gjyqësisë në Kosovë, pas vitit 1989, kemi folur në kuptimin negativ vetëm për këtë periudhë. Kemi bërë një lloj amnistimi të heshtur për periudhat e mëparshme

të sistemit të gjyqësisë në Kosovë kur socializmi ka lulëzuar në Kosovë. Ne kemi bërë atë amnisti të heshtur, por kjo nuk do të thotë që ne do të pajtohemi dhe do të pranojmë që gjyqtari ose prokurori i cili është përgjegjës për mijëra vjet burg, për dënime politike, të jetë përsëri gjyqtar dhe të jetë përsëri prokuror. Ne nuk do të pajtohemi që ligjet, prej të cilave ka pësuar 90% e popullatës në Kosovë, të jenë përsëri të aplikueshme në Kosovë. 90% e ndoshta 100% e juve deputetëve që jeni sot këtu, keni pësuar prej këtyre ligjeve që sot janë të plotëfuqishme në Kosovë. Duhet të thuhet se pas luftës, krijimi i sistemti gjyqësor në gjenezë është nisur mbrapsht dhe nuk mund të ketë rezultate të mira e të lakmueshme me diçka çka është nisë mbrapsht. Pasojat e kësaj që është nisur dhe është krijuar kështu po shihen edhe sot. Mos të përmendet urdhëri ekzekutiv i cili tashmë është bërë problem i njohur dhe nuk ka kush që flet mirë për udhrërin ekzekutiv, përveç atyre që e kanë imponuar. Ne do të mirremi edhe me pasoja tjera. Gjyqësia sot në Kosovë nuk është gjyqësi e pavarur, të gjithë pajtohemi. Por nuk po themi edhe një gjë tjetër – gjyqësia sot në Kosovë është nën ndikim të plotë të politikës së UNMIK-ut. Prej kujt dirigjohet, ne nuk dijmë. Por gjyqësia në Kosovë është e dirigjuar politikisht. Është gjyqësi politike.

Vetëm shikoni sa krimi ndodhë në Kosovë dhe asgjë nga përkryesit e atyre krimeve nuk bëhet. Sa krimi hynë në Kosovë dhe gjyqi është krejt në aut. Ndërsa, ndiqen penalisht, hulumtohen, gjurmohen, përgjohen të gjithë ata njerëz që kanë funksione politike, janë njerëz publik e tjera, e tjera, kurse kriminelët e vërtetë shëtisin rrugëve. Gjyqet, madje bashkëpunojnë me kriminelë për të sulmuar personalitetet publike. Këto janë gjyqe politike. Unë sot e mora një libër, një autor, që ka shkruar një libër: Vrasja e drejtësisë në Kosovë. Do të thotë njerëzit në Kosovë kanë filluar me shkruar libra, e le më çka mendojnë. Kanë filluar të shkruajnë libra me nga 300 faqe se qysh drejtësia në Kosovë po vritet. Dhe, kjo është, do të thotë prej ...

Çështja e dëshmitarëve është një pasojë tjetër. Dëshmitarët në Kosovë nxiten, yshten, iu premtohen para të mëdha, kërcnohen që të dëshmojnë ashtu e kështu dhe në fund, nëse zbulohet se janë dëshmitarë të rrejshëm, lehen të shkojnë në shtëpi. Mendoj se gjyqësia e Kosovës dhe ekspertët, duhet t'i ndriçojnë këto raste, jo për t'i evidencuar por që të mos lejojnë në kodin penal apo çka është tash në procedurë të mriatimit, apo në kodin për procedurë penale që të lejohen këto vrima dhe mundësi që dëshmitarët e rrejshëm të lëhen të lirë.

Një çështje tjetër është përgjegjësia e gjyqtarëve dhe e prokurorëve për gjykimet e kurdisura. Nuk mund dikush, politikan apo kushdoqoftë tjetër të bëhet aq cinik dhe të thotë se raste të tilla ndodhin edhe në perëndim, në drejtësinë perëndimore. Mirret njeriu - i pafajshëm, çohet në burg, mbahet dy vjet, lirohet dhe ç'fajësohet dhe të thuhet po kështu ndodh edhe në Evropë. Kështu ndodh në Evropë, por persoant që janë përgjegjës për raste të tilla do të bartin përgjegjësi juridike. Cili gjyqtar dhe cili prokuror në Kosovë për dështimet e tilla, për kurdisje të tilla të gjyqeve ka pasë përgjegjësi. Unë nuk dij deri tash që ka pasë ndokush. Dhe, duhet të kodifikohet edhe kjo përgjegjësi.

Dhe, në fund, besimi në drejtësi. Qytetarët e Kosovës nuk po besojnë në drejtësi. Drejtësia në Kosovë, ndoshta po flas, jam deputet por në emër të qytetarëve shumë flitet por nuk shoh një njeri, nuk kam pa njeri që thotë: po – unë besoj në gjyqin e Kosovës. Unë jam i pari që nuk

besoj në gjyqet e Kosovës. Dhe kjo rrjedh sepse, siç thash, neni me të cilin unë jam dënuar në vitin 1981, neni i kodit, është i plotëfuqishëm edhe sot. Dhe me nenin 133 dhe atë 136 është dënuar në Suharekë, momentalisht emri s'po më kujtohet, me atë nen me të cilin jam dënuar është dënuar njeriu i cili pas dy vjet burg dhe pasi ka mbajt një pjesë të burgut është liruar i pafajshëm. Prandaj, qysh mund t'i besoj unë asaj gjykate, atij ligji me të cilin 90% e qytetarëve të Kosovës janë dënuar, janë ndjekë, janë marrë në polici, janë përgjuar, janë rrahur, janë torturuar e gjithçka tjetër... Nuk ka këtu besim.

Çështja të cilën duhet ta bëjmë ne si Kuvend, me miratimin e kodit penal dhe kodit për procedurë penale që, nejse, do të mriatohen këtu dhe nuk ka rrugë tjetër, duhet që gjytarët dhe prokurorët t'i emërojë Kuvendi i Kosovës. Nuk ka kurrfarë rruge tjetër të ligjshme. Nëse shkon kështu qysh është sot, është rrugë e paligjshme dhe do të ketë gjyqësi politike në Kosovë.

Dhe, e fundit është, duhet bërë reformimi rrënjësor i sistemit gjyqësor në Kosovë. Ne kemi patur një sistem gjyqësor komunist, të shtypur dhe të dirigjuar pastaj prej pushtetit militarist e shovenist të Millosheviqit dhe tash, duke u bë pak të them i lëmuar, edhe prej politikave të UNMIK-ut. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Bajram, ju falemnderit. E ka fjalën Dragisha Kërstoviq. Sa për informim, ne në fund të debatit do t'i aprovojmë rekomandimet, pra shumëçka që do të përsëritet dhe po përsëritet, është në rekomandim. Prandaj, ju lutem përqëndrohuni në kohën e nevojshme dhe çështjet të mos përsëriten. Urdhëroni, Dragisha. Le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Poštovani predsedniče, poštovani gospodine Kadiu, deme i gospodo poslanici,

Iako sam označen kao član Radne grupe u materijalu koji ste dobili, ja u toj Radnoj grupi nisam učestvovao ne zbog nekih razloga bojkota već jednostavno nisam imao priliku, nisam imao vremena i bili su i neki drugi razlozi, znači zbog čega nisam učestvovao. Da sam kojim slučajem učestvovao pokušao bih da izvršim uticaj na Izveštaj sa svog stanovišta. Ovako, izveštaj je takav kakav jeste i o njemu se naravno raspravlja.

Ono što želim odmah na početku da kažem, mislim da ne bi trebalo da se vračamo na neki period pre konflikta koji se dogodio 99. godine i da raspravljamo o pravosudju, kosovskom pravosudju iz tog perioda, jer taj period je završen, on je dobio odredjene kvalifikacije. Zbog posledica koje su se desile neko snosi ove konsekvencije, neko ove, i na kraju krajevea zbog toga svega imamo ovo što imamo sada, imamo UNMIK, imamo Medjunarodnu misiju i na taj period mislim ne bi trebali da se vračamo i mislim cilj ovog Izteštaja nije trebalo da bude to.

Ja naravno imam brojne zamerke na Izveštaj koji je sačinjen. I prva moja zamerka se odnosi na to da multietničnost kosovskog pravosudja nije postignuta iako su se neki faktori od početka zalagali da se ta multietničnost postigne. To nije postignuto iz već poznatih razloga. Dakle, nema bezbednosti i slobode kretanja, nema povratka raseljenih i naravno to je osnovni razlog što za sada nema ni multietničnosti i kosovskog pravosudja iako su brojne srpske sudije spremne da udju u to pravosudje i da tu nacionalnu strukturu kosovskog pravosudja poprave, odnono da je dovedu u neki normalni red.

U ovom Izveštaju su izrećene i brojne neistine. Izrećena je neistina, na primer, da su demolirane zgrade prilikom konflikta iz 99. godine, da su odneseni predmeti iz svih sudova. Ono što ja znam, mislim da nema dokaza da su zgrade demolirane i da su odneseni predmeti baš iz svih sudova. Poznato mi je da iz Prištinskog okružnog suda nisu odneseni predmeti, da iz Vučitrnskog opštinskog suda nisu odneseni predmeti i mislim da nije dobro da Izveštaj sadrži ovakve kvalifikacije i ovakve neistine.

Osim ovoga, Izveštaj sadrži i veliki broj političkih kvalifikacija i ocena iako bi Izveštaj, po pravilu, trebalo da bude izveštaj o stanju u pravosudnom sistemu Kosova i da se strogo drži struke i profesije i naravno da se osloni na ono što podaci koji su dobijeni iz sudova govore o stanju u tom pravosudnom sistemu.

Nije dat odgovor na jedno vrlo važno pitanje a to je – koliko su sudovi u svom dosadašnjem radu, dakle konstituisani po UNMIK-ovim pravilima, doprineli stabilizaciji stanja na Kosovu i koliko su doprineli suzbijanju kriminala naročito onog organizovanog. Takav odgovor u Izveštaju nema i mislim da je Izveštaj, što se toga tiče, veoma manjkav i veoma sporan.

Vi ćete naći u Izveštaju recimo strukturu osudjenih lica. I na nekoliko mesta prosto oni koji su pravili Izveštaj lamentiraju zbog toga što u mnogim zatvorima nema Srba. Ta činjenica pada u oči i mislim da to nije dobro i Izveštaj je morao da izbegne jednu takvu konstataciju i da se zadovolji time da tamo gde nema Srba stavi crticu, a ne da ovaj... recimo, za Okružni zatvor u Peći, za Okružni zatvor u Prizrenu, za ne znam okružni zatvor još koji beše... Jednostavno kaže, toliko ovih... toliko pripadnika ove etničke zajednice, toliko ovih, ali nijedan Srbin. Zaista, nešto što ovako ukazuje na nešto, svakako nije dobro.

U Izveštaj imamo veliki broj tabelarnih pregleda odnosno statističkih podataka i mislim ja ne bih oko tih tabelarnih podataka. Verujem da su oni korektno dati, ali i tu ima jedan propust koji je suštinske prirode. Zapravo, nema podataka o izjavljenim pravnim sredstvima i broju potvrdjenih, ukinutih i preinačenih odluka. Barem ja nisam bio u prilici da vidim takav podatak a to je vrlo značajan podatak kada se raspravlja o radu pravosudnih organa odnosno o stanju u pravosudnom sistemu na Kosovu. Prema tome, sve u svemu, dakle tekstualni deo Izveštaja je uglavnom politički dimenzioniran i sa dosta tendencioznim i neistinitim konstatacijama i zbog toga je po mom stanovištu neprihvatljiv.

U nekim tabelarnim pregledima, u nekim kažem, nema zastupljenog srpskog jezika, što je ozbiljan prigovor. Neke tabele ja nisam mogao da protumačim upravo zbog toga. Mislim da su struka i profesija ovom prilikom ustuknuli pred politikom i ono na šta posebno želim da

istaknem jeste da se ni u Izveštaju a ni u raspravama dosadašnjim ne propušta nijedna prilika da se ne govori o nezavisnosti Kosova. Mi se naravno sa time nećemo složiti i profesora Bajramija želim da upoznam da su pored Hrvatske, Slovenije i Albanije, da je i Srbija država u tranziciji. Milošević i njegovi saradnici, koji su krivi za konflikt na Kosovu, nisu više u Beogradu. Oni su u Hagu i tamo su ih poslale srpske vlasti. I aktuelne srpske vlasti u Beogradu dobijaju najveća priznanja od evropskih asocijacija i Američkog Kongresa. Srbija ima kontakte i sa Republikom Albanijom i to vrlo korektne za sada a juče su otpočeli i kontakti sa kosovskim asocijacijama. Mi to pozdravljamo i mi to podržavamo. Hvala lepo.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ramadan Kelmendi, le të bëhet gati Ismajl Kurteshi...

ARSIM BAJRAMI:

Mendoj se kolegu nuk duhet ta përziejë fare transicionin e Kosovës me transicionin e shteteve tjera. Problemi i transicionit në Serbi, është problem i Serbisë. Ne po ndërtojmë një transicion tonin bashkë me bashkësinë ndërkombëtare. Ne po mundohemi të instalojmë këtu një shtet ligjor çfarë ka munguar në Kosovë dhe çfarë i është imponuar Kosovës, kështu që nuk ka asnjë lidhje... Serbia le të përparojë me transicionin e vet. Kjo është çështje e saj. Ne po ndërtojmë këtu gjyqësinë e Kosovës dhe kemi përgjegjësi edhe si Kuvend, edhe në bazë të akteve në fuqi, për ta ndërtuar një gjyqësi të pavarur krejt me standarde evropiane.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Lere, Nekibe, s'ta ka përmend emrin. Replikë don, a? Urdhëroni Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë dhe përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare,

Unë në tërësi përkrah Raportin mbi punën e gjyqësisë të paraqitur këtu nga zonja Kelmendi dhe profesor Arsimi. Mirëpo nuk pajtohem me disa pjesë të diskutuesit të mëparshëm i cili vërtetë jep insinuata dhe të pavërteta. Sido që të jetë, unë kam disa pyetje dhe një fjalë hyrëse.

Ajo që e bën shtetin ferr mbi tokë, është padrejtësia dhe gjyqësia totalitare. Elemente të këtij komponenti kemi. Ku s'ka ligj, nuk ka liri dhe ku s'ka liri nuk meriton të jetohet. Shteti pa gjyqësi krijon padrejtësi. Nuk siguron liri të individit dhe as të kolektivitetit. Shkelet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria. Sistemi juridik që rrespekton ligjet e pushtuesit, dhe tani konkretisht në Kosovë ligjet e Serbisë të ashquajtura ligje të aplikueshme, krijon paradoks juridik të tipit jodemkratik që askund në botë nuk ka aplikimin. Themeli i shtetit është

drejtësia. Ajo realizohet përveç përmes gjyqësisë dhe vërtetë gjyqësia e Kosovës nuk realizon drejtësinë sa duhet dhe sa kërkohet.

Këtë e vërtetoj me këto fakte: Gjyqësia në Kosovë, një kohë të gjatë ka kaluar, dhe në veçanti kalon, nëpër një krizë. Ku janë faktet?

E para, është mungesa e ministrisë së drejtësisë dhe nuk ka gjyqësi të mirëfilltë pa ministri të drejtësisë.

E dyta, pavarësia e gjykatave në Kosovë nuk është. U tha, nuk dua të elaboroj më tepër. Një numër i madh i gjyqtarëve janë zgjedhur dhe janë emëruar pa dhënë betimin, dhe pa dhënë betimin para këtij Kuvendi dhe më vjen keq, ata aplikojnë ligjet diskriminuese, një numër i vogël tash, dhe kanë dhënë betimet në kuvendin e Serbisë, në një kuvend që u muar vendim për të shkatërruar tërë atë që ishte në Kosovë. A s'janë këto elemente që flasin për një pagjyqësi jo të plotë, joefikase, të padrejtë dhe joprofesionale.

Në mungesë të kodit penal, në mungesë të kodit të procedurës penale vështirë se do të krijohet sistemi gjyqësor si duhet. Dhe, edhe ne duhet patjetër të kërkojmë kodin e përgjegjësisë për gjyqëtarë dhe ata që ushtrojnë këtë funksion.

Krejt po e shkurtoj. Unë relacionin e sistemit gjyqësor e lidhi edhe me shërbimin korrektues. Ne nuk kemi informata të duhura dhe të mjaftueshme mbi mënyrën e funksionimit të tyre, kushte te punës, numrin dhe strukturën e të punësuarve, organizimin, vizitat, sistemin edukues-përmirësues, pastaj tipet e burgjeve në Kosovë, të mbyllura, të hapura dhe një numër të elementeve tjera që i përshkojnë këto.

Pyetjet: E para, Burgu i Mitrovicës pse nuk ka asnjë gardian shqiptar dhe nuk kthehet administrata shqiptare në të;

E dyta, Burgu në Smrekovnicë që është i dedikuar gjysëm i mbyllur dhe gjysëm i hapur, sot nuk funksionon. Cilat janë shkaqet dhe pse?

E treta, 8.620 denoncime të bëra nga shqiptarët e Mitrovicës, në mesin e tyre edhe unë e tjerë plotë, pranë xhandarmërisë franceze për atë që ka bërë Serbia mbi shqiptarët e këtij qyteti, në veçanti shqiptarët e pjesës veriore, asnjë denoncim yni nuk është marrë në shqyrtim dhe si të tilla kemi informacione por jo ende të vërtetuara plotësisht se ato janë hudhur dhe si të tilla kurrë nuk do të shqyrtohen dhe ja këtu është vlera e tyre.

Organet e judikaturës së Kosovës veriore, asnjëherë deri më tani nuk janë të integruara në sistemin e gjyqësisë kosovare. Vlerësoj se gjyqësia e Kosovës ka nevojë të shkundet, të jetë e pavarur, të këtë ligjet e avancuara demokratike të aprovuara në këtë Kuvend, të moszbatojë dispozitat e ligjeve të aplikueshme diskriminuese të një shteti që nuk ekziston. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ismajl, për një minut të lutem. Nekibe, a doni fjalën apo doni të bëni replikë?

NEKIBE KELMENDI:

Ma ka përmend Raportin. Unë jam autore e Raportit. Të falemnderit që më dhat fjalën, zoti kryesues.

Desha shkurt. U tha se gjykatësit nuk po i zbulojnë rastet e disa vrasjeve që vërtetë na kanë tronditur tërë Kosovën. Mirëpo, gjyqet nuk zbulojnë rastet. Tjetërkush i zbulon rastet. I zbulojnë policia dhe ekspertët që janë për zbulimin e rasteve. Gjyqet punojnë vetëm kur rastet e zbuluara iu shkojnë për t'i gjykuar dhe nuk mund t'i bëjmë fajtore gjykatat pse nuk po gjykohen për vrasjen e deputetit, e tjerëve, e tjerëve.

Sa i përket mungesës së multietnicitetit. Nuk është aty arsyeja. Arsyeja është se 41 gjyqtarë serbë janë emëruar në sistemin gjyqësor të Kosovës në vitin 2000 nga ana e Përfaqësuesit Special dhe nuk kanë dasht të kyçen në sistemin gjyqësor të Kosovës, por sigurisht kanë qenë të ndikuar nga Beogradi. Mua më vjen keq që ata nuk janë liruar akoma nga ato ndikime, por është çështje e tyre. Herën e fundit, tash kur u zgjodhën gjyqtarët, janë emëruar edhe 22 gjyqtarë, bile-bile kemi toleruar që të aplikojnë në Ministrinë e Drejtësisë së Serbisë për gjyqet kosovare. E kemi përbirë edhe atë dhe edhe asaj ia kanë këthyer shpinën, nuk kanë dashur të kyçen në sistemin gjyqësor të Kosovës.

U tha – nuk qëndron fakti se janë vjedhur radiatorët. Po, unë, vetë me sytë e mij e kam parë në Podujevë pa radiatorë. Ju lutemi shumë. Gjykata Komunale e Podujevës, nuk ka radiatorë. Ku janë radiatorët? Tha, kanë shkuar diku te Kurshumlia, se më afër është Kurshumlia.

Lëndët nga Prishtina, dosjet e gjykatave nga gjykatat e Prishtinës, të Mitrovicës, të Gjilanit e të shumë gjykatave tjera, ende gjenden sot e asaj dite, bile-bile edhe lënda e burrit tim gjendet në Serbi. Është vjedhur prej këtu, prej Kosovës dhe dërguar në Serbi. Dhe dihet pse është vjedhur, edhe e fëmijëve të mij.

Pastaj, u përmend – pse nuk ka të burgosur serbë në burgjet tjera. Nuk ka sepse, më falni, 43 të akuzuar për krime lufte të minoritetit serb kanë ikur qysh në vitin 2000 prej Burgut të Mitrovicës dhe sot e asaj dite ata nuk i përgjigjen as gjyqësisë kosovare, as UNMIK-ut, as kërkujt. Dhe, krejt leht mund të ndodhë, se veprojnë akoma diku në këto troje tona të Kosovës!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të falemnderit. E ka fjalën Ismajl Kurteshi. Le të bëhet gati Smilka Millosavleviq.

ISMAJL KURTESHI:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Në Kosovë, në bazë të nenit 9.4.8 të Kornizës Kushtetuese, gjykatësit dhe prokurorët emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-ës prej listave të kandidatëve të propozuar nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës dhe të miratuar nga Kuvendi. Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës është organ i përbërë prej 10 anëtarëve, për të cilin nuk është përshkruar se kush e emëron por dihet se atë Këshill nuk e ka emëruar Kuvendi i Kosovës dhe deri më tani Kuvendi i Kosovës nuk ka miratuar listat e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe as nuk ka pasur qasje në emërimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, prandaj e tërë procedura e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në komunë ka mbetur e cunguar, e papërfunduar, është që është jodemokratike dhe e imponuar. Prandaj, shtrohet pyetja – a mund të jenë këta gjyqtarë dhe prokurorë legjitim?

Në Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 1999/7 në lidhje me emërimin e gjyqtarëve thuhet përveç tjerash: Gjyqtarë e prokurorë mund të emërohen ata që nuk kanë aplikuar ligje diskriminuese në periudhën dhjetëvjeçare. Kurse, Rregullorja 2001/8 e UNMIK-ut i amniston gjykatësit që kanë zbatuar ligje diskriminuese pasi që kushti - të mos kenë aplikuar ligje diskriminuese, hiqet. Mirëpo, mbetet kriteri – të kenë vlera të larta morale. Tani shtrohet pyetja – a mund të kenë vlera të larta morale ata gjykatës që kanë zbatuar ligjet diskriminuese?

Për anomalitë e gjyqësisë në Kosovë folën parafolësit dhe unë vetëm telegrafikisht do t'i përmend disa raste. Sistemi paralel që ka përëfshirë Kosovën ka përfshirë edhe gjyqësinë e Kosovës, prandaj në Albanik dhe Zubin-Potok punojnë edhe gjyqet paralele të cilat punojnë me ligje të Serbisë. Dëshmitarët e rrejshëm janë njëri nga dëmet që po i sjellin gjyqësisë në Kosovë. Viteve të fundit në Kosovë ka ndodh shpesh që të inicohen procese gjyqësore të bazuara në dëshmi për të cilat është vërtetuar se janë të rrejshme dhe pas vuajtjeve të dënimeve me muaj e vite të tëra, është vërtetuar pafajësia e të akuzuarve, siç është rasti i Afrim Zeqirit nga Gjilani dhe shumë raste të tjera, por mesa dihet deri më tani nuk është dënuar asnjë dëshmitar i rrejshëm.

Prestigjin e gjyqësisë kosovare po e dëmtojnë shumë edhe akuzat e pabaza, joprofesinalizmi dhe veprimet tendencioze. Dënimi me 10 vjet burg i gjenealit Salih Veseli, nën akuzën – tentativë për nxitjen e vrasjes, i ka irituar shumë qytetarët e Kosovës të cilët me të drejtë pyesin: si është e mundur të dihet se gjeneral Veseli ka nxitur vrasjen e komandant Drinit, kur ende nuk dihet vrasësi. Do të thotë vrasësi është i pazbuluar. Dhe të metat tjera si jotransparanca, joefikasiteti në punësinë e gjyqësisë, mbrojtja e lirë e të akuzuarve për vrasje, arrestimet me urdhër administrativ, falsifikimet deri në atë masë që bëhen kontrata edhe me të vdekurit për të arritur qëllime të caktuara të njerëzve dhe këto janë të meta të cilat sot po e përcjellin punën e gjyqësisë së Kosovës dhe me kësaj radhe po përmend një rast i cili ilustron joefikasitetin e gjyqësisë në Kosovë. Rasti i uzurpimit të objektit të Shoqatës së Pensionistëve në Gjilan është rast për të cilin ka filluar procedura gjyqësore më 25 shkurt 2000. Më 15 gusht të vitit 2000 administratori komunal është pajtuar që policia e UNMIK-ut ta ndihmojë lirimin e këtij objekti të uzurpuar. Kurse, më 11 nëntor të vitit 2001, Gjykata Komunale në Gjilan obligon të padituri ta lirojë objektin brenda 15 ditësh. Ky aktgjykim

bëhet i plotëfuqishëm më 30 shtator të vitit 2002 por objekti ende është i paliruar dhe nuk dihet se kur do të lirohet.

Prandaj, një sistem gjyqësor që po përcjellin kaq shumë defekte, nuk mund ta kryejë misionin që i takon. Sistemi gjyqësor në Kosovë duhet sa më parë të riparohet dhe të aftësohet për punë të mirëfilltë profesionale. Kosovës i nevojitet një sistem efikas gjyqësor dhe për këtë duhet angazhuzar institucionet kompetente. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Smilka Millosavleviq, le të bëhet gati Sadik Idrizi. Do t'ju lutja të mos përsërisim gjërat, në mënyrë që edhe zoti Kadi të mund ta merrë fjalën e pastaj do të shkojmë në pauzë. Prandaj, në qoftë se nuk ka elemente të reja, të mos i përsërisni gjërat.

SMILJKA MILOSAVLJEVIĆ:

Hvala. Gospodo poslanici,

Slika koju daje podneti Izveštaj je nedovoljna za potpuno sagledavanje stanja pravosudnog sistema u proteklom periodu, koji nije definisan zato što analitički deo govori u celom tekstu o periodu od 99. godine, dok statičk, deo Izveštaja prikazuje stanje u protekloj kalendarskoj godini.

Izveštaj, pre svega liči na politički referat, sa jasnom odredjenom motivacijom, u svru optužbe svih i svega, ponajviše vojno-političkih srpskih snaga, sudija i tužilaca Srpske nacionalne zajednice i srpskih pavosudnih organa. A, Izveštaj se najmanje bavi potpunijom i kritičnijom analizom sopstvenog dela u proteklom vremenu. S tim u vezi, smatram da Izveštaj ni u kom slučaju ovako sročeno neće služiti svrsci već naprotiv produbljivanju razlika.

Navešću samo neke od stavki, kojima ću to da dokumentujem. Ovde je bilo već iznošenja stavova o tome da su sredstva za rad sudova uzeta, odnete i tako dalje. Ja ću samo da prekomentarišem. Interesuje me samo kako je Komisija došla do ovog zaključka? Čija je to tvrdnja? Kada je učinjen, i kada je učinjena jedna kompletna analiza o tome šta je od predmeta izneto? Koja je imovina odneta i ko je razbijao i demolirao zgrade, kako se to tvrdi. Znači ovo je paušalan zaključak i ovaj zaključak ne treba aprihvatiti.

Zatim, još jednu stavku ću navesti po pitanju sudija i tužioca Srpske zajednice. Zaključak takodje svom jednostranošću upućuje na već obrazloženi cilj autora Izveštaja. Niko ne govori o potpunijim razlozima i rezervama pomenutih lica za prihvatanje ovih funkcija, kao ni činjenicu da su ova lica, u više navrata, iskazala spremnost za uključivanje u rad pa čak i činjenicu da je jedan broj lica i aktivno radio i to već od prvih dana nakon rata ali se nikada nije odgovorilo na jednostavno pitanje – zašto su oni morali da napuste pravosudje ili zašto

se ti ljudi ne uključe u većem broju od pomenutih bezznačajnih primera kojima se vešto manipuliše i konstatacijama o multietničkim institucijama pravosudnog sistema.

Zatim, moram još u nešto da se osvrnem, kada je u pitanju funkcionisanje paralelnih pravosudnih organa. To je interesantan detalj, jer u metodološkom prilazu izveštavanja autora teksta sledi odmah već sa iznetom konstatacijom. Znači autor smatra najprioritetnijim pitanjem postojanja rada pravosudnog sistema, znači funkcionisanje paralelnih organa. To se znači da zaključiti za ove činjenice u analitičkom uvodnom delu, koji takodje služi u svrsci jednostrane političke manipulacije i ocene. Hvala lepo!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Sadik Idrizi, le të bëhet gati zoti Shefki Sejdiu.

SADIK IDRIZI:

Poštovani predsedniče, drage kolege,

Ja ću u ime drugih zajednica, znači one Parlamentarne grupe koja predstavlja deset odnosno to je grupa od 10-11 poslanika nesrpske i nealbanske zajednice.

Stanje u pravosudju smatramo da je onakvo kakvo jeste i da odražava sliku ukupnog stanja na Kosovu. Niti je mnogo bolje, niti je gore nego što je u nekim drugim sferama života. znači, stanje u obrazovanju, stanje u zdravstvu, stanje u privredi, da ne idemo ovamo u KEK-u i tako dalje. Znači od prilike je u toj ravni i stanje u pravosudju. Problema ima. Ima odredjenih stvari koji se kreću napred, sporo i neke stvari u zastoju. Što se tiče ovih drugih zajednica i prema ovim izveštajima tabelarnim, pada u oči da su veoma malo zastupljene. U redovnim sudovima i u sudovima za prekršaje nema nijednog pripadnika Turske nacionalne zajednice. Bošnjačka zajednica je nešto zastupljenija. Figurira jedan Aškalija, Rom ne figurira. Mislim da je na ovom zadnjem konkursu primljen jedan Goranin i još jedan Bošnjak i to je sve u odnosu na broj koji čine ove zajednice na Kosovu nedovoljna zastupljenost. Za razliku, znači od Srpske zajednice, koja ima drugačiji pristup prilasku, ove druge zajednice učestvuju ali ne u meri u kojoj bi trebalo da budu prisutne u sudovima.

Druga stvar je što ove druge zajednice, posebno mislim na Tursku i na Bošnjačku zajednicu, imaju u odredjenim sredinama još problema oko upotrebe jezika. U Dragašu je situacija korektna, znači govorim o Dragašu. U Prizrenu, što se tiče Bošnjačke zajednice je delimično, znači zadovoljovajuća. Što se tiče Turske zajednice, ona ima više problema oko upotrebe jezika u sudovima, znači na saslušanjima i tako dalje i mislim da u toj oblasti bi trebalo da se učine odredjeni napori.

Grupa koja je radila Izveštaj, mislim možemo mi biti nezadovoljni odredjenim stvarima i možemo imati primedbe na ovaj Izveštaj ali rad koji je ovde uložen odnosno Izveštaj ima dosta znači pokazatelja i to je jedan od izveštaja sa kvalitetnije uradjenih izveštaja. Drugo je

pitanje da li smo mi zadovoljni stavkama u Izveštaju ili ne, ali ovo je jedan od izveštaja koji daje jednu sliku, pregledniju sliku i sa smernicama odnosno sa zaključcima i preporukama za dalji rad. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Shefki Sejdiu, le të bëhet gati Muhamet Kelmendi.

SHEFKI SEJDIU:

Zonja dhe zotërinj deputetë, të nderuar ndërkombëtarë, i nderuar zotri Kadi,

Unë më tepër këtu po paraqitem si intelektual, deputet intelektual. Plotësisht pajtohem me referatet që kolegët më parë i dhanë. Unë vetëm nga një dobësi imja profesionale do t'i jap disa mendime t'mia rreth gjendjes në gjyqësi nga aspekti i terminologjisë. Sepse, terminologjia, në një mënyrë është reflektim i një realiteti që është në një hapësirë të caktuar. Në konceptet, ne duhet t'i hulumtojmë si konceptin drejtësia - e drejta; gjyqësia - gjyqi; gjykimi – denimi. Të gjitha këto koncepte universale që janë në gjyqësitë normale në sistemet normale, te ne, e kam një përshtypje, se mbështeten në termin paragjykim dhe arbitrarizëm. Andaj, nëse lexoni shtypin, do të vëreni që përditë lindin terma të ri, si te institucioni gjyq, ndjekës, gjykatës, dëshmitarë e tjerë; dëshmitar i mbrojtur, i pambrojtur, i mësheht, gjysmë i mësheht e të tjera. Të gjitha këto tregojnë kompleksitetin e jetës sonë këtu dhe drejtësisë sonë. Ju lutem këtu dalin edhe gjëra të tjera. Që nga rastet, e quan rast, lëshohen pas disa muajve, vjetëve; gjykime, procese dhe unë kam frik se këto të gjitha dikur, dalëngadalë, në mënyrë shumë të përzgjedhur, do të shndërrohen edhe në afera. Ju lutem, liberatorët po dënohen. Cili është ai shtet, cila është ajo shoqëri që liberatorët i dënon?

Nuk do ta zgjas shumë dhe pasi është zoti Kadi këtu, unë kam frik se këto denime, këto gjykime i ngjajnë një prapavije shumë të thellë. Kosova është mësuar me procese. Vetëm t'ju përkujtoj këtu se në më 1878 kapatur procese dhe likuidime. Edhe në Prizren përsëri në vitetet e dyzeta, gjithashtu procese të Prizrenit. Edhe tash, një paradigmë procesesh në Prizren, sikur është krijuar, thuaja një traditë. Në Prishtinë, më 1911, m'u këtu është mbajtur, në këtë hapësirë, procesi dhe gjithashtu likuidimi dhe ekzekutimi. Në Prishtinë, gjithashtu më 1947 procesi, Gjon Sereqi, e tjerë. Përsëri eliminime e likuidime. Dhe mos të përmendim, paradigmat shtohen në kuadrin e Prishtinë me Adem Demaçin dhe sot proceset e gjeneralëve.

Zotri Kadi, mua më kujtohen shumëmirë nga literatura franceze, proceset e shumta që nga Revolulcioni borgjez francez e deri te Procesi shumë i famshëm i kapitenit të ri Drejfys, që e detyron inteligjencën frenge dhe Zolën të hidhet në luftë për mbrojtjen e të drejtës dhe të vërtetës. Ai Procesi Drejfus ka qenë dhe është zbuluar pas dhjetë viteve të vuajtjes, vuajtjeve të tij dhe të vetë Zolës, doli si proces i montuar nga antisemitët francez dhe Gjermania. Mos shifni ju këtu edhe analogji procesesh, aferash me Kosovën. Unë e ndiej si intelektual veten të ndrydhur, shumë të ndrydhur. Shpeshherë e ndiej veten si ebreit dhe në pozitën e ebreitëve dikur. Këtu ju lutem drejtësia duhet me të vërtetë t'i rregullojë, të sanksionojë si duhet. Këtu

unë nuk jam kompetent këto që dëgjove, me shumë kompetencë i dëgjova se si do të organizohet ky sistem. Por, më e rrezikshmja është drejtësia me paragjykime. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fjalën e ka Muhamet Kelmendi, le të bëhet gati Berat Luzha.

MUHAMET KELMENDI:

Zonja dhe zotërinj,

Nga diskutimet e deritashme u theksuan disa çështje, për të cilat me disa tërësisht dakordohem e për disa të tjera natyrisht mendoj se janë të karakterit politik e që kanë për pikësynim, përsëri këtu nga kjo foltore të na çojnë kah statusi përfundimtar i Kosovës dhe pushtimit të Kosovës nga Serbia.

Do të mbështetem në tri çështje për të cilat mendoj se Komisioni është dashur t'ua kushtojë një vëmendje më të madhe. Çështja e parë, është çështja se shumë pak flitet për vazhdimësinë e sistemit të njëjtë gjyqësor nga e kaluara. Kemi tërësisht, në të gjitha strukturat sistemin e njëjtë gjyqësor si të kohës së Titos, pastaj të kohës së Ivan Stamboliqit, të Kohës së Millosheviqit e deri me këtë kohë kur po flasim. Mendoj se në këtë drejtim Komisioni është dashur të bëjë një analizë konstruktive të kësaj situateje dhe të shkojë nga ajo që duke bërë analiza të sistemit gjyqësor dhe të gjykatave në vende në transicion, për çka u propozua këtu, apo të shteteve në perëndim, të na propozojë dhe të dalë me një propozim të ri se si duhet të dukej ky sistem i ri gjyqësor në Kosovë. E përkrah plotësisht idenë se duhet të kemi sistem dyshkallësh, sepse pa të, është e pamundur të kemi një drejtësi të cilën e prentendon shoqëria demokratike.

Ana e dytë e çështjes, ose çështja e dytë, është fakti se në Komision, po ashtu, shumëpak flitet për anën përmbajtësore të aplikimit të ligjeve të zbatueshme. Unë kam pritur nga Komisioni që të marrë rastin konkret të Dukagjinit, të cilin e njohim nga praktika, dhe ta analizojmë në mënyrë shkencore – a kemi ne aplikim të ligjit aktual që ka qenë në fuqi këtu. Apo, kemi diskriminim dhe kemi një gjyq i cili është mbështetur kryesisht në veprimtarinë politike dhe përcaktimin politik të dënimit të këtij grupi. Apo, kemi rastin tjetër, ku po ashtu, mendoj është dashur të merret në shqyrtim, rasti i grupit të Llapit. Sepse, jemi të gjithë dëshmitarë të një shkeljeje flagrant të të gjitha formave, të gjithë sistemit, të krejt procedurës në tërësi. Në grupin e Dukagjinit kemi një aplikim të gabueshëm, të anës përmbajtësore, të neneve. Sepse mbështetet në fakte joreale dhe bëhet zbatimi joreal nga ana e gjykatësve kur dënohet grupi i tillë dhe natyrisht presim kështu të veprohet edhe në grupet tjera, sepse janë fakte të pakontestueshme që kemi të bëjmë kryesisht me gjykime dhe gjykata politike.

U tha me të drejtë këtu se nuk kemi asnjë kriminel të kapur e të dënuar, ose shumëpak. U tha me të drejtë këtu se nuk kemi asnjë krim që është kryer drejtpërdrejt në Kosovë, të kapen dhe të denohen, nga ana e regjimit njëzetë e më tepër vjeçar pushtues këtu. Kemi vetëm luftëtarë

të lirësë, njerëz të cilët kanë kontribuar dhe ata i fusim nëpër grupe dhe grupacine të ndryshme në mënyrë që në tërësi të devijohet lufta jonë e drejtë dhe me këtë ecet një rruge e cila, nuk na shpie asgjëkund, përveç na çon në konflikte të mëdha.

Krejt qytetarët tanë janë sot nëpër protesta të mëdha. Në Rrafshin e Dukagjinit ende qyetarët nuk besojnë se njerëzit e lirisë janë dënuar. Edhe në Rrafshin e Kosovës dhe në vende tjera. Kjo e obligon Kosovën dhe Kuvendin, zoti kryetar, që pikërisht këto demonstrata, këto protesta t'i analizojnë në mënyrë më thellësuar kur është fjala për gjykimet e tilla që po zhvillohen. Sepse, jemi të zgjedhur nga këta qytetarë dhe duhet mendimet e tyre t'i aplikojmë në mënyrë që të ecim përpara.

Fakti i tretë, nëse më lejohet edhe dy minuta, është shumë pak e bërë analiza e shkollimit. Edhe pse këtu u tha se është shkruar. Po ne kemi qenë në Komision dhe kemi parë shumë gjykatës të propozuar nga Komisioni i tillë, i cili është dalë nga ky Kuvend, që nuk kanë pasur provimin e jurisprudencës. Ky Kuvend nuk ka dhënë pajtueshmërinë dhe megjithatë janë vendosur si gjyqtarë. Dhe ana tjetër, për mendimin tim, është ana morale. Është një shkelje e rëndë. Dhe ne kemi gjyqtarë në të gjitha segmentet, në të gjitha strukturat e sistemit gjyqësor të Kosovës ku kanë punuar gjyqtarë të sistemit të vjetër dhe kanë dënuar shqiptarë me 10, 15, 100 apo edhe me shekuj, siç u tha këtu. Prandaj, mendoj se Komisioni duhet të bëjë një analizë më të thuktë të këtyre problemeve për të dalur para neve këtu, para qytetarëve të Kosovës dhe për të thënë – ku janë gabimet. Pse kemi gjykata politike? Pse lejohet kjo formë e ecjes përpara dhe pse bëhen këto shkelje kaq të rënda të të gjitha vlerave të popullit shqiptar dhe të popullit të Kosovës.

Duhet t'më lejohet që t'i bëj katër propozime:

Nuk duhet të shkojmë vetëm nga nxjerrja e ligjeve që rregullohet materia penale, por duhet të shkojmë edhe nga nxjerrja je ligjeve që rregullojnë materiet civile, ato ekonomike, sociale dhe të familjes. Ne kemi probleme jashtëzakonisht të mëdha në fushën pronësore-juridike, ku një pronar i cili ka humb të drejtën e pronësisë para 30 vjetëve paraqitet përsëri pronari i asaj çështjeje. Dhe që të kemi gjykata të pavarura me sistem të pavarur, duhet të kemi ligj, dhe që pajtohem, të të gjitha fushave.

Ana e dytë, është se duhet të ushtrohen kompetencat dhe të barten kompetencat në tërësi tek organet tona, pajtohem me atë.

Dhe ana e tretë është, duhet të ndërtojmë gjykatën kushtetuese, ku të gjitha organet duhet t'i nënshtrohen asaj, sepse pa të dhe pa këtë gjykatë nuk mund të ndërtojmë një sistem gjyqësor të mirëfilltë.

Lus Komisionin ose organet kompetente në analizat e mëtejshme të marrin në shqyrtim të domosdoshëm shembujt e sistemeve gjyqësore në gjykatat e vendeve në transicion dhe domosdo në Evropën Perëndimore, përsëris këtu Republikën Federale të Gjermanisë, Austrinë e vende të tjera, sepse kanë treguar mjaft sukses se si duhet të ndërtohet një shoqëri demokratike, se si duhet të ndahen tri shtyllat kryesore të ndërtimit të shteteve demokratike,

pa të cilat unë mendoj se ne nuk mund të pretendojmë se jemi dhe do të shkojmë kah ndërtimi i një shoqërie të tillë. Ju uroj sukses.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Berat Luzha dhe le të bëhet gati Liljana Keniq. Do të thotë, heqni dorë nga diskutimi, por e dorëzoni me shkrim, zoti Berat? Ju falemnderit. Le të bëhet gati Bajrush Xhemajli.

BERAT LUZHA: (Diskutim i dorëzuar me shkrim)

Mendoj se të gjithë po pajtohemi se gjendja në gjyqësinë e Kosovës është shumë e rëndë. Këtë gjendje e përshkruan madje edhe Raporti i Grupit punues por edhe materialet tjera që na kanë ardhur. Nga ana tjetër, gjyqësinë, si të gjitha lëmitë tjera, po e përëcjellin probleme të mëdha, si mungesa e hapësirave të punës, mungesa e kuadrove, problemet materiale, mungesa e kompetencave, veprimi paralel i gjykatave serbe në pjesën eriore të Kosovës, por edhe veprimi i disa gjykatave paralele «kosovare» në Serbi, etj.

Ndërtimi i sistemit gjyqësor kosovar pas luftës, si duket, ka filluar së parpthi, duke i zbatuar ligjet e ish jugosllavisë dhe duke futur në gjykata kuadro, të cilat kanë zbatuar në të kaluarën e errët ligjet diskriminuese antishqiptare të regjimeve diktatoriale jugosllave. Ligjet e një shteti që tashmë nuk ekziston, të një shteti të huaj dhe të një shteti armik e kthejnë Kosovën prapa, në skëterrën e kaluar, të cilën e krijonin pikërisht këto ligje, këto gjykata dhe këta gjykatës. Këto ligje, të ashtuquajtura të zbatueshme janë jokompatibile me kohën dhe me realitetin në të cilin jetojmë, janë në kundërshtim me synimet për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe pengojnë drejtpërdrejt zhvillimin e gjyqësisë së pavarur të Ksoovës. Sepse nuk mund të ketë gjyqësi të pavarur dhe demokratike me ligje të diktaturës, të diskriminimit, të apartheidit dhe të gjenocidit.

Si rezultat i zbatimit të këtyre ligjeve, sot në Kosovë kemi gjykata, të cilat nuk janë efikase, të cilat gjykojnë pjesëtarë vetëm të një përkatësie kombëtare, të cilat nuk i gjykojnë kriminelët e njohur të luftës, të cilët u ikin shqyrtimit të lëndëve të nxehta. Si rezultat i zbatimit të këtyre ligjeve, sot në Kosovë lulëzon hapur krimi, vrasjet, droga, prostitucioni... Nga ana tjetër kemi dështime të njëpasnjëshme të proceseve të monutara gjyqësore. Rasti i fudnit është dështimi i procesit të montuar politik në Prizren. Kurse, kriminelët dhe terroristët e vërtetë, të cilët gjatë luftës kanë bërë krime që dihen nga të gjithë, për ironi lirohen, dënohen simbolikisht apo edhe arratisen fare nga buzrgjet. Kriminelët e vërtetë sot shëtisin të lirë nëpër Kosovë dhe nëpër Serbi, madje shpesh të përcjellur nga njësitë e pollicisë ndërkombëtare dhe të KFOR-it. Ata janë të vendosur edhe në për poste të rëndësishme në kierarkinë shtetërore. Nga ana tjetër, si rezultat i zbatimit të këtyre ligjeve, kriminelët kërkohen gjetiu, aty ku nuk janë, kërkohen në mesin e atyxre që me guxim iu kundërvunë dhunës dhe na sollën këtë pak liri. Në këtë mënyrë, njerëzit tanë më të mirë dënohen politikisht, me ish ligje të huaja dhe nga gjykatës dhe ish gjykatës të huaj.

Duke zbatuar ligje të huzaja dhe duke mos ndërtuar sistem gjyqësor demokratik, ligjor dhe humanitar, gjykatës dhe prokurorë janë bërë edhe aso «profesionistësh», nënshkrimet e të cilëve janë të hudhura në qindra aktvendime gjyqësore në të kaluarën tonë të zezë jo aq të largët. Madje, profesionistë të tillë janë emëruar edhe në oroganet më të larta gjyqësore, si në Këshillin gjyqësor Prokurorial, në Gjykatën Supreme, në gjykatat e qarkut dhe ato komunale, si është rasti me Tadej Rodiqin, Osman Tmavën, Miftar jasiqin, Avdi Dinajn, Tomisllav petroviqin e shumë të tjerë.

Është shpresëdhënës fakti se së shpejti do të miratohen dy ligjet e para penale, të lejuara për miratim. Me këtë shpresojmë se do të fillojë ndërtimi i një sistemi të mirëfilltë[demokratik në gjyqësinë kosovare.

Çka duhet bërë:

- Të fillojë bartja e kompetencave të rezervuara te institucinet vendore e dhe në këtë lëmi.

- Të formohet ministria e drejtësisë apo, së paku për fillim, një departament i përbashkët mes UNMIK-ut dhe Qeverisë së Kosovës, i ngjashëm me ish departamentin e drejtësisë të këshillit të përkohshëm administrativ;

- Të miratohen edhe ligjet tjera penale me prioritet në Kuvend, apo, së paku, të nxirren rregullore të përkohshme të UNMIK-ut, të cilat do t'i zëvendësonin ligje te zabtueshme;

- Të shpërbëhen të gjitha gjykatat dhe organet tjera paralele në këtë lëmi;

- Të luftohet me prioritet krimi, t'i shpallet luftë prostitucionit, drogës;

- Të parandalohen vrasjet dhe të zbardhen të gjitha vrasjet ende të pazbuluara;

- Të verifikohet lista e gjykatësve dhe e prokurorëve nga Kuvendi;

- Të kthehen në Kosovë të gjitha dosjet e plaçkitura të institucioneve, sidomos të gjykatave dhe prokurorive.

(Berat Luzha)

LILJANA KENIĆ:

Poštovani predsedniče Skupštine, poštovani poslanici,

Oko Izveštaja o pravosudnom sistemu na Kosovu i metohiji ja pre svega želim da kažem da cenim i poštujem trud ove Komisije i autora samog Izveštaja ali moram da kažem da je on

nekompletan, nedorećen i nedovoljan za sagledlavanje stanja u pravosudnom sistemu ali je i često tendenciozan.

Osvrnula bih se i najviše na poglavlje 5. gde gospodja objašnjava o primenjivim zakonima na Kosovu. Kaže, na samom dnu, 5. strane, stoji zaključak da je primenjivanje zakonodavstva koje bila na snazi 1999. godine faktički vrača Kosovu u 89.godinu i tako dalje. A posebno, krivični zakoni, ne samo da potiču iz perioda socijalističkog poretka nego su i zakoni strane države koja sada i ne postoji. Izraz - strana država, za mene je vrlo uvredljiv izraz. Prejudicira odredjena pitanja neprimerena trenutku pa ni samom Izveštaju koji bi trebalo da pretenduje na kvalifikovani i profesionalni osvrt o pitanjima pravosudnog sistema.

Zatim kažete, hoćete zakone u gradjansko-pravnoj oblasti, hoćete zakon o svojini. Pretpostavljam da su u primeni jugoslovenski zakoni koji vi želite da uklonite. Ali, zaboravljate činjenicu da ti propisi u sebi nose osnov Austrijskog gradjanskog zakonika i Francuskog koda civila i ostalih izvornih propisa na kojima se temelji i svo zakonodavstvo naprednih evropskih zemalja. Zakonodavstvo o kome govorimo i danas ima punu podršku i priznanje najeminentnijih pravnih stručnjaka Evrope.

Zatim, dalje govorite oko primene, kažete da sudski organi sude prema medjunarodnim standardima. Ja bih to naravno najradije volela. S tim u vezi, želim da vam kažem i da kada su u pitanju konvencije, medjunarodne konvencije i medjunarodni sporazumi, želim samo da vas podsetim da je Jugoslavija prihvatila sve medjunarodne konvencije i sporazume, ratifikuje ih, kao i sve ostale strane i inkoorporira ih u svoje nacionalno zakonodavstvo. Samim tim, učinjeno je, i stvorena je mogućnost neposredne primene tih odredaba.

Dalje bih, pohvalila bih, kao što rekoh, tabellarni pregled, koji je dat na kraju izveštaja. Vrlo lepo i slikovito je prikazano stanje. Primedba je, nema prevoda na srpski jezik ali ima i nedostataka. Niste naveli nasledjene predmete iz prethodne godine, broj novih predmeta kao i podatke o broju nerešenih na kraju izveštajnog perioda koje treba obavezno istači i podatak o načinu rešavanja predmeta i njihovoj daljoj sudbini. Dakle, da li su podnete žalbe na te odluke? U kom broju i odluke više sudske instance po tim uloženim žalbama.

Sa ovakvim primedbama, došlo bi se u situaciji da se tek tada rad organa može detaljno sagledavati i utvrditi ukupna ocena o vrednosti ostvarenoj u protekloj godini. Tome bi trebalo dodati i identičan pregled svakog izvržioca ponaosob jer se samo tako može kvalitativno donositi i ta ocena i ceniti njegova podobnost za rad u pravosudnim organima, kvalitet sudjenja, o čemu u ovom ponudjenim izveštaju ne govori ni reč. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Bajrush Xhemajli, le të bëhet gati Fadil Kryeziu.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Të nderuar të pranishëm,

Ne disi jemi të prirë që të ankohemi në kompetenca që s'i kemi në UNMIK-un, për gjyqësinë por edhe për çështje tjera, ndërsa vetë fajin ta heqim apo të them ashtu figurativisht t'i lajmë duart si pilati antik, atëherë. Mandej, zonja Kelmendi mendoj se ka bërë një apologji që të gjithë ata që punojnë në gjyqësinë vendore t'i duartrokasin, nëse janë duke shikuar televizionin.

Unë pikërisht do të flas diçka për ata që kanë dorë në pjesën e gjyqësisë vendore dhe mendoj se iu përket jo të vajtojnë por t'i zgjidhin lëndët gjyqësore. Por këto lëndë gjyqësore nuk zgjidhen duke i shërbyer politikave të caktuara në shërbim të fushatave elektorale dhe të shkohet aq larg sa pistat të gabohen qëllimisht dhe të hetohet në pista të porositura. Bëhet kështu sepse gjyqësia në Kosovë ende nuk është në shërbim të qytetarëve, e as që mund të bëhet fjalë për një gjyqësi të pavarur, u tha edhe këtu më herët, por gjyqësi në shërbim të politikave të vjetra, po e potencoj – të vjetra, në rrethana të reja, me po atë staf të vjetër gjyqësie. Ja shihni, është po i njëjti gjyq i procedurës penale, po të njëjtit prokurorë, po të njëjtit gjykatës dhe po të njëjtit hetues dhe për më tepër ata bashkëpunëtorë denoncues që i kanë shërbyer politikës serbe për të bërë dosje për ata që kanë luftuar okupatorin më parë veç se tani kanë marrë një detyrë të re, një rol të ri të them ashtu, në rrethana të reja, kështu që tani bëjnë dosje për çlirimtarët e Kosovës qoftë për t'i dërguar në Hagë, qoftë të bëjnë dëshmi të rreme sipas porosisë së politikave të caktuara për gjithësesi antishqiptare apo edhe antinjerëzore, të them dhe në bashkëpunim me Beogradin, çka është më e keqja.

Dhe, krejt në fund, gjyqësia e Kosovës së re nuk mund ta bëjnë njerëzit pa asnjë kredibilitet moral e profesional dhe për më tepër ata të cilët për keqpërdorim detyre ka qenë dashur, po e potencoj, të ulen në bankën e të akuzuarit pasi kanë dënuar njerëz me porosi për dekada me radhë, madje ai që sot ta zëmë udhëheq me Këshillin Gjyqësor Prokurorial të Kosovës ka nënshkruar sipas porosisë edhe dënimin me pushkatim. Janë shumë mirë të njohura ato, po të mos flasim për proceset e montuara. Dhe, pse pikërisht ata zgjidhen në krye të gjyqësisë. U përmend këtu që s'ka kuadra. Po pse pikërisht ata? Kjo është çështja.

UNMIK-u nga ndikimet politike vendore ka bërë përzgjedhjen më të keqe të mundshme kadrovike. Janë eliminuar që në start njerëzit e perspektivësh gjyqësore. Ne s'na është dhënë ajo çka ka qenë dashur të jipet, 180 e diçka aplikantë, prej të cilëve një herë janë zgjedhë 90, për të intervistuar e pastaj janë zgjedhë 40 dhe mendoj se janë zgjedh më të dobtit e mundshëm. Është thënë këtu, si shembull po e marr konkretisht se çka është zgjedhë. Është zgjedhë ta zëmë, thot i ka ndërrue tri nacionalitete brenda 90-shës e këndej, ka thënë mos gabofsha zoti Kelmendi prej Mitrovice a s'di kush prej deputetëve. Do të thotë, njerëzit e kalibrit të tillë janë zgjedhë dhe s'paska pasë njeri tjetër me u zgjedhë por njerëzit që janë taman ashtu që konvenon si ta dojë nevoja.

Unë mendoj se Kosovës së re, i duhet një gjyqësi e reformuar rrënjësisht, tha zoti Bajram Kosumi që pajtoj plotësisht, me njerëz të ri në udhëheqje, që janë energjikë dhe pa hipoteka,

që iu beson dikush, për qytetarë dhe që mund të krijojnë një gjyqësi të papolitizuar dhe të pavarur. Sllloganet gjyqësi e pavarur, e tjera për fushatë elektorale vërtetë janë joshëse por deri sot plotësisht të varur i kemi zgjedhur. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fadil Kryeziu, le të bëhet gati Xhelal Canziba.

FADIL KRYEZIU:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Unë nuk jam jurist dhe kam më vështirë të flas ose t'i qasem këtij problemi në këtë drejtim, por t'ju them të drejtën as që kam menduar të flas për këtë temë, ngase kam pritur prej kolegëve që i kemi me shumicë pothuaj në këtë Parlament që temës së rendit të ditës t'i qasen në mënyrë adekuate. Aty është e qartë, pra raporti mbi gjyqësinë në Kosovë. Ndërkaq, në fakt këtu ... flasim për drejtësinë. Për mendimin tim të merresh me çështjen e drejtësisë duhet kohë, duhet punë dhe këtë që nga shekujt dhe deri më sot ende deri në fund nuk i kanë dalë në krye. Këtë e them, ose ndoshta do ta parafrazoj një fjalë të popullit – se kurrë nuk na bjen taman asgjë. Në këtë drejtim dua të them dy fjalë. Të gjithë parafolësit e mij folën për drejtësi, se si drejtësia duhet të jetë e pavarur. Merre nga cilidokënd qoftë por të gjithë tërhoqën ngapak për vete. Domethënë, diçka që duhet pra t'u takojë më tepër këtij grupi, atij grupi, atij etniteti, apo këtij etniteti, pra përdorimi ndoshta i do çelësave të së kaluarës, prej të cilave të gjithë ne kemi vuajt dhe mbi të gjitha do të thosha shumëpak iu qasen profesionalitetit në drejtësinë, pra edhe në gjyqësinë, konkretisht kosovare.

Në këtë dërejtim, unë do të shtroja disa çështje që për mua edhe në kohën kur kemi vendosë të shqyrtojmë këtë çështje dhe të ftojmë zotin Zhan Kadi ne nuk kemi vendosur të ftojmë, që është dashur të ftohet këtu, edhe kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të sjellë problemet, të sjellë të arriturat, të sjellë pengesat, të sjellë pra edhe varësinë e gjyqësisë në Kosovë, nga vjen ajo, pse është ajo e pranishme. Këtu nuk është i pranishëm as kryeprokurori i Kosovës, nëse ka Kosova kryeprokuror, po flas, për njerëzit tanë vendorë që janë në këto punë. Pse nuk u është dhënë mundësia që ata këtu para nesh të sjellin problemet, të sjellin të arriturat, pra të sjellin edhe pengesat.

E treta, Komisioni për zgjedhjen e gjyqtarëve për të cilin neve në vazhdimësi kemi folur edhe herave tjera, kur na është dhënë rasti, a është Komision i përjetshëm apo si është zgjedhur dhe deri sa do të zgjasë mandati i tij.

Çështja e pavarësisë së gjyqeve. Pavarësia e gjyqeve dhe e gjyqtarëve në kuadër të kushteve në të cilat ne jetojmë, pra ngre dilema të shumta te të gjithë ne. U tha këtu se gjyqet nuk janë të pavarura. Unë kam dilema në këtë drejtim. Le të jetë se ato janë të varura nga UNMIK-u, nga ndonjë strukturë e ciladoqoftë ajo, nga cilido kënd që vjen, por edhe janë jo të pavarura

edhe nga mosprofesionaliteti apo nga frika e gjyqtarëve, apo nga ngjyrimi politik i gjyqtarëve, apo nga veprimet tjera që vijnë në drejtim të gjyqeve tona. Për këtë flasin shumë argumente, flasin dështimet e gjykimeve, flasin pra arrestimet e personave që dalin në gjykim dhe shpallen të pafajshëm. Pse mbahen ata në burg kur janë të pavajshëm. Dhe gjyqësia ndërkombëtare ka provuar duke na sjellur gjyqtarë nga bota e jashtme, pra nga bota ndërkombëtare dhe të gjithë ata pothuaj në të gjitha proceset deri në këtë rast kanë dështuar. Çfarë mësimi ne mund të nxjerrim nga kjo drejtësi ndërkombëtare? Për fat të keq ,mendoj se qasja ndaj së drejtës, që u tha këtu, pra është një qasje e tejkaluar më dhe për fat të keq ne nuk kemi alternativë më të mirë, sepse nuk kemi rast të shohim gjyqësinë, pra edhe gjermane, kur edhe Helmut Koli akuzohet dhe dënohet. Ku është efikasiteti edhe i gjykatave tona.

Çështja tjetër që këtu nuk u shtrua dhe besoj se është faji pikërisht te ne, është çështja edhe e provimit të judikaturës. Ne shohim përditë se njerëzit tanë, juristët tanë dalin në këto provime, dalin në provime pra edhe me intervenime që vijnë madje edhe nga qarqet e larta apo institucionet tona. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Xhelal Canziba, le të bëhet gati Blerim Baruti.

XHELAL CANZIBA:

I nderuar kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Se gjyqësia në Kosovë ka rënë në provim, kjo shifet çdo ditë. Për këtë u tha shumëçka dhe këtu nga parafolësit. Unë desha ta vë theksin vetëm në një segment të gjyqësisë në Kosovë. Përkundër deklaratave verbale se gjyqësia duhet të jetë e pavarur, do të thotë edhe e depolitizuar. Realiteti ka treguar se është e kundërta. Gjyqësia është një instrument shumë i padenj në duar të politikës. Është thënë shumëherë se është një tentim për të balancuar krimin në mes të viktimës dhe xhelatit, gjë që kjo tendencë është krim në veti. Por realisht është shkuar shumë më larg se balancimi i tillë, pasi sot jemi dëshmitarë se kemi dy kute për matjen e drejtësisë: një për serbë e tjetri kut për shqiptarë, në dëm të shqiptarëve. Ja, për shembull, shqiptarët mbahen në burg me të ashtuquajturin urdhër ekzekutiv, të Përfaqësuesit Special të KB në mungesë provash siç është rasti i Afrim Zeqirit nga Cërnica e Gjilanit. Kurse, serbët e inkriminuar u falët faji ende pa i burgosur, siç është, ta zëmë rasti i Millan Ivanoviqit, i cili edhe tani kërcnohet me formimin e ushtrisë serbe në Kosovë. Pastaj, i sh kryetari i komunës së Rahovecit, Angjellko Kollashinac, dënohet me 8 vite burg me akuzën për krimet në deportimet e shqiptarëve prej shtëpive të tyre, duke ditur që në rrethin e Anadrinisë janë vrarë diku një mijë qytetarë. Kurse, rasti i gjeneralit Salih Veseli, dënohet me dhjetë vjet burg me akuzën qesharake – tentimnxitje për vrasje, dhe raste tjera.

Gjykuar në bazë të numrit të të burgosurve, del se sikur gjithë ato varreza masive në Kosovë i kanë bërë shqiptarët e jo serbët. Pastaj nga burgu i Mitrovicës ikin mbi 40 serbë të akuzaur për krime dhe askush nuk shqetësohet për këtë. Edhe sot, me urdhërin ekzekutiv, kinse të rrezikshëm po të gjenden në liri, mbahen në burg komandant Maliq Ndrecaj e Fatmir Mehmeti e të tjerë.

Prandaj, kësaj praktike të drejtësisë, me dy kute, duhet dhënë fund njëherë e përgjithmonë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Blerim Baruti, le të bëhet gati Teuta Hadri. Shumë mirë, tërhiqeni pra.

BLERIM BARUTI:

I nderuar krkyetar, Kryesi e punës, ministër, zoti Zhan Kadi dhe deputetë të nderuar,

Sistemi i juridikaturës në Kosovë, pas periudhës së okupimit shekullor, kolonizimit, apartheidit dhjetvjeçar, gjenocidit, dhe afër katër viteve pas mbarimit të luftës është në situatën çfarë është. Dokumentacini para luftës është i shkatërruar dhe i plaçkitur nga forcat serbe. Edhe pas kësaj kohe, sot në Kosovë, veprojnë organet e jurisprudencës jashtë institucioneve të UNMIK-ut. Edhe pse sipas vendimeve të UNMIK-ut kompetente janë vetëm gjykatat e formuara nga ai, prapëseprapë me ndihmën e organeve të Serbisë e ndoshta edhe me bekimin e disa përgjegjësve të UNMIK-ut në pjesët veriore të Kosovës si në Zveçan, Albanik, Zubin-Potok veprojnë oroganet paralele të gjyqësisë. Sot mekanizmi institucional i vetëm që punon në lagjet veriore të qytetit të Mitrovicës janë organet e jurisprudencës dhe atë: gjykata e qarkut, prokuroria publike e qarkut, gjykata komunale, prokuroria publike komunale dhe gjykata komunale për kundërvajtje. Edhe pse në kushte të vështira të jashtëzakonshme, duke iu falënderuar moralit të lartë dhe angazhimit të madh të udhëheqësve, gjyqtarëve, prokurorëve dhe të peronelit tjetër punues të këtyre organeve me guxim të madh mund t'ju bind se ata me sukses po i kryejnë detyrat e tyre.

Pas luftës, përgjegjësit e sigurisë në Kosovë kanë inicuar procedurë penale për krime lufte gjenocid dhe krime të tjera në Kosovë, ku afër 50 serbë janë arrestuar dhe ndaj tyre është ngritur akuzë. Gati të gjithë kanë qenë në Burgun e Qarkut të Mitrovicës ku nga ky burg janë arratisur 43 serbë të akuzuar për krime lufte. Ky burg nuk kontrollohet nga vendorët.

Shqetëson fakti se nuk po bëhen hetime të mjaftueshme për kryerësit e veprave kriminale. Kryerësit e këtyre veprave kanë jetuar apo ende jetojnë nëpër enklavat serbe nëpër Kosovë.

Prokurori ndërkombëtar ka hequr dorë nga ndjekja e mëtejme për rastin e krimeve të bëra në natën në mes 2 dhe 3 shkurtit të vitit 2000 ku janë vrarë 13 shqiptarë të pafajshëm në lagjet veriore të qytetit të Mitrovicës, ndër sytë e ndërkombëtarëve.

Xhandarmëria françeze ka krijuar dosje për krime lufte të cilat dosje i ka mbuluar pluhuri dhe se akoma nuk është zhvilluar procedurë në këto dosje. Kërkojmë që prokuroritë mos ta zvarrisin më dhe procedojnë në procedimin e këtyre lëndëve. Ka patur edhe shumë raste të tjera që nuk janë ndriçuar: Kidnapimi dhe zhdukja e Sylë Sadikut; vrasja e 15 vjeçarit Gazmend Ibrahimit, si dhe plagosja e 7 të rinjve shqiptarë e boshnjakë të Lagjës së Boshnjakëve në Mitrovicë.

Brengosë fakti se nuk kemi të qartë çështjen e Millan Ivanoviqit, i cili është i akuzuar për tentim ndaj forcave paqëruajtëse më 8 prill të vitit të kaluar, me ç'rast kanë pësuar plagë të rënda 22 paqëruajtës polakë, të cilët tentonin vetëm ta mbanin rendin. Kjo bëhet kështu me faktin se procedurën e zbatojnë të tjerët. Shqetësuese është argumenti se zhagitet procedura sipas kallëzimit penal kundër kriminelit Cvetiq i cili ka qenë urdhërdhënës i masakrës së Prekazit dhe i masakrave tjera të bëra në regjionin e Mitrovicës. Po ndërlidh këtë rast me keqpërdorimi ne detyrës zyrtare të prokurorit paralel të qarkut Millan Bigoviq i cili hudhi poshtë kallëzimin penal të famkeqit Cvetiq, mirëpo megjithatë prokurori legjitim inicioi procedurën kundër Millan Bigoviqit për keqpërdorim të detyrës.

Derisa në Shtëpinë ndëshkimore korrektuese Dubrava të paraburgosurit kanë drejtë vizite nga 4 persona njëkohësisht në kohëzgjatje prej 60 minutash, qendra hetuese ne Mitrovicë lejon vizitën e 2 personave në kohëzgjatje prej 20 minutash. Në qendrën hetuese në Mitrovicë iu cungohet e drejta e vazhdimit të marrëdhënies së punës të 8 punëtorëve të cilët kanë mbi 20 vjet përvojë pune në këtë institucion. Kurse në anën tjetër, në fillim të këtij viti, i kanë pranuar gardianë të ri. Drejtori i qendrës ka pranaur t'i pranojë 27 gardianë mitrovicas që punojnë në burgjet tjera e që më parë kanë punaur pranë këtij institucioni duke i kushtëzuar që ata në punë të vijnë si të dijnë në lagjet veriore të qytetit të Mitrovicës kur nuk ka qarkullim të lirë. Pra, pa iu siguruar transport, sikur të gjithë tjerëve. Përndryshe, këta ish punëtorë të burgut, i janë drejtuar edhe Ombduspersonit të Kosovës, zotit Marek Anton Novickit për këtë çështje. Megjithëse shumica e të paraburgosurve në këtë institucion janë shqiptarë, i tërë personeli mjekësor atje përbëhet nga serbët me në krye neuropsikiatren Radmilla Jeftiq. Gjatë bisedave me avokatët e Mitrovicës, ata shprehën pakënaqësinë e tyre në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë sepse varej nga disponimi i policëve për t'i transportuar gjer në burg. Ju falemnderit për mirëkuptim dhe vëmendje.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Replikë, Dragisha Kërstoviq. Le të bëhet gati Gani Prekopuca.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Ja hoću da zamolim da ova rasprava bude usmerena u jednom pravcu koji će da doprinese poboljšanju stanja u kosovskom pravosudju. Isprovociran sam diskusijom oba prethodna poslanika od kojih jedan nalazi da se prema Srbima izriču veoma blage kazne u sudjenjima kod kosovskog pravosudja i da se pominju brojna imena. Mislim da je ocenjivanje pojedinih slučajeva, pojedinačnih slučajeva sa ove govornice je zloupotreba ove govornice. Jer, budite uvereni, da svaki okrivljeni i svaki osudjeni nema svog poslanika ovde da bi štitio njegove interese i njegov slučaj. Prema tome, mislim da to nije dobro i da takvu praksu utreba izbeći i govoriti o nekim opštim aspektima kosovskog pravosudja i borbi da se to kosovsko pravosudje dovede u red i da daje neke rezultate i neke efekte podjednako za sve zajednice i za sve ljude koji žive na ovom prostoru.
Ja hoću da demantujem one koji tvrde da paralelni sudovi još rade. Ono što neko radi tamo van Kosova to je nešto što se može zvati sud i ne mora, i po mom shvatanju, to nije sud. Na Kosovu više nema paralelnih sudova. Dakle, konstituisani su i sudovi u Leposaviću i u

Zubinom potoku. Samo je pitanje trenutka kada će oni neposredno poćeti da rade i na predmetima.

Ja se zalažem da se mi zborimo za nezavisno i za profesionalno sudstvo i mislim da nećemo imati problema koji sada imamo u pravosudju Kosova. Ako budemo pominjali imena, i ako budemo pominjali pojedine slučajeve, mislim da nećemo daleko otići od onog stanja u kojem se sada nalazimo. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të falemnderit Dragishë. Ilaz Pireva dhe le të bëhet gati Rangjell Nojkiq.

(D. Krstoviq, prej vendi: Predsedniče, samo jedna intervencija. Imamo intervenciju, da ovi koji imaju pisane materijale, malo sporije da čitaju, zbog prevoda)

Atëherë, pak më ngadalë, Ilaz. Urdhëroni..

ILAZ PIREVA:

Unë përkrah Raportin e Komisionit për legjislacion dhe gjyqësi. U muar vesh, kanë bërë një raport brenda mundësive që kanë pasë, sepse unë konsideroj, edhe në bazë të asaj që kam lexuar në të, disa fusha kanë mbetur edhe të paprekura. Sidomos rreth mënyrës së trajtimit të të rinjve nëpër shtëpitë tona korrektuese, duke u nisur prej të gjitha atyre veprave të cilat i kanë kryer apo s'i kanë kryer, por konsideroj që këtu është një çështje mjaft e ndieshme dhe duhet të jetë për neve edhe mjaft e ngutshme.

Unë një çështje s'e kam të qartë këtu. Kur merren ligje te aplikueshme, kur merret ai 23 marsi i 89-shit diçka sikur është bërë një kthesë, po them, dhe t'i kthehemi prapë asaj gjyqësie, atyre ligjeve, për mua do të ishte e papranueshme sidomos tash katër vjet pas luftës e cila përfundoi në Kosovë.

Një, ku qëndron ndryshimi i ligjeve pas 23 marsit kur është rrëzuar autonomia, e dijmë pse dhe ajo autonomi çfarë ishte dhe ligjet që ishin para 23 marsit. Para 23 marsit, u përmend këtu edhe nga të tjerët, me ato ligje, në mënyrën më drakonike janë dënuar të rinjt tanë por jo vetëm të rinjt por të gjithë dhe atë në mënyrën më të rëndë. Me atë ligj, kam qenë me atë ligj në izolim, me ligjin pas 23-shit të 89-shit vetëm e kam vazhduar rrugën pak më gjatë, unë jo, por më kanë detyruar në Leskofc. Aty është ndryshimi i atyre ligjeve, pra para 23-shit dhe pas 23 marsit të 89-shit. Kemi procesin e montuar të 75-shit, ku ka lulëzaur ajo autonomi, që dikush ka menduar, kur le të urdhërojnë të gjithë gjykatësit, juristët, profesorët këtu, t'i shikojnë ato lëndë, ka proces më të rëndë se i 75-shit prej 45-shit e këndej dhe deri në ditët e sotme. Prandaj, të kthehemi prapë në ato ligje dhe tash katër vjet kur bëhen, vërtetë uni kisha për ta bërë një pyetje këtu për zotin Zhan Kadi që të shihet pse ende sot e kësaj dite zbatohen ligjet e ashtuquajtura të aplikueshme.

Prandaj, u tha këtu edhe nga të tjerët, është një detyrë shumë e ngutshme, sepse njerëzit na kuptojnë për të gjitha këto vështirësi. Vetëm një nuk na kuptojnë: të shkelet mbi ta, në emër të disa ligjeve, nuk e kuptojnë dhe nuk na e falin. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Para se ta marrë fjalën Rangjell Nojkiq, një sqarim. Gjatë kohës së pauzës që do ta kemi pas fjalës Kadi, shefat e grupeve parlamentare, edhe koordinatorja dhe kryetari i Komisinit përkatës edhe një herë këto rekomandime le t'i shqyrtojnë pastaj do t'i aprovojmë. Ndërsa, ju lutem jo pyetjet për zotin Kadi por ai është duke na dëgjuar lidhur me Raportin e punës të Komisionit që ka punuar gjatë dhe nga ajo të përmbledhë një përvojë se si nuk duhet të procedohet në të ardhmen. Urdhëroni...

RANDJEL NOJKIĆ:

Zahvaljujem se gospodine predsedniče, radno predsedništvo, gospodine Kadiju, dame i gospodo,

Ja mislim da pojedinačna istupanja za ovom govornicom su zaista zloupotrebljena i oni zaista čini mi se prejudiciraju neke stvari. Mislim da je prošlo vreme kada je moglo samo da se uperi prstom i da se kaže, pogotovo kada su u pitanju Srbi, i da se kaže ovaj je kriv, on je ratni zločinac i da se po prekom postupku odvede u zatvor i da sprovede godinu-dve i da bi dokazao na kraju krajeva da nije kriv. Mislim da se i ovog puta prejudicira i poziva se na ime jednog uglednog Srbina, jednog vrlo važnog političara, jednog političara koji ima veoma-veoma veliki ugled u Srpskoj zajednici tojest gospodina Milana Ivanovića i ja se nadam da i predstavnici suda i predstavnici iz medjunarodne zajednice neće ovo iskoriste kao ponovni atak na gospodina Milana Ivanovića. Postoje materijalni dokazi i na osnovu materijalnih dokaza gospodin Milan Ivanović je na slobodi. Te prema tome, molim vas, nemojte da upućujete paušalne optužbe i pre svega mislim da ne bi smelo da se upućuju ovakve poruke koje uopšte ne doliču ovakvom forumu. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Hamiti, i fundit dhe pastaj Zhan Kadi, le të bëhet gati.

SABRI HAMITI:

Të falemnderit zoti kryetar,

Ne sot po bisedojmë për një temë shumë të ndieshme, tepër të rëndësishme për zhvillimet në Kosovë. Kjo sepse ka pasoja në shumëçka, në zhvillimet përpara, tash dhe ajo që do të vijë.

Ne kishim përpara një Raport që për mendimin tim ishte shumë i argumentuar, një bazë shumë të mirë, i cili dilte si sublimim i kërkimeve empirike në fushat e ndryshme të gjyqësisë në Kosovë. Pra, ajo që duket si tekst i ndërtuar, me të vërtetë është tekst totalisht i mbështetur në të dhënat që na japë shansin që për problemin të flasim në mënyrë substanciale. Gjithmonë kur flitet për drejtësinë, sidomos tene, mund të flitet duke u pasur parasysh tradita e të këqiave në të kalurën dhe duke pasur parasysh që ajo trashigimi po del edhe këtu. Mua më duket që edhe mënyra e të folurit është e bartur po ashtu, sepse kalon duke artikuluar përvojën në të kaluarën të këqija, faktikisht del këtu i artikuluar si përvoja personale dhe më duket se në këtë fazë të bisedimeve për gjëra të rëndësishme për Kosovën nuk është shumë e kështillueshme që të shpalosim përvoja personale, as unë për veti e as kërkush tjetër, sepse njeriu nuk mund të dalë nga bota e vet e brendshme, por në këtë rast duhet t'i shohim përgjithësimet.

U tha, nuk ka gjyqësi të pavarur në Kosovë dhe është provuar në pika të ndryshme që kjo të dokumentohet. Nuk ka gjyqësi të pavarur, sigurisht, aty ku ekziston një autoritet çfarëdoqoftë ai që nënvihet ose mbivihet. Unë them se s'ka gjyqësi të pavarur aty, as kur si autoritet politik artikulohet mbi të një pushtet vendor, qoftë ai i Kosovës, as një pushtet i UNMIK-ut, po as ... Domethënë, nëse pranojmë pavarësinë e gjyqit, ky duhet të jetë pavarësi totale, jo me primesat politike ose parapolitike të cilat si doni quani cilatdo anë të jetë. Sepse atëherë relativizohet termi. Dhe, kërkesa jonë këtu është që të ndërtohet gjyqësia e pavarur nga gjithëçka tjetër. Kjo ka mundësi të ndërtohet, unë kujtoj, vetëm me krijimin e sistemit të brendshëm të gjyqësisë. Dhe, unë kam lexuar atë kornizë me të cilën punojmë dhe unë kam pa që në pikën 5.3, prej a) deri në i) janë pjesë, është e përshkruar një punë në gjyqësi që nuk e ka emrin minsitri e drejtësisë por përkah substancialiteti i detyrave i përshkruan të gjitha ato. Dhe, unë kujtoj se është koha, bash duke u mbështetur në përgjegjësi që u ipen organeve ose institucioneve tashmë të Kosovës, të ndërtohet ministria e drejtësisë. S'ka kurrfarë arsye që të kërkohet rishikim i atyre që po quhen kompetenca a përgjegjësimarrje. Vetëm le të zbatohet ajo që është në Kornizën kushtetuese, ajo jap mundësi që të ndërtohet ky ekzekutiv në Kosovë dhe unë mendoj pa u ndërtua ky asnjë nga këto probleme, për të cilat po bisedojmë ne, nuk do të zgjidhet, as në nivelin e organizimit të gjyqësisë, as të prokurorëve, as të nivelit të gjyqtarëve, as të sprovës së tyre, as ta quajmë edhe biografisë së tyre sepse s'ka shansë me u bë ajo. Vetëm në këtë mënyrë bëhet dhe vetëm në këtë mënyrë atëherë merren përgjegjësitë direkte për mënyrën e organizimit të kësaj lëmie fundamentale për zhvillimet e lirive të njerëzve dhe të zhvillimit të Kosovës.

Prandaj, unë mendoj që ajo që është bërë në rekomandimet e një kërkimi shumë të mirë empirik të Komisionit të veçantë për gjyqësinë, edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës i përkrah ato rekomandime. Sepse, më duket që edhe diskutimi ynë deri këtu për asnjë pikë nuk ka dalë jashtë tyre, por është brenda esencave të tyre. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Profesor Hamiti, ju falemnderit. Fjalën e ka Zhan Kadi, zëvendësadministrator ndërkombëtar.

Report on the Status of the Judiciary: December 2002 to April 2003

INTRODUCTION

Mr. Chairman, I would like to express my thanks for this invitation to present a status report on the Kosovo Judicial System to the Kosovo Assembly. I have asked the new Director of the Department of Justice, Mr. Paul Coffey, to join me in this presentation and he is available to answer questions. I would like to speak about the progress we have made in the establishment of the judiciary and to comment on the Report of the Committee on Legislation, Judicial and Constitutional Framework Issues.

An independent, effective, impartial and competent justice system is an essential part in establishing a stable and democratic society in Kosovo. It is therefore one of UNMIK's top priorities. I will address four points which have been common threads of all the discussion today which are the independence, multi-ethnicity, impartiality and competence of the judiciary.

An Independent Judiciary

In working towards this goal, it is necessary that the system for recruitment and appointment of judges and prosecutors also be independent and impartial. The Kosovo Judicial and Prosecutorial Council (KJPC) is an independent body which is responsible for advising the SRSG on the recruitment and appointment process. The KJPC is composed of 5 international legal professionals and 4 Kosovan legal professionals. It receives applications of candidates and conducts the initial selection process then short-lists candidates and recommends them for appointments as either prosecutors or judges to the SRSG through the Kosovo Assembly. I would point out that Regulation 2000/8 gives the SRSG final authority in the appointment process. The procedures is perhaps better said in Rule 15 of the Provisional Rules of the Assembly: Upon receipt of recommendations from the KJPC, the Assembly has 10 working days to submit the cases to the SRSG with its endorsement, advice or observations. The Assembly does not have

decision-making or veto power, or the ability to amend the recommendations. If the Assembly does not take action within 10 days, the SRSG can make appointment on his own. This happened last time but this does not mean that the judges and prosecutors were appointed illegally. The Assembly has no blocking power, but can provide essential advice.

Let me quote the position expressed by Ms. Kelmendi in her report on the State of the Judicial System in Kosovo: the "principle of separation of judicial power from the executive and legislative [must] be respected". I fully endorse this position and this is very much our guideline. Judges are now being appointed for the duration of the UNMIK mission. After UNMIK, judges will be appointed for life. The independence of the selection process from the political arena, therefore, is crucial to providing a strong foundation for an independent judiciary.

As of 27 March 2003, there is a total of 312 judges and a total of 43 prosecutors working in the Kosovo judicial system. They work in a total of 57 courts, including one commercial court in Pristina. To support court administration and work, there are 1284 court staff. To enhance the efficiency, impartiality and overall functioning of the judicial system, additional judicial personnel have been recruited during the past three months, including members of minority communities.

I should point out that per capita, there are roughly 19 judges and prosecutors per 100,000 inhabitants, and 2.85 courts per 100,000 inhabitants, which is close to European standards.

Despite the high proportion of judges, prosecutors and courts to population, however, there remains a significant backlog of cases currently pending in local courts: 13,700 civil cases, 495 administrative cases and 11,700 criminal cases. It is clear that we must continue to improve the efficiency of operations within the justice system. In this effort, the role of the local staff and judiciary is of tremendous importance as it is the local judiciary that deals with the bulk of justice.

During the past three months, the local judiciary dealt with 100 percent of civil and more than 97 percent of criminal cases and is handling seven cases involving organized crime. 78% of criminal proceedings resulted in convictions. The rule of law is being respected. All suspects have been brought before a judge within the legal time limit of 72 hours. The percentage of detainees whose pre-trial detention exceeds six months, however, remains high. At the beginning of April, out of 575 pre-trial detainees, 152 have been in custody for more than 6 months and 96 have been in custody between 3 and 6 months. The prison population as of 3 April 2003 was 1282.

During the debate, there was mention of the executive orders of the SRSG. Now, no one is detained because of an executive order. Executive orders were more useful at the beginning of the mission when the judicial system was not up and running. There is not as much justification now when there are local and international judges, who are, I should say, doing a good job. So though the possibility of executive order still exists, in practice there are none.

A Multiethnic Judiciary:

Establishing the judicial system of Kosovo is not just a question of the numbers of judges and prosecutors and support staff. It is important that the justice system reflects the different values and needs of the community it represents. The composition of the judiciary therefore should reflect all the components of its society so that every Kosovan feels that his or her interests are represented and therefore trusts the judicial system. Thus UNMIK considers multi-ethnicity within the judiciary to be a guiding principle. In the latest vacancy, there were 34 new appointees, out of which 13 were Serbs. As I previously mentioned in my presentation to you in January, this was significant step towards this goal.

Currently, Kosovo Serbs comprise almost five percent of all judges and two percent of all prosecutors. Other minorities (Turkish, Bosniac and Roma) comprise 5.5 percent of all

judges and 7 percent of all prosecutors. Among the court staff, 93 percent are Albanian, 4 percent Serb, 3 percent other minorities (Turkish, Bosniac, Roma, Ashkali, Croat). We need to continue our efforts to make the judiciary a better mirror of the ethnic diversity of the Kosovo society.

An Impartial Judiciary:

Let me now deal with the impartiality of the judiciary. One of the essential characteristics of the judicial system we are creating is that it be neutral. The public must have confidence that cases are being handled in an impartial manner whatever the ethnicity of those involved or whatever the nature of the case. This is also why I do not think it is appropriate at all to discuss the ethnicity of this or that case. Let us leave it to the judges and by doing so pay tribute to their impartiality.

In July 2001, the Kosovo Judicial and Prosecutorial Council (KJPC) developed Codes of Ethics for Judges, Prosecutors and Lay Judges which were adopted in December 2001. These Codes create transparent guidelines for the conduct of judiciary, codify respect for international human rights standards and thus foster public confidence in the judicial system. Breaches of these codes by judges or prosecutors can trigger investigations by the Judicial Investigation Unit and result in sanctions proposed by the KJPC. But I would like to pay tribute to the great majority of Kosovo judges and prosecutors who are often subject to pressure, and even physical pressure, and I have one particular case in mind, and who remain neutral and impartial.

UNMIK also recognizes that the development of an independent and impartial judiciary in Kosovo is still at a relatively early stage. In order to complement the local judiciary, UNMIK has **27** international judges and prosecutors (IJPS) who deal with the 3-4% of serious criminal cases where:

- The local judiciary would be too vulnerable to threats and intimidation to be expected to deal impartially with certain kinds of cases: organized crime, war crimes; or
- When there is a real risk of perception of bias in cases involving inter-ethnic crime

One should be aware that you do not have internationals on one side and Kosovans on the other. They work together in close cooperation and therefore I fully agree with the observations of Ms. Kelmendi on this, (and she knows it very well having been a part of it herself), that the relationship between international and local judges and prosecutors has been fruitful, and supports the strengthening of such contacts, anticipating the evolution of the role of IJPS towards greater mentoring, monitoring, and oversight of some cases. We shall move progressively towards this.

A Competent Judiciary:

But we also need a fully competent judicial system, and this is my fourth point I wanted to mention. The quality of Kosovo's system is largely dependent on the professional competence of judges and prosecutors.

The Kosovo Judicial Institute was created by OSCE in order to build professional capacity. It has been performing training seminars on an ad hoc basis, with a strong emphasis on criminal law. We need to go beyond that and have taken two courses of action.

The first consists of modifying our recruitment process. All potential candidates for judges and prosecutors will have to pass an examination.

The second consists in giving an initial training to all newly appointed members of the judiciary. This includes training in new laws, and basic courtroom and case management

skills. With this initial education of judges and prosecutors, we should have better qualified members of the judiciary.

Let me now deal with an issue mentioned today and badly resented: the Applicable law which is the law in 1989 in so far as it complies with international law. I know it is a difficult situation. The problem is that we did not arrive here with a kit of new legislation in our suitcases. We had a choice: no laws or this system. As we wanted to avoid a legal vacuum we made the choice of using the existing laws in so far as they complied with human rights standards and international law. And we corrected things immediately with Regulations, and we are moving forward. The Codes of Criminal Law and Criminal Procedure, which were provided to you last week, are very important. This is the law of Kosovo. The old law is becoming more a thing of the past, once these Codes are passed. And we will need some training of judges, local and international, because they will not know it. I envision about 6 months of training.

So Mr. Chairman, ladies and gentlemen, in concluding my report on the status of the judiciary, I would like to emphasize two things. The first is that we have within the Kosovo judiciary remarkable people who are competent and impartial, and who have a strong commitment towards establishing justice in Kosovo. They have shown courage and dedication and should be praised further.

The second element is that we started from scratch three years ago and there is still considerable room for improvement if we want to meet European standards. In terms of multi-ethnicity, even-handedness towards communities, efficiency of the judicial system, more work needs to be done and more progress achieved.

Thank you.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Kadi, ju falemnderit për kontributin e dhënë shumë të vlefshëm. Do ta bëjmë tani një pauzë deri në ora 13,30 dhe pastaj do të vazhdojmë dhe aprovojmë rekomandimet e paraqitura. Ju falemnderit.

Pas pauzës, seanca vazhdoi punën.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Deputetë të nderuar, po vazhdojmë punën.

Pas një debati të frytshëm përmbajtësor, mbi gjendjen në gjyqësinë e Kosovës dhe pas përkrahjes maksimale në diskutime për Raportin dhe rekomandimet, s'na mbetet asgjë tjetër, por t'ju ftoj që me një votë formale ta aprovojmë Raportin me rekomandimet për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës.

Kush është për, le ta çojë dorën. Le të numërohen votat, ju lutem.

Kushështë kundër?

A abstenon ndokush?

Së pari t'ju them se të pranishëm në sallë janë 67 deputetë.
Le të numërohen votat dhe sidomos ato që janë kundër.
Më lejoni ta shpallim rezultatin e votimeve dhe atë:

- 15 vota kundër,
- 06 abstenime,

Prandaj, konsideroj se janë aprovuar Raporti dhe rekomandimet në raport.

Votimi – Glalsanje – Voted:

Për –Za – For.....Shumica – Većina - Majority
Kundër – Protiv – Against.....15.....
Abstenime – Uzdržanih – Abstaned.....06.....

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës të seancës së sotme: **Shqyrtimi i Raportit për personat e humbur dhe të kidnapuar.**

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit Flora Brovina. Urdhëroni zonja Brovina.

FLORA BROVINA:

Së pari, më lejoni që personalisht të shpreh keqardhjen që kjo pikë e rendit të ditës nën numër dy, që ishte e paraparë nën numrin një - u bë nën numrin dy, sepse tani nuk marrin pjesë edhe ata nga Departamenti i Drejtësisë dhe duhej të dëgjonin, dhe, e dyta, për arsye të rrespektit ndaj personave të rrëmbyer dhe të humbur gjatë luftës në Kosovë.
Komisioni për personat e rrëmbyer dhe të humbur gjatë luftës në Kosovë ka bërë përpjekje që të njihet drejtpërdrejtë me problemet dhe pengesat që kanë familjarët në ndriçimin e fatit të personave të rrëmbyer dhe t'i evidentojë këto dhe t'i paraqesë para jush.
Komisioni për këtë arsye ka mbajtur mbledhje të rregullta javore me asociacionet e familjarëve dhe me asociacionet ndërkombëtare e të vendit që merren me këtë problematikë dhe këto janë: Zyra për personat e zhdukur pranë UNMIK-ut, pastaj Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, Këshilli i të Drejtave të Njeriut, Kryqi i Kuq i Kosovës dhe, siç thash, asociacionet e shumta të familjarëve anëembanë Kosovës.

Komisioni ka organizuar takime studimi në terren. Për këtë arsye kemi vizituar Institutin e Mjekësisë Ligjore në Rahovec, ku ndodhen mbi 400 kufoma të paidentifikuara e që pritet identifikimin. Kushtet, atje, janë shumë të pavolitshme dhe në këtë Institut punojnë vetëm 2 ekspertë të mjekësisë ligjore dhe asnjë nga vendorët dhe sipas asaj që vrejtëm, atëherë duhen vite dhe vite për t'u identifikuar ata që ndodhen aty dhe të mos flasim për personat tjerë që pritet të identifikohen nëpër varrezat e pazbuluara.
Komisioni, gjithashtu ka vizituar Institutin Mjekoligjor të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë ku ka zhvilluar bisedime me ekspertët vendorë me qëllim që të shihen problemet pse ekspertët vendorë nuk janë të angazhuar gjatë ekspertizave, zhvarrimeve dhe identifikimit të kufomave qoftë në Kosovë qoftë në Beograd. Na erdhi mirë që atje hasëm në një bisedë shumë konstruktive dhe në mirëkuptim dhe nga kjo bisedë rrodhi angazhimi i ekspertëve vendorë që të marrin pjesë, pa marrë parasysh kushtet dhe rrethanat, që nuk janë në favor të tyre, natyrisht dhe të angazhohen në identifikimin e personave të zhdukur qoftë në Kosovë, thash, qoftë në Serbi. Ekspertët tanë, tani, të paktën me një përfaqësues, janë angazhuar në Zyrën për Personat e Zhdukur pranë UNMIK-ut.
Kryetarja, domethënë, unë personalisht, kam marr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur që është mbajtur gjatë muajit shkurt të këtij viti në Gjenevë, e organizuar nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Në Konferencë është biseduar kryekëput për personat e zhdukur kudo në botë dhe rezultat i këtij takimi ka qenë Deklarata finale që u aprovua në këtë Konferencë nga përfaqësuesit e shteteve të

ndryshme dhe organizatat joqeveritare që merren me problemin e personave të zhdukur.

Moto e këtij takimi ishte: Të zhdukurit dhe familjet e tyre, e drejta për të ditur. Parimet kryesore të Deklaratës janë: Çdo familje ka të drejtë të dijë për fatin, vendin dhe shkakun e vdekjes së më të dashurve të tyre. Autoritetet qeveritare kanë përgjegjësi nga se dijnë dhe duhet të dijnë për zhdukjen e njerëzve të rrëmbyer dhe për fatin e tyre. Duhet të rrespektohet dinjëteti njerëzor nga të gjitha palët dhe në çdo situatë. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet në mënyrë që të rrespektohet tradita kulturore, sociale, fetare dhe tradita kombëtare e personave të zhdukur dhe familjeve të tyre.
Gjatë këtij takimi, pata rastin të takohem edhe me familjarët serbë të Kosovës, të cilët aty mermin pjesë, në përbërje të Delegacionit nga Serbia, dhe natyrisht që propozimi im ishte, nëse ata e njohin shtetin e Kosovës, t'u drejtohen komisioneve gjegjëse qoftë qeveritare qoftë Komisionit parlamentar për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë.

Dihet se sot kërkohen afër 4.000 persona të rrëmbyer e të zhdukur gjatë luftës dhe për të cilët familjet e tyre ende nuk kanë asnjë informatë se ku ndodhen. Shumica prej tyre janë rrëmbyer nga policia, nga ushtria dhe nga forcat paramilitare të kontrolluara nga shteti i Serbisë. Njerëzit u rrëmbyen në shtëpi, në rrugë, në tregje e kudo tjetër dhe u zhdukën pa asnjë gjurmë. Ata ishin civilë, të rinj, pleqë, gra e fëmijë, por kishte edhe ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të zënë rob të luftës. Për disa dihet se u maltretuan, u rrahën, u dhunuan, u masakruan, u ekzekutuan, madje u nxorrën edhe nga varrezat dhe u zhdukën. Dihet gjithashtu se një numër i të rrëmbyerve humbi pa gjurmë. Disa i lyen edhe me materie kimike dhe ua dhanë flakën e i dogjën. Shumë nga njerëzit dhe kufomat e rrëmbyera u dërguan në Serbi. Në varret masive në serbi ka afër 900 kufoma të shqiptarëve të Kosovës e të varrosur në varrezat masive në Batajnicë, në Petrovo-sello, Bajina-Bashta dhe të tjera. Dihet se disa kufoma u hodhën në Danub. Ky akt quhet gjenocid, krim i shumëfisht, krim kundër njerëzimit. Për këtë gjenocid ndaj popullit shqiptar as sot e kësaj dite nuk është ngritur asnjë aktakuzë kundër kriminelit Millosheviq, para për gjenocidë, thash, kundër bashkëpunëtorëve të tij dhe kundër shtetit të Serbisë nga institucionet e Kosovës. Dëshmitë për gjenocid ende ndodhen në Serbi, në varrezat masive. Atje ndodhen edhe shumica e kryerësve të drejtpërdrejtë të krimeve në Kosovë, e të cilët shëtisin të lirë.
Prej themelimit të Komisionit për personat e rrëmbyer gjatë luftës në Kosovë dhe të pagjetur ende, ballafaqohet me probleme të ndryshme. Me mijëra familjarë sot vuajnë dhe kanë ankth të thellë për mëse 4.000 persona të zhdukur, të rrëmbyer dhe të humbur gjatë luftës në Kosovë. Gjendja shpirtërore e familjarëve të personave të rrëmbyer është shumë e rëndë. Ata jetojnë në një ankth të papërshkruar. Ata nuk mund të gjejnë qetësi dhe të pajtohen me fatin e tyre, pasi që ende nuk është gjendur asnjë gjurmë për më të dashurit e tyre.
Mosgjetja e më të dashurve u shkakton poshtërim, fyerje dhe vuajtje. Atyre dhe shoqërisë sonë, ua zhvlerëson marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve dhe brezave të ardhshëm. Prandaj, kërkohet të bëhen hapa konkretë për ndriçimin e fatit të secilit veç e veç.

Duke marrë parasysh instrumentet e zbatueshme të të drejtës ndërkombëtare, të të drejtës humanitare, rezolutat e Kombeve të Bashkuara familjet kanë të drejtë të dijnë për fatin e më të dashurve të tyre të rrëmbyer. Kanë të drejtë të dijnë ku gjenden, a janë të gjallë. Nëse ka të vdekur, si është shkaktuar vdekja e tyre? Kush e bëri krimin? Ku i kanë varret? Dihet se ekziston adresa e saktë se ku mund të gjenden këto informata. Kjo është Qeveria e Beogradit. Ata u rrëmbyen në mënyrë institucionale, me plan të hartuar për gjenocid kundër popullit shqiptar të Kosovës. Ende nëpërkëmbet fati i të rrëmbyerve. Qeveria serbe e din se një numër i madh i tyre u rrëmbyen dhe morën të gjallë. Çka ndodhi me ta? Ku gjenden? Sa për përkujtim, t'i kujtojmë pengjet e luftës të cilat u gjendën në burgjet e Serbisë. T'i kujtojmë vëllezërit Bytyqi, që u pushkatuan në burgjet e Serbisë. Ku janë të tjerët?
Pas vrasjes së Gjingjiqit, u vërtetua se ekzistojnë kampe dhe burgje private në Serbi, të ashtuquajtura pra private, sepse dihet që këto forca paramilitare, që e vranë edhe Gjingjiqin, ishin fort mirë të kontrolluara nga Qeveria e Beogradit. Këto burgje, pra, kanë qenë të drejtuara nga formacionet policoro-mafioze të Serbisë dhe po këto formacione kanë vepruar edhe në Kosovë gjatë luftës dhe pikërisht në ato regjione të Kosovës prej nga ka më së shumti të rrëmbyer dhe të zhdukur. Ne deri tash nuk kemi asnjë përgjigje lidhur me krimet, pra të kryera në Kosovë nga këto formacione.

Duke u lidhur me kërkesën e serbëve për kthim të organizuar në Kosovë, duhet të kihet parasysh edhe tragjedia dhe ankthi i mijëra familjarëve që presin ndriçimin e fatit të më të dashurëve të tyre të rrëmbyer dhe të humbur, pa asnjë gjurmë Komisioni ka konstatuar se - Zyra për Personat e Zhdukur pranë UNMIK-ut deri më tash ka bërë shumëpak ose aspak për ndriçimin e fatit të tyre dhe ajo ka qenë e vetmja përgjegjëse dhe më kompetentja për ta bërë këtë. Zyra e UNMIK-ut për personat e zhdukur, si organ përgjegjës për këtë çështje, nuk ka qenë sa duhet transparente e të tregojë më shumë mirëkuptim dhe bashkëpunim edhe me shoqatat dhe institucionet tjera, siç është, për shembull Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur dhe Komisioni ynë.
Komisioni ka vërejtje për mospërfshirjen e ekspertëve të mjekësisë ligjore të Kosovës në procesin e zhvarrosjes dhe të identifikimit të kufomave në Serbi por edhe në Kosovë, si dhe pjesëmarrjen e asociacioneve humanitare për të drejtat e njeriut të Kosovës, ekspertëve juridikë dhe ekspertëve të tjerë që janë të domosdoshëm gjatë zhvarrimit dhe identifikimit. Arsyeja se ne nuk kemi ekspertë të tillë, nuk qëndron. Sepse për katër vjet, edhe po të merrej një nxënës i shkollës së mesme, mund të përgatitej të bëhej ekspert vendor.
Çështja e të rrëmbyerve dhe të të humburve gjatë luftës duhet të jetë transparente, humanitare dhe për këtë të ketë kompetenca dhe përgjegjësi edhe Parlamenti i Kosovës, edhe Qeveria, edhe Presidenca.

Duhet të nxirret ligji për mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe ligji për mbrojtjen institucionale të familjeve të tyre.

Prandaj Komisioni, në bazë të Raportit dhe sigurisht edhe diskutimeve, propozon që të nxirret një rezolutë nga Kuvendi dhe:

- që Kuvendi i Kosovës të shprehë shqetësimin që gjatë katër viteve, pas përfundimit të luftës në Kosovë, ende nuk dihet për fatin e afër 4.000 personave të rrëmbyer dhe të zhdukur pa gjurmë si dhe të shprehë shqetësimin për gjendjen e rëndë të familjeve të tyre;
- që Kuvendi, Presidenca dhe Qeveria dhe institucionet e të gjitha niveleve ta ngrisin çështjen e të rrëmbyerve në çdo takim dhe bisedë me palën ndërkombëtare dhe të vendit;
- që bashkësia ndërkombëtare, Kombet e Bashkuara, duke përfshirë edhe Këshillin e Sigurimit dhe vetë Sekretarin e Përgjithshëm, pastaj Shtetet e Bashkuara, duke përfshirë edhe vetë presidentin e Shteteve të Bashkuara, Bashkësinë Evropiane, e të tjera të ndihmojnë për ndriçimin e fatit të të rrëmbyerve gjatë luftës në Kosovë që ende janë të pagjetur;
- që bisesdimet me Serbinë të kushtëzohen me ndriçimin e fatit të të rrëmbyerve;

- që Qeveria, sa më parë, të hapë zyrën e ekspertëve vendorë për ndriçimin e fatit të të rrëmbyerve dhe përkujdesjen e familjeve të tyre në mënyrë që kompetencat për këtë çështje nga Zyra për Personat e Zhdukur të UNMIK-ut të kalojë tek organet vendore qeverisëse;
- që të bëhet trysni më e madhe, në mënyrë që të përshpejtohet procesi i identifikimit të viktimave të luftës;

- që të formohet një arkivë e posaçme për të rrëmbyerit dhe të zhdukurit në Kosovë;
- që Kuvendi të formojë një grup ekspertësh për ngritjen e padisë pranë Tribunalit Ndërkombëtar të Hagës për krimet e luftës kundër njerëzimit në ish jugosllavi dhe për akt të gjenocidit të kryer në Kosovë – kundër Millosheviqit, kundër bashkëpunëtorëve të tij dhe kundër shtetit të Serbisë;

- që ekspertët vendorë të mjekësisë ligjore, juristët, antrpologët dhe njohësit e të drejtave të njeriut nga Kosova të marrin pjesë në identifikimin e viktimave;

- që varrimi i viktimave të jetë dinjëtoz, në bazë të traditave familjare, etnike, fetare dhe nën mbikëqyrje institucionale;

- që të punohet në ndërtimin e një kompleksi ose muzeu, si do që të quhet, ku do të ruheshin gjërat personale të gjetura të viktimave të luftës;

- që të përcaktohet me ligj statusi i personit të rrëmbyer dhe të humbur gjatë luftës dhe të drejtat e familjeve të tyre.

Ju falemderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Zonja Sanije Alijaj. Le të bëhet gati Stojanka Petkoviq.

SANIJE ALIJAJ:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Unë jam anëtare e Komisionit për personat e kidnapuar dhe të humbur dhe plotësisht pajtohem me Raportin e punës së Komisionit dhe me dokumentin apo rezolutën që do të hartohet pas debatit të bërë në këtë Parlament. Mirëpo, kam dalur këtu t'i paraqes, në fjalën time, disa fakte të cilat Serbia i ka shkaktuar gjatë luftës popullit të Kosovës.

Natyrisht, në pjesën e dytë të fjalës sime, do të bëjë përpjekje që t'ia bëjë disa sygjerime Komisionit parlamentar në punën e ardhshme dhe zyrës së Qeverisë që do të insistojmë të formohet pranë Qeverisë së Kosovës.

Dhuna shtetërore e Serbisë, në dekadën e fundit kundër Kosovës, mori përmasa të gjenocidit etnik kundër popullit shqiptar të Kosovës. Masat që vlerësohen si krime kundër njerëzimit, që i shkaktoi policia, ushtria dhe paramilitarët serbë deri më datën 23 mars të vitit 1999, po e theksoj edhe një herë – deri më 23 mars të vitit 99 janë: vrasja dhe masakrimi i 1.885 civilëve të vrarë, kryesisht gra e fëmijë; djegia deri në themel e 27.882 shtëpive; djegia dhe shkatërrimi i 446 vendbanimeve; si dhe dëbimi i 502.360.000 banorëve nga 346 fshatra, të cilat mbetën të boshatisura.

Dhuna e okupatorit, u ashpërsua me metodat më gjenocidale kundër popullatës civile në Kosovë prej datës 24 mars të vitit 1999, kur filluan bombardimet e NATO-s. Në këtë periudhë, Kosova ishte në një shtetrrethim ushtarako-policor të okupatorit me të gjitha forcat që pati në dispozicion. Si pasojë e veprimeve të tyre barbare, janë shkaktuar pasoja që tmerruan njerëzimin. Të vrarë janë mbi 12.000; të zhdukur mbi 3.600; janë të dhunuara me qindra femra, kryesisht vajza të reja, për çka konsideroj se është krimi më i shumtuar dhe më i dhembshëm, sepse këtyre krijesave jo vetëm që iu shkaktoi dhembje fizike e psiqike por i shkatërroi tërësisht deri në themel edhe familjet e tyre. Janë të evidentuara 30 vendbanime, ku janë kryer krime masive, duke filluar nga 10 qytetarë të pafajshëm e deri me mbi 300. Janë të dëbuar mbi 900.000 shqiptarë. Shtëpi të djegura janë 122.775 - me vlerë financiare mbi 14 miliard, të pallogaritura dëmet e shkaktuara në objektet shoqërore. Fshatra të djegura janë 1.007.

Mirëpo, sot në Parlamentin e Kosovës po shtrojmë një çështje ndër më të dhembshmet: kidnapimi dhe humbja e mbi 3.600 qytetarëve që lanë pasveti mijëra familje pa asnjë lajm lidhur me fatin e të afërmëve të tyre.

Pjesëtarët e familjeve të të humburve, duke mos ditur asgjë për fatin e të dashurve të tyre, jetojnë me shpresë dhe dëshprim.

Komisioni parlamentar për personat e kidnapuar dhe të humbur, punën e vet e bën në bashkëpunim me kryefamiljarët, të cilët kanë pasur fatin që të kenë të humbur nga më të dashurit e tyre. Vetëm një orë të qëndrimit dhe të veprimit me ta, mjaftojnë që dy-tri ditë njeriu të mos qetësohet në shtëpi. Pjesëtarët e familjeve të të humburve, duke mos ditur asgjë për fatin e të dashurve të tyre, jetojnë në mes të shpresës dhe dëshprimit.

Anëtarët e Komisionit parlamentar, punuan në favor të familjeve të të humburve dhe të kidnapuarve me qëllim që t'u ndihmojnë në ndriçimin e fatit të të afërmëve të tyre. Pritja për familjarët është gjithmonë tepër e gjatë, kurse vuajtja dhe pasiguria është një agoni për ta. Deri më sot, qasja ndaj të kidnapuarve dhe të të zhdukurve nuk ka qenë adekuate.
Pas nxjerrjes së rezolutës, që do të bëhet sot në Parlament, pritet të ngritet problemi në nivelin më të lartë si të institucioneve vendore ashtu edhe të atyre ndërkombëtare në mënyrë që të vihet deri te rezultatet konkrete, sepse deri sot kemi fare pak rezultate konkrete në këtë drejtim.

Ne jemi të vetëdijshëm se për të ardhur deri te rezultatet konkrete, duhet ngritur problemin shumë seriozisht në institucionet ndërkombëtare të vendosjes në mënyrë që ndriçimi i fatit të të zhdukurve të kushtëzohet te Qeveria e Serbisë me zhvillimet ekonomike dhe integrimet ndërkombëtare.

Si hap konkret shumë të domosdoshëm, është që Qeveria të hapë një zyrë për personat e humbur, në mënyrë që të ekzekutohen nismat që i merr Komisioni parlamentar dhe Kuvendi.Qeverisë, institucionet ndërkombëtare të vendosjes, së bashku me zotin Shtajner, ta detyrojnë Qeverinë aktuale të Serbisë që të jetë transparente – ku janë njerëzit e zënë peng; ku janë kufomat e vjedhura të tyre; ku janë varrezat masive në Serbi; të detyrohet t'i hapë dosjet dhe arkivat dhe të bashkëpunojë me Tribunalin e Hagës; t'i lejohet që UNMIK-u dhe Tribunali i Hagës të kenë qasje të lirë në hulumtimin e lokaliteteve ku supozohet se mbahen ende të gjallë të kidnapuarit dhe të humburit. Konsideroj se vetëm kështu mund të kontribuohet në drejtim të paqës dhe stabilitetit në rajon.
Komisioni parlamentar dhe zyra e Qeverisë të pajisen me prova materiale për kryerjen e krimeve; të formohet dokumentacioni për personat e humbur dhe të kidnapuar. Zyra e Qeverisë të kërkojë nga organet gjyqësore të ngrisë aktakuzë për gjenocid për të gjitha rastet veç e veç.

Ne kuptojmë përpjekjet e vullnetarëve për kthimin e serbëve, të cilët ikën me plotë të mira të plaçkitura. Edhe pas luftës, të pasuruar me shitjen e shtëpive të tyre, edhe nga dy-tri herë. Por, në radhë të parë, prioritet duhet t'u jipet kthimit të njerëzve të rrëmbyer, nëse janë të gjallë dhe kthimit të mbetjeve të kufomave të të humburve. Qeveria e Serbisë duhet të detyrohet ta bëjë këtë sepse me elaborate institucionale i shkaktoi qytetarëve të Kosovës këtë fatkeqësi të papërballueshme.

Qeveria duhet të ketë një program, konkretisht zyra e Qeverisë, me qasje profesionale në mënyrë që të investohet në radhë të parë për ata që janë të gjallë dhe varrimin dinjëtoz për ata që identifikohen si të humbur.

Shumica e familjarëve që kanë pësuar tragjedi, janë femra, si kryefamiljare, të cilat kujdesen për ngritjen e fëmijëve të tyre me plotë vështirësi dhe varfëri. Problemet e traumave të njerëzve, problemet juridike, sociale, të punësimit dhe kujdesi për fëmijët e këtyre familjeve kërkojnë zgjidhje urgjente nga Qeveria e Kosovës. Konsideroj se

nxjerrja e një fletushke apo një reviste për botimin e rasteve shumë të dhembshme, është një çlirim për familjarët dhe shumë i nevojshëm për Kosovën. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Sanije, ju falemnderit shumë.

Deputetë të nderuar, dëgjuam dy diskutime shumë të argumentuara. Unë shpreh bindjen tuaj që është çështje më e dhembshme që kemi patur për një vit e gjysmë. Për t'u dhënë mundësi të gjithë atyre që janë paraqitur për diskutim, ju lutem të tjerët ta rrespektoni kohën.
Fjalën e ka Stojanka Petkoviq, le të bëhet gati Mevlyde Saraçi.

STOJANKA PETKOVIĆ:

Poštovani predsedavajući, gospodo poslanici,

Na samom početku naglasila bih da je sam naziv Komisije neprihvatljiv. Iz prostog razloga, što se u njemu ne predvidjaju kidnapovana i nestala lica pre rata i nakon rata odnosno nakon dolaska medjunarodne zajednice na prostorima Kosove i metohije. Rekla bih da Izveštaj ove Komisije ne sagledava realno stanje sudbine kidnapovanih i nestalih lica svih nacionalnih zajednica na ovom prostoru.

Naime, u Izeštaju se pominje 3.600 nestalih Albanaca. Optužuje se Vlada Srbije; vojska jugoslavije i srpska policija. O sudbini srpskih stradalnika, pominje se samo u jednoj jedinoj rečenici – u preporukama pod tačkom 5. i ništa više.

A ja vas gospodo, sada pitam: šta je sa kidnapovanim i nestalim Srbima? Šta je sa počinjenim zločinima nad njima? Šta je sa albanskim privatnim zatvorima u kojima su srpski zatvorenici mučeni i zlostavljeni? Šta je sa njihovim porodicama koje su traumatizovane i posle tri i po godine nisu rasvetljili sudbinu svojih najmiljih, njihove majke i njihove sestre. Nemaju grobove, nemaju mesto i nemaju svoje hunke gde će da ih oplakuju. I konačno, šta je sa kidnapovanim i nestalim licima nealbanskih i nesrpskih pripadnika, znači ostalih drugih nacionalnih zajednica?

Prosto nije moguće da u bilo kojem i u bilo kakvom ratu bude jednostavno stradalnik samo jedan narod ili jedna nacionalna zajednica. Vi želite pregovore sa Beogradom! Ali samo onda i u onom segmentu kada su vaši lični interesi u pitanju?! I upravo za to, zbog ovakvog jednonacionalnog i jednostranog izveštaja, koji danas ovde razmatramo, zapravo donosi još jedno produbljivanje izmedju dve nacionalne zajednice, i to nije dobro. Zbog svega toga, za nas je ovaj Izveštaj, sa ovakvim preporukama, za ovakvu deklaraciju neprihvatljiv. Ja bih pre rekla da mi danas trebamo da razmatramo Deklaraciju koja je donešena u Ženevi, jer ona, jednostavno, ravnomerno pokriva ... ravnopravnu zastupljenost ovom problemu.

Dakle, kao zaključak: samo neuključivanje kidnapovanih i nestalih Srba, nakon dolaska medjunarodne zajednice na ovim prostorima, u ovom Izveštaju predstavlja zaštitu počinioca zločina. Ovako jednostrani Izveštaj je još jedan dodatni zločin, koji je upravo počinila ova Komisija u smislu zataškavanja, prikrivanja i minimiziranja ratnih zločina koji su počinjeni nad Srbima. Hvala!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Replikë, apo...!

FLORA BROVINA:

Vetë diskutimi i zonjës parafolëse ishte tendencioz dhe në baza nacionale. Komisioni fare s'ka ndarë të kidnapuarit dhe të të humburit, domethënë, në baza nacionale. Shifra 4.000 të rrëmbyer dhe të zhdukur nuk ka të bëjë me ndasi nacionale. Të gjithë janë të Kosovës dhe këto të dhëna ne i kemi marrë nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar i cili, kujtoj, i plotëson të gjitha kushtet dhe i përmbahet Deklaratës, të cilën e ka nxjerrë vetë në takimin në Gjenevë.
Prandaj, distancohem personalisht dhe besoj edhe në emër të shumicës në Komision nga diskutimet e tilla. Neve na interesojnë të gjithë qytetarët e Kosovës dhe as në fjalimin as në paraqitje nuk patëm dallime nacionale.

Sa i përket të të rrëmbyerve, ky Komision është i përcaktuar për të rrëmbyerit gjatë kohës së luftës. Për të rrëmbyerit, që mund të ndodhin edhe sot, dhe nga çdo nacionalitet, sigurisht përgjigjen organet e gjyqësisë. Ky është dallimi.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Mevlyde Saraçi, le të bëhet gati Teuta Hadri.

MEVLYDE SARAÇI:

I nderuar kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Kuvendi i Kosovës sot po diskuton një nga pikat më të ndieshme që preokupon popullatën e Kosovës tani e katër vite më parë. Familjet e shumta në Kosovën e pasluftës zgjohen e bien në ankth, duke pritur një të vërtetë për katër mijë familjarët që u rrëmbyen të gjallë nga shtëpitë e tyre në prezencë të dëshmitarëve, që u ndalën nga kolonat e të dëbuarve, që u kapën në rrugë e gjetiu.

Qytetarët e Kosovës, që nga 12 qershori i vitit 1999 filluan të kërkojnë bijt dhe bijat e tyre me anë të protestave nëpër rrugë dhe sheshe të Kosovës, në takime me

personalitete vendore e ndërkombëtare, mirëpo, për fat të keq edhe sot e kësaj dite kjo çështje nuk u zgjidh dhe familjarët po vazhdojnë të jetojnë në këtë ankth.

Meqenëse vij nga Gjakova, përcjell mesazhet e mijëra qytetarëve, të nënave të cilët përveç solidarizimit me ta, kërkojnë që të bëjmë të pamundurën dhe të gjejmë rrugën e zgjidhjes së enigmës së personave të rrëmbyer dhe të humbur nga policët, ushtria dhe paramilitarët serbë. Tani mëlështë se pakuptimtë çfarëdo arsyeje që të fshehet e vërteta. Familjarët, por jo vetëm ata, e dijnë se lufta ka sjellur edhe fatkeqësi, mirëpo realiteti duhet të tregohet.

Zyra e UNMIK-ut për të zhdukur ka punuar dhe po punon me Serbinë në këtë drejtim. Prandaj kërkojmë që ta përshpejtojnë këtë punë dhe të janë sa më të hapur dhe të japin informata sa më të sakta. Ata ndonjëherë dijnë të dalin edhe me fjalë të pamatura duke thënë se të gjithë janë të vdekur dhe herëpasherë thonë se në mesin e tyre ka edhe të gjallë. Kjo gjë lëndon familjarët edhe më tepër, të cilët provojnë në mënyra të ndryshme të komunikojnë me matrapazë dhe profiterë të ndryshëm vetëm e vetëm që të marrin ndonjë informatë për më të dashurit. Nëse ka informacione se ka të gjallë, atëherë Zyra e UNMIK-ut duhet gjithësesi të insistojë që ata të kthehen sa më parë. Ndërkaq, varrezat masive që po përmendën dita më ditë, duhet të hapen dhe të bëhet ekshumimi dhe identifikimi i personave që i kërkojmë.
Sido që të jetë, edhe në Gjakovë, sikur është ndalur jeta. Në zemër të qytetit është ndërtuar një mur me emrat e njerëzve që i rrëmbyen të gjallë dhe i presim. Të kujtojmë 24 e 26 marsin 1999 kur u nxorrën me dhunë nga shtëpitë dhe i morën me vete të rinj e pleqë dhe i dërguan në Serbi. Kujtojmë 27 prillin e dhembshëm në Meje, me ç'rast vetëm për një ditë u ndaluan qindra veta dhe humbën pa asnjë gjurmë. Kujtojmë, po ashtu Rrugën e Çabratit, 7, 8 dhe 10 majin.

Protestat, grevat, materialet dokumentare, fotografitë, dëshmitë dhe rrëfimet janë argumente të mjaftueshme për të kërkuar llogari në Beograd dhe Qeverinë Serbe. Ata e dijnë mirë dhe kanë obligim të tregojnë të vërtetën. Ndryshe, fshehja është krim i dyfisht.
Prandaj, edhe diskutimi i sotëm dhe aprovimi i rezolutës do të obligojë të gjitha instancat që të sillen më me përgjegjësi, me theks të posaçëm, ndërkombëtarët në bashkëpunim me Qeverinë Serbe, në mënyrë që të ruhet dinjëteti i familjeve dhe të kthehen të humburit e të rrëmbyerit qoftë të gjallë, qoftë të vdekur, ashtu siç janë. Ndryshe, jeta në Kosovë është shumë vështirë që të normalizohet.

Krimet e pushtetit serb në Kosovë lanë gjurma të tmerrshme në historinë më të re të Kosovës gjatë luftës së fundit. Familje të tëra kanë mbetur pa kryefamiljarë dhe pa kurrfarë burimi të të ardhurave. Gjendja e tyre shëndetësore ka arritur kulmin kritik. Fëmijët po ashtu janë në gjendje të rëndë sociale. Ne po shpresojmë akoma se Zyra e UNMIK-ut për të zhdukurit dhe Komisioni ndërkombëtar për të zhdukur do të bashkpunojnë më ngusht me institucionet e Kosovës dhe do ta përshpejtojnë ekshumimin dhe identifikimin e personave të gjallë dhe kuptohet ekshumimin e atyre që nuk janë të gjallë.
Një gjë është e qartë. Të gjithë ata persona që i kërkojmë edhe sot, i morën të gjallë ushtarët dhe policët, bashkë me paramilitarët serbë, me urdhëra nga Qeveria Serbe në

grupe të të cilëve morën pjesë edhe shumë bashkëqytetarë serbë, të cilët u identifikuan nga familjarët e të të rrëmbyerve. Dhe për krejt atë që ka ndodh në Gjakovë dhe rrethinë, mund të sqarojë dhe të përgjigjet kryeshefi i sigurimit serb në Gjakovë Sreten Camoviq, i cili edhe sot e kësaj dite jeton i lirë dhe mban fshehtësinë e kësaj të vërtete të hidhur. Ndërkaq, masakrën e Mejes, komplet e ka inçizuar gazetari Dragan Prentiq, ndërkaq, në të janë të implikuar edhe Dragutin Josipoviq – Guta, Miçunoviqi e shumë e shumë të tjerë. Të gjitha këto shënime janë dhënë nga familjarët që kanë përjetuar tregjedinë.

Dhe, krejt në fund, do të shpreh shqetësim për pranimin e krijesës së unionit Serbi-Mali i Zi në Unionin Evropian në kohën kur në Kosovë akoma nuk dihet ende për fatin e mbi 4000 personave të rrëmbyer e të zhdukur dhe përgjegjës për këtë është pikërisht Serbia dhe Qeveria Serbe. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Teuta Hadri, le të bëhet gati Dragisha Kërstoviq.

TEUTA HADRI:

Të nderuar deputetë, i nderuar zoti kryetar,

Meqë Flora dha fjalën e vet mjaft të kompletuar për këtë pikë të rendit të ditës e po ashtu edhe kolegët tjerë, unë do të flas më shkurtimisht në mënyrë që t'u mundësojmë edhe tjerëve kolegë të debatojnë rreth kësaj pike.

Për çështjen e personave të zhdukur e të kidnapuar nga forcat policore dhe paramilitare serbe, është dashur më shumë të punohet nga Zyra e UNMIK-ut e jo të zvarritet qe plotë katër vite. Nuk e kuptoj UNMIK-un si do ta organizojë demokracinë në Kosovë kur në Kosovë po shkilen ende të drejtat themelore të njeriut. Po shkilet e drejta e nënës për ta kërkuar dhe zbuluar fatin e të birit. E drejta e gruas për ta kërkuar dhe zbulaur fatin e bashkëshortit dhe e drejta e fëmiut për ta zbuluar fatin e babait. Si do të ketë tolerancë ndaj pakicave kur shumica në Kosovë po dhunohet? Si mendon UNMIK-u ose OSBE-ja? Le ta përjetoni vetëm 5 minuta fatin e një familjeje që i është kidnapuar apo zhdukur një anëtar i familjes. Përëcillni 5 minuta këtë atmosferë në familjet tuaja dhe, besoj se do të veproni ndryshe, po të jetë anëtar i familjes tuaj. Mendoni dhe përjetoni si do të rriten këta fëmijë të këtyre personave të zhdukur e të kidnapuar, me plotë ankth në jetë dhe ëndrra për të ardhmen me anktkh. Dhe unë pyes Zyrën e UNMIK-ut çfarë është duke bërë për zbardhjen e fatit të këtyre personave kur sot ende 400 kufoma janë në Rahovec dhe presin identifikim. A mos vallë kjo pengesë i intereson Zyrës së UNMIK-ut për ta mbajtur peng Kosovën me dhunë, krime, korrupcion dhe është politikë e tij që zbaton në Kosovë... Vetëm një shembull do ta përmend. Para dy javësh në Pejë, krimineli që bëri krimet më të tmerrshme në Gjakovë Sava Stojanoviq, që ka informacion për këtë, udhëhiqte grupin

e kthimit të pakicës serbe në Gjakovë dhe në Kosovë i lejohet të përcillet nga forcat e sigurimit dhe të vijë deri në Pejë dhe OSBE-a lejon këtë para syve të saj vetëm për Savën dhe familjen e tij që ka dhunuar dhe bërë masakra në Kosovë dhe OSBE-a ka material mbi 3.200 faqe. E sot, Sava Stojanoviq, vjen në Kosovë, drejtor i spitalit të Gjakovës?!. Ka informacione se ky person ka bërë edhe masakrën ndaj kolegut të vet, ish drejtorit të spitalit - doktorit Izet Himës para syve të nënës, familjes dhe të fëmijëve. Momçillo Stojanoviq, kryetar i komunës së Gjakovës, Gjokica Stojanoviq, kryetar i këshillit ekzekutiv dhe Millan Stojanoviq, shef i sigurimit policor – katër anëtar të një familjeje që bënë krime në Kosovë! E sot, Sava Stojanoviq, vjen i përcjellur nga OSBE-a. Pyes Zyrën e UNMIK-ut për persona të zhdukur – a thua vallë nuk pati njeri tjetër nga asnjë serb i ndershëm në Kosovë që nuk kishte duart e përlyera me gjakun e bijve të popullit tanë dhe a nuk patë njerëz më të ndershëm se Sava për të ardhur dhe udhëhequr misionin për të kthyerit serbë në Kosovë? Jo. Apo dikujt po i intereson Kosovën ta mbajë nën dhunë, peng, nën krim dhe dhunë dhe për të krijuar krim në Kosovë.

Prandaj, kërkoj nga organet kompetente të Kosovës, e në veçanti të UNMIK-ut të bëjnë presion në Qeverinë e Beogradit, meqë ata dijnë për krimet që janë bërë, se ku janë bijt tanë, në çfarë vendi dhe ku gjenden, e veçanërisht për të kidnapuarit. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Dragisha Kërstoviq, le të bëhet gati Alush Gashi.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Poštovani predsedniče, poštovane kolege i koleginice poslanici,

Ja odmah hoću da, bez obzira na razumevanje za pitanje koje se postavlja na dnevni red, dakle apsolutno imam razumevanje za ovo pitanje koje je vrlo osetljivo i koje je kod svih naroda na Kosovu izazvalo traume. Moram da stavim prigovor da je i ovom prilikom iskorišćena govornica da se mimo dnevnog reda stavi na razmatranje i rezolucija koja u dnevnom redu nije najavljena. Dakle, smatram da ste, gospodine predsedniče o tome trebalo da imate stav i da upoznate poslanike o čemu se raspravlja.

Dakle, ja zaista, niti Koalicija «Povratak» ne sporimo to ljudsko osećanje za rešavanje ovog pitanja i za rešavanje sudbine otetih i mi se zalažemo da se sudbina otetih i nestalih lica na Kosovu i metohiji za vreme rata, posle rata i pre rata zaista razreši i da svi oni koji su krivi za sudbine tih ljudi da se privedu zakonu i pravdi.

Mi se medjutim ne slažemo sa jednostranim pristupom ovom pitanju. I koliko god, gospodja Flora Brovina pokušava da uveri Koaliciju «Povratak» da se ovde radi samo... radi podjednako o svim nestalim i kidnapovanim licima, ja ću da vas podsetim da je celokupna dosadašnja diskusija, osim diskusije Stojanke Petković, išla u pravcu toga da se od Vlade u Beogradu traži izveštaj, da se traži odgovornost, da se traži podnošenje krivičnih prijava odnosno prijava za genocid i tako dalje, a nijednom reču nije rećeno da se i od Vlade Kosova zatraži to isto, kad su u pitanju nestala srpska lica. I ako budemo imali takav pristup ovom pitanju, dakle samo brigu za nestala lica Albanske zajednice za vreme rata, a ne i brigu za sva druga nestala lica pre, u toku rata i posle rata, onda mi nećemo moći da rešimo ovo pitanje iz prostog razloga što to nije pravedan pristup ovom pitanju i mislim da će to biti korak nazad a ne korak napred.

Ja svakako podržavam brigu pripadnika Albanske nacionalne zajednice za njihove nestale za vreme rata i to je sasvim na mestu i sasvim ljudski i opravdano. Ali, ja se moram založiti i za brigu pripadnika moje nacionalne zajednice, za one koji su nestali pre, za vreme i posle rata i mislim da je to sasvim normalno i mi ćemo zaista nastojati da se ova Komisija nazove komisija za nestala i kidnapovana lica za vreme rata i posle rata jer je to naš interes. U protivnom, mi nećemo učestvovati u toj Komisiji a pitanje je da li će imati smisla i naše dalje učešće u institucijama Kosova i metohije.

Ukoliko se, dakle, isti tretman ne bude dao nestalim i kidnapovanim iz svih nacionalnih zajednica, onda mi nećemo moći da idemo napred.

Rezolucija je u mnogim tačkama za nas sporna. Mi ne možemo da je prihvatimo zbog toga što mnoga mesta u toj rezoluciji ne štite naše interese. Mislim da bi mogla da se napravi jedna rezolucija koja bi jednako štitila i interese svih zajednica na Kosovu i zašto ne bi smo, ovaj, jednostavno danas odložili usvajanje te rezolucije i kad napravimo rezoluciju po meri svih nacionalnih zajednica onda ćemo da je usvojimo i onda ćemo da tražimo da se ta rezolucija i primenjuje.

I mislim da nije vreme da se sada traži odgovornost Vlade Republike Srbije. Da, da se traže odgovori na ova pitanja nestalih i kidnapovanih, da. Moguće je da će Vlada Srbije, ne moguće nego sam siguran da će Vlada Srbije pomoći da se ta pitanja razreše. Jer to, nije ona vlada čija je personifikacija bio Slobodan Milošević. To je nova Vlada, Vlada koja je okrenuta Evropi, Vlada koja je okrenuta demokratskim promenama i mislim da će ta Vlada sigurno znati da će biti odgovorna da da odgovore na ona pitanja za koja može da da odgovore. A što se tiče odgovornosti te Vlade, ja stvarno ne vidim da je ta Vlada odgovorna, jer ta Vlada je konstituisana posle svih onih zala koja su se desila na Kosovu i konačno konstituisana je posle pada Slobodana Miloševića.

Ovde su izvršene i neke zamene teza. Ja ne bih o tome da detaljišem. U svakom slučaju se zalažem da se potpuno jednak pristup nestalim i kidnapovanim da i u izveštaju i u rezoluciji koja će se možda danas usvojiti. Mi nećemo glasati za onu koja je pripremljena, koju smo videli ali možemo glasati za neku koja ima smisla, koja rešava pitanje na zadovoljstvo svih, što je moguće. U svakom slučaju, ovaj, ja vas molim da počnemo da razgovaramo nekim drugim jezikom. Ja sam prvi muškarac koji se danas

javlja po ovom pitanju za ovu govornicu. Ili, se ne sećam. Uglavnom su do sada bile... Ja znam da se u Evropi i u Americi demokrate zalažu za što veće učešće žena u institucijama. Nažalost, ja sam... ja mogu da kažem da je današnja rasprava, iako su je vodile dame, išla ka tome da taj jaz izmedju Srpske nacionalne zajednice i Albanske nacionalne zajednice ipak bude dublji. Nemojmo to da radimo. Ajmo da krenemo nekim drugim putem. Da tražimo svi svoje nestale jer to je jedan osnovni ljudski osećaj na koji svako ima pravo. Zašto bi smo sada žrtve jednih, zašto bi sada žrtve jednih bile veće i teže žrtve drugih manje i, ovaj ...

I na kraju, ja opet hoću da podsetim na ono mesto iz ekspozea predsednika Vlade. Ajmo da učinimo da se na ovim prostorima nikada više ne ponovi nedavna prošlost. Opaloste, ja bih vas zamolio ovako ljubazno, da date reč gospodinu Randjelu, iako ovo nije pravilo i izvinite što ovo radim. On je čovek iz naše zajednice koji najviše radio u ovoj Komisiji.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Edhe në pikën e kaluar ia kam dhënë fjalën. Prapë do ta marrë, kur të vjen në rend. Por para se të vazhdojmë, desha vetëm një sqarim. Mund të ketë qenë përkthim jo i sakt... Përkthimi, ju lutem. A ka përkthim? Unë do të doja një sqarim që është i domosdoshëm, konsideroj. Mund të ketë qenë përkthimi i gabuar ose të mos ketë përkthim. Zonja Brovina dhe zonja Alijaj, ishin tejet – tejet të qarta. Nuk ndahen viktimat. Flasim për Kosovën dhe falënderoj posaçërisht zotin Kërstoviq që... Flasim për të gjithë qytetarët e Kosovës deri në çlirimin e Kosovës. Në këtë nuk duhet të përzihet Qeveria e Kosovës, e cila, ka një vit që është krijuar. Prandaj do të vjen në rend të ditës dhe unë mendoj se ky Komision do ta vazhdojë funksionimin e vet bashkërisht me të gjithë deputetët. Por nuk ka interferime dhe nuk ka kurrfarë përzierjeje. Në rend të ditës është Raporti dhe në atë raport raportuesit kanë të drejtë të propozojnë dokument të caktuar dhe për atë është debati dhe do të lutja që, meqë Dragisha e qetësoi mjaft, profesor Alush Gashi le ta vazhdojë këtë e pastaj le të bëhet gati zoti Bakalli.

ALUSH GASHI:

I nderuar kryetar, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Padyshim se kjo është një prej çështjeve më të rëndësishme, është një prej plagëve të hapura të shoqërisë tonë kosovare dhe është një prej çështjeve për të cilat mendoj se duhet të jetë në rend të ditës derisa të gjendet edhe qytetari i fundit i Kosovës që konsiderohet si i zhdukur dhe derisa të sjellen edhe eshtrat e fundit të atij qytetari i cili mungon.

Mendoj se demonstrimi i pushtetit të Beogradit për mosdhënie të kufomave nga varrezat masive është demonstrim i vazhdimit të një politike të papranueshme, politikë e cila sot gjykohet në Gjykatën e Hagës.

Parafolësi foli për demokratizim në atë vend por atë e përkujtoj se ai është një vend i cili edhe këto ditë ka vrarë kryeministrin e vet. Ai është një vend i cili gjendet nën një pushtet ushtarak dhe ai është një vend me të cilin ne jemë shumë të interesuar që të kemi raporte shumë korrekte në baza të njëjta të reciprocitetit.

Natyrisht se të gjitha çështjet tjera, të cilat lidhen me këtë, janë çështjet të cilat duhet të diskutohen në institucionet e Kosovës, por fatkeqësisht ende institucionet e Kosovës nuk kanë ato kompetenca.

Mendoj se çështja e të zhdukurve duhet të jetë prioritet i politikës së jashtme të Kosovës, politikë të cilën duhet ushtruar në ministrinë e punëve të jashtme të Kosovës dhe në Ministrinë e Drejtësisë. Unë nuk mund të prejudikoj se çka flet apo për çka angazhohet Përfaqësuesi Special lidhur me këtë çështje pasi që ai institucion nuk është transparent para këtij institucioni në të cilin marr pjesë unë.

Mendoj se Kuvendi i Kosovës demonstron një kulturë shumë të lartë kur flet për çështje të të zhdukurve të qytetarëve të Kosovës. Dhe, derisa qytetari i fundit, i cili është i zhdukur nuk kthehet në Kosovë, mendoj se raportet me vendin fqinj do të jenë shumë diskutabile. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Bakalli, le të bëhet gati Rangjell Nojkiq.

MAHMUT BAKALLI:

Kolegë të nderuar deputetë, zoti kryetar,

Dola së pari që të mbështes fjalën e zonjës Flora Brovina dhe të mbështes Raportin e Komisionit për personat e humbur dhe të kidnapuar.

Sygjeroj që një prej konkluzave kryesore tona, pranë punës së Komisionit por edhe Zyrës së UNMIK-ut për këtë çështje, edhe të zyrës, që eventualisht do ta organizojmë pranë Qeverisë sonë për personat e humbur dhe të kidnapuar, të jetë një azhuritet më i madh dhe një punë më frytdhënëse. Dhe kjo do të ishte konkluza kryesore e kësaj mbledhjeje. Ne duhet t'i shpejtojmë pak çështjet. Rrespekti ynë dhe ndieshmëria jonë ndaj personave të humbur, të zhdukur dhe të kidnapuar është e njëjtë për të gjithë personat nga Kosova, dhe veç e veç për secilin prej tyre. E dini se kjo na ngarkon shumë edhe në kuptimin politik, por edhe moral, edhe shpirtëror dhe ne duhet të shpejtojmë pak, të jemi më azhur në zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Thash se ndjenja jonë është e njëjtë për të gjithë dhe veç e veç për secilin prej tyre, ndjenjë e rëndë. Por më lejoni që të nënvizoj një rast për të cilin mendoj se edhe Komisioni edhe Zyra e UNMIK-ut, edhe zyra e Qeverisë sonë, duhet të ndërmarrin

diçka të posaçme për arsye se ekzistojnë disa fakte të prekshme, argumente të prekshme të cilat mundësojnë shpejtimin e gjetjes dhe të zgjidhjes së problemit. Fjala është për fatin e Ukshin Hotit. Dihet fare mirë se atë e kanë kidnapuar para Burgut të Dubravës. Dihet fare mirë se atë e kanë liruar nga burgu para skadimit të afatit të dënimit dhe një ditë para saj, një të diele. Dihet se e kanë përcjellë gardianët deri në dalje. Dihet se drejtori i burgut ka qenë në zyrën e vet. Dihet se dikush e ka kidnapuar, apo e ka marrë prej derës së burgut të Dubravës dhe e ka dërguar në drejtim të panjohur dhe për të deri më sot asgjë nuk dihet, përveç thashethemeve të ndryshme.

Unë lus që Komisioni ynë, Komisioni i UNMIK-ut dhe komisioni i Qeverisë sonë të mbështeten në këto çështje të kapshme të cilat i përmenda. Dhe, për shembull, t'u japin inisiativë organeve të Serbisë dhe t'i lusë që ta marrin në pyetje apo eventualisht të fillojnë ndonjë proces penal ndaj ish drejtorit të burgut të Dubravës dhe gardianëve tjerë të cilët e dijnë këtë rast dhe t'i pyesin se kush erdh, kush e muar, kush e kidnapoi dhe ku e çoi Ukshin Hotin. Ju falemnderit.

NË VAZHDIM, SEANCËN E KRYESOI BASHKËKRYESUESI XHAVIT HALITI, ANËTAR I KRYESISË SË KOSOVËS.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Të falemnderit. E ka fjalën Rangjell Nojkiq, le të përgatitet Besa Gaxherri.

RANDJEL NOJKIĆ.

Pa ja želim prvo da izrazim žaljenje zbog čega je sada izašao predsednik Skupštine jer sam hteo upravo njemu da uputim jednu kritiku. Žao mi je što takodje, monitori više ne prate rad skupštinskih komisija onako kako je dogovoreno da bi mogli da imaju pravu sliku i uvid u stanju.

Ja sam takodje član Komisije za nestala lica i član sam Radne grupe i smatram da imam ravnopravan tretman kao i svi ostali članovi. Prva tri govornika su bili članovi Komisije. Ja, kao drugi predsedavajući, i ako sam se odmah javio na početku, dobio sam tek, verovatno sada pri kraju i mislim da to apsolutno nije u redu. To je prva stvar.

Druga stvar, želim da vam kažem da se problemom nestalih lica bavimo 2000.-te godine još u vreme privremenokg saveta Kosova, kada sam bio član Radne grupe. I mislim da je postojala dobra volja, da je moglo da imamo mnogo više rezultata. Onda kada nije bilo kasno, sada je verovatno dosta kasno i zato su rezultati takvi kakvi jesu ali mislim da sa sudbinama porodica i žrtvama ne bi trebali da se igramo i da se manipuliše. Juče

je jedan član porodice, to vrlo lepo rekao da ima ljudi koji učestvuju u radu... a da nisu nikoga izgubili i da zapravo njihove diskusije ne vode u smislu da se razjasne sudbine i to jeste činjenica.

Ja moram da vam kažem da radeći u ovoj Komisiji, u samom početku sam se ogradio jer je zaista ovaj Izveštaj jednostran, bez obzira koliko god vi kažete da je on obostran odnosno sveobuhvatan. Ja mogu da vam na osnovu primera i na osnovu dokumenata koji su ovde napisani, da vrlo jasno kažem da on nije. Jer vi ako tražite, razumete, da se stručnjaci sa Kosova uključe i identifikaciji, a ne kažete da se i stručnjaci iz Beograda uključe ovde, onda to nije jednostran, ato upravo ovde u ovom dokumentu piše. Tako da mislim da to nije dobro.
Ja sam da vam kažem, ovako učestvovajući u radu ove Komisije, imao prilike da čujem mnoge sudbine. I kao član ove Komisije, kada su bili upravo predstavnici Udruženja Albanaca, mnoge stvari koje mi se nisu svidele nisam hteo da govorim pred njima jer zapravo shvatam njihovu tugu i patnju i zaista sam se uzdržavao da iznosim svoje mišljenje pred njima. Jer, zaista kažem, još jedanput ponavljam, to je veoma težak bol. Ali, morate da shvatite da postoji i druga strana, da postoje žrtve i da ovaj rat imao zločince i s jedne i s druge strane. I ako to ne budemo shvatili, i ako tako ne budemo gledali, mi ćemo stvarati samo još veći jaz, jaz koji nikad neće doći do rešenja. Može da se nadju rešenja. Mislim da je potrebno malo više sluha prema porodicama. I ja da vam kažem, ja sam juče imao toliko poziva od Udruženja kidnapovanih Srba sa Kosova i metohije. Oni žele da učestvuju u radu i oni zahtevaju i mole da ova Skupština, ovo telo im omogući da što pre dodju. Nisu učestvovali u izradi ovog dokumenta iz objektivnih razloga. Znate da nemaju slobodu kretanja i da ne mogu da dodju. No, medjutim, ja se nadam da će se stvoriti taj uslov i da će oni doći da ispričaju svoju priču. I mislim da upravo ta udruženja mogu da daju rezultate. Da kad oni pričaju o mukama i o patnjama i o činjenicama da upravo te činjenice mogu da dovedu na jedan put razumevanja, jer ukoliko to postoji, ovaj proces koji je možda dosta zakasneo, ja kažem, on je veoma sada zakasneo, ali može da da rezultate u identifikaciji žrtava i da se što pre identifikuju žrtve i predaju rodbinama na dalji proces sahrane prema svojim verskim i tako dalje drugim običajima. Prema tome, potrebno je razumevanje. Nažalost, čini mi se da nema razumevanje i to je...
Ne mislim da Vlada u Beogradu ne želi da da ove žrtve. Postoji jedan proces u kome su uključeni medjunarodna zajednica, medjunarodni eksperti i potrebno je da se izvrše identifikacije. Jer, ja ću sada vama da kažem, vidim da postoje malo reakcije ovako... Kada sam 2000.-te godine u ovoj Komisiji govorio da su žrtve i Srbi i da ih ima sigurno u masovnim grobnicama, rećeno je: ne nije tačno. Sada se pokazalo da jeste tačno. Prema tome, vrlo je važna identifikacija. Ne možete vi da kažete – tamo je otkriveno, ja ne znam koliko vaših..., sve su to Albanci. Možda ima i Srba. Možda je Milošević, i verovatno jeste, medju tim žrtvama sahranio je i neke Srbe. Ko će da primi te žrtve i ko će da ... Prema tome potrebno je razumevanje, potrebno je da se uključe i jedni i drugi stručnjaci i da se izvrši identifikacija i da se uključe porodice i udruženja kojima je to vrlo važno i da se problem reši.

Mislim da je to način i put do iznalaženja rešenja. Dalje, ja ću morati i još nešto da vam kažem. Ova Komisija ima svoje ime i prezime. Ona se zove Komisija za nestala lica.

Nema nikakav dodatak u toku rata, posle rata, za vreme rata. I ona se bavi žrtvama svim i onih pre rata, jer vi znate 98.-te šta se dešavalo, i 99.-te godine ali i 2000.-te i postoji odgovornost. Ja se slažem da ima odgovornih zbog ovih žrtava u porodicama Albanaca..... Ali ima i odgovornih sa imenom i prezimenom i funkcijama i zaodgovorne nad srpskim žrtvama.

Ja ću da vam ovde pokažem jedan dokumenat, dokumenat Nataše Kandić, iz Fonda za humanitarno pravo koju je vi verovatno uvažavate ali koja veoma jasno na samom uvodu govori ko su odgovorni za žrtve nad Srbima. To jeste OVK, koja je imala preko sto zatvora, koja ... zatvorenike i druga imena, razumete koja ovde stoje. Te prema tome molim vas nemojte da branimo zločince. Zločinaca ima i s jedne i s druge strane i dajte neka oni pridju pravdi. Kako? Ja ne branim. Ja uopšte ne branim i nijednog trenutka nisam rekao znate nisu...

(Ndërhyn kryesuesi: Të lutem zotri Nojkiq... Të ka kaluar koha. Të lutem, nuk je këtu gjyqtar.)

... Nisam sudija ali sada ću da vam kaažem nešto. Mislim da je ovo takodje za ove gore koji posmatraju i za monitora, pre svega. Ako sam član jedne Radne grupe i ako imam svoje mišljenje, morate da mi dozvolite da iznesem svoje mišljenje u Radnoj grupi odnosno pred ovom Skupštinom kakav je moj stav. Vi niste to hteli da stavite ni u Izveštaju, iako sam ja dostavio pismene primedbe koje nisu ušle u dokumenat i sada još mi ograničavate vreme. Mislim da to nije u redu ali dobro, mislim da će predstavnici... Pa izvinite molim vas, niste nikoga opomenuli osim mene a ja vam još jedanput, još jedanput ponavljam, ja sam član Radne grupe i član sam grupe koja je radila na izveštaju... na izradi ovog izveštaja i ja vas molim moje ime u ovom izveštaju želim da se izbriše jer ne želim da bude dekor, jer on u ovom slučaju je dekor jer je vrlo – vrlo jednostran. Hvala!

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Besa Gaxherri. Le të bëhet gati Hasan Meta, dhe kisha lutur komisionet e punës, më falni, jam duke zëvendësuar kryetarin për kohë të shkurtër, ai nuk iku por kishte një punë urgjente dhe shkoi, që kur të diskutojnë në emër të komisioneve brenda komisionit të merren vesh kush do të flasë në emër të komisionit e jo secili anëtar i komisionit të dalë dhe të flet në emër të komisionit, sepse vërtetë edhe po lodhemi edhe po përsëriten gjërat. Më falni!

BESA GAXHERRI:

Ju përshëndes zoti kryesues dhe deputetë të nderuar,

Si anëtare e Komisionit për personat e rrëmbyer dhe të humbur gjatë luftës në Kosovë dhe si pjesëmarrëse në përgatitjen e këtij Raporti, nuk dua të përsëris gjërat që u thanë

në këtë raport. Vetëmse ndiej obligim moral dhe atë në pozitën e institucionit, pra të këtij Komisioni, në kuadër të këtij Kuvendi që para jush të paraqes një pasqyrë shumë të shkurtër për komunën e Pejës, pasi që vie nga ajo komunë lidhur me këtë çështje tepër të ndieshme dhe tragjike.

Komuna e Pejës, pra, hyn në radhën e komunave më të dëmtuara nga lufta e përjetuar me të vrarë, të zhdukur, të dhunuar, me shkatërrime, djegie e plaçkitje. Në komunën e Pejës, gjatë periudhës janar 98 deri në qershor 99 janë vrarë 831 persona. Nga 831 persona të vrarë 90 prej tyre janë kufoma të gjetura, por të dëmtuara dhe të karbonizuara, të cilat që nga viti 2000 gjenden në morgun e Rahovecit. Në komunën e Pejës, sipas të dhënave nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, konsiderohen 94 persona të zhdukur për të cilët nuk ka dëshmi se janë të vrarë, por vetëm dihet se kur janë kidnapuar dhe asgjë tjetër. Ndërsa 128 kufoma janë të zhdukura. Për shumicën prej tyre kemi të dhëna se pasi që janë varrosur, pas një kohe, kryesisht në fund të prillit dhe gjatë muajit maj të vitit 99 janë zhvarrosur nga policia serbe dhe janë drejtaur në drejtim të panjohur për ne, me qëllim të zhdukjes së gjurmëve të krimit, e që njëkohësisht ata dyfishuan krimin.

Për zbardhjen e fatit të këtyre personave të kidnapuar dhe kufomave të zhdukura, në këtë komunë, kryesisht është marrë Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut si dhe disa organizata qeveritare e joqeveritare ndërkombëtare. Një ndër to, është edhe Shoqata Abacel nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila ka ofruar formularët antemortum në të cilët janë shënuar të gjitha të dhënat për personat e kidnapuar dhe kufomat e zhdukura gjatë luftës në Kosovë. Intervistimin e familjarëve e kanë bërë ekipet pra pranë Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Pejë.

Në komunën e Pejës janë të njohura masakrat e Lagjes Dardania, Lagjes Kristali, masakrat e fshatit Lubeniq, Qyshk, Nabërxhan, Pavlan dhe Zahaç, ku nga këto masakra mungojnë shumë njerëz, mungojnë edhe si kufoma edhe si njerëz.

Shteti serb ushtroi dhunë të paparë mbi popullin shqiptar të Kosovës me qëllim të spastrimit etnik të Kosovës. Në Kosovë pra u ushtrua gjenocid. Prandaj, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive në Pejë, ka bërë 23 kallëzime penale për krimet e kryera duke përfshirë edhe disa nga komunat e Klinës dhe të Istogut. Në këto kallëzime penale janë përfshirë 420 persona të dyshuar për pjesëmarrje në këto krime. Këto kallëzime penale, me një material shumë të gjerë, ku dëshmohen këto krime, i janë dorëzuar prokurorit të Tribunalit Ndërkombëtar të Hagës dhe Prokurorisë së Qarkut në Pejë. Familjarët e 94 personave të kidnapuar dhe 128 kufomave të zhdukura, jetojnë në ankth dhe çdo ditë presin të afërmit e tyre të gjallë apo të vdekur të kthehen në shtëpitë e veta. U bënë katër vite dhe s'ka asgjë. S'ka asnjë lajm. Është koha që të vritet ndërgjegja e institucioneve kompetente për këto çështje, e që aludoj në radhë të parë në Përfaqësuesin Special të Kombeve të Bashkuara, zotin Shtajner. Këta familjarë presin shumë nga ky debat që po bëhet sot në Kuvend dhe presin shumë nga nxjerrja e një rezolute për zbardhjen sa më të shpejtë të fatit të këtyre njerëzve dhe këtyre viktimave.

Ndoshta pa radhë, por unë kërkoj falje nga ju dhe më vjen keq që nuk është këtu kryetari prezent. Nuk dij kush e bën radhën, stafi teknik apo kryetari, por unë kam vërejtje dhe kjo është vërejtja e tretë apo e katërtë, të cilët nuk e radhitin fjalën si lajmërohemi por sipas, ku ta dij unë, çfarë merrni ju si kriter dhe unë kërkoj nga ju që kjo të mos ndodhë. Unë jam lajmëruar sot e pesta me radhë, dhe jam anëtare e këtij Komisioni, ndërsa kujt t'i teket, nuk dij kush vendos, të thirrem e dhjeta apo e pesëmbëdhjeta. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Urdhëroni. Le të përgatitet Fetije Këpuska.

HASAN META:

Zoti kryesues, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë do të mundohem që të mos politizohet kjo çështje, të mos merrem me atë punë, por do të merrem me atë aspektin kryesisht njerëzor të saj. Sipas titullit të Raportit, thotë Raport pune me vërejtjet dhe rekomandimet e Komisionit për personat e humbur dhe të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Dhe si të tillë po e pranoj, përndryshe po të ishte ndonjë titull tjetër, do të thonim se duhet të jetë më i zgjeruar dhe t'i përfshijë të gjitha viktimat që nuk janë të gjetura, pa marrë parasysh kujt i takojnë. Kjo nuk do të thotë që në të ardhmen të bëhet ndonjë raport edhe më i gjerë edhe për viktimat tjera. Por, këtu në rekomandime, përveç tjerash që pajtohem me shumë gjëra këtu, thotë: të kërkohet ndihmë nga bashkësia ndërkombëtare, nga Kombet e Bashkuara, Bashkësia Evropiane dhe nga SHBA-të për ndriçimin e fatit të të rrëmbyerve dhe ende të pagjetur.
Zotëri të Komisionit, e keni harruar ndoshta që këtu janë Kombet e Bashkuara, si UNMIK, këtu është Bashkësia Evropiane, këtu janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet tjera. Dhe, realisht, është dashur që me kohë... Unë pajtohem që dikush e tha këtu, që është shumë e vonuar kjo dhe pajtohem me atë se është e vonuar. Por duhet ta kemi edhe një përgjegjësi ne të gjithë këtu vendorët, pa marrë parasysh se nuk mund t'ia veshim Qeverisë këtë punë, por përpara çfarë kanë qenë strukturat, që me kohë nuk i kanë shqyrtuar këto gjëra.
Unë kam shumë të njohur që kanë humbur jerëzit gjatë Luftës së dytë botërore dhe pakashumë e dij çka do të thotë kur nuk gjenden eshtrat e dikujt dhe çfarë... nuk kam të humbur personalisht, por i dij nënat apo bashkëshortet e njerëzve apo prindërit që gjithnjë kanë kujtuar se është dikushi dikund, që do të vijë, kanë mbetur me shpresa e tjera. Është e pamundur ne ta parafytyrojmë dhe ta ndiejmë sikur ata që kanë humbur të vetët dhe atë duhet ta kemi gjithësesi parasysh.

Dhe, besoj se, më në fund duhet të kuptohet, nuk ndihmon rezoluta, nuk ndihmon zyra, nuk ndihmon komisioni, por duhet të trokitet në dyert e duhura që kjo çështje më në fund të zgjidhet në mënyrën si duhet, që njerëzit që kanë humbur të vetët të dihet a janë të vdekur – gjenden eshtrat, janë gjallë – gjenden diku e të tjera, e të tjera.

Dhe, askush nuk duhet t'ikë përgjegjësisë për shumë gjëra, por nuk e kam ndërmend të polemizoj me askë, por duhet ditur kur kryhen krimet e mëdha, permanente, me qëllim të caktuar, në mënyrë institucionale, çfarë edhe janë bërë nga pushteti i atëhershëm serb, nga ushtria dhe jo vetëm në Kosovë por në tërë territorin e jugosllavisë, pre ndonjë krimi për ndoshta hakmarrje të individëve e tjera, që nuk është bërë në mënyrë isntitucionale. Duhet të jemi të kujdesshëm. Mendoj se të gjithë kanë të drejtë që ta dijnë fatin e të vetëve, pa marrë parasysh kujt i takojnë dhe si i takojnë. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Fetije Këpuska, le të përgatitet Berat Luzha.

FETIJE KËPUSKA:

Ju falemnderit, zoti kryesues, kolegë deputetë,

Kërkesa jonë për zbardhjen e fatit të të zhdukurve në Kosovë nuk është vetëm një apel formal, i cili do të duhej të varej nga disponimi apo nga vullneti i zyrtarëve në Beograd. Zbardhja e fatit të mijëra personave të vrarë, të zhdukur, të marrur peng gjatë luftës në Kosovë është një detyrim ndërkombëtar i Beogradit. Informatat e plota e të sakta për fatin e këtyre personave, për vendndodhjen e tyre apo të varrezave të tyre, është një obligim ndërkombëtar i paraparë me konventat ndërkombëtare. Kujtoj se përmbushja e këtij detyrimi, pra zbardhja e fatit të personave të pagjetur, të gjallë apo të vdekur, duhet të jetë parakusht për çfarëdo dialogu për të cilëndo çështje me Beogradin.

Siç dihet, gjatë luftës në Kosovë, janë bërë shumë shkelje drastike të të drejtës ndërkombëtare, pra të rregullave dhe konventave të luftës, të rregullave që u referohen luftës dhe konflikteve të armatosura. Forcat serbo-ushtarake, policore, paramilitare nuk kanë rrespektuar përkufizimin që ka të bëjë as me popullatën civile as të caqeve të sulmeve. Lufta nënkupton betejën mes forcave të armatosura në konflikt, pra nënkupton përjashtimin e popullatës civile. Kjo nuk është rrespektuar pasi që numri më i madh i viktimave të të vrarëve e të zënëve rob janë civilë. Është obligim ndërkombëtar sjellja njerëzore ndaj të të gjithë personave që nuk janë të përfshirë në konflikt, rrespektivisht janë të ndaluar shkelja e dinjëtetit dhe integritetit njerëzor, e sidomos sakatosja, brutaliteti, mundimi, maltretimet, si dhe marrja e pengëve. Po kështu, nuk është rrespektuar përkufizimi as sa i përket caqeve të sulmeve e objekteve të sulmeve, meqë janë atakuar dhe asgjësuar edhe objektet kulturore, fetare dhe shumë institucione tjera.

Unë do të flas posaçërisht në aspektin e mosrrespektimit të konventës që kanë të bëjnë me të vdekurit, pra me të vrarët. Me konventën ndërkombëtare, palët në konflikt janë të detyruara që të marrin masa për gjetjen e të vdekurve, që t'i varrosin denjësisht, që të marrin masa për ruajtjen e varrezave të tyre, që gjithmonë të mund të gjenden. Para varrimit, sipas konventave ndërkombëtare duhet bërë identifikimin e të vrarit dhe madje sipas mundësisë edhe të shkakut të vdekjes. Palët në konflikt, duhet që reciprokisht t'i komunikojnë dhe bëjnë të ditura këto të dhëna njëra-tjetrës sikur edhe për të plagosurit dhe të personave të zënë peng. Kjo kështu nuk ka ndodh. Pra nuk janë rrespektuar konventat. Me Konventën e Gjenevës, vendet e përfshira në konflikte të armatosura, janë të obliguara të sigurojnë rrespektimin e konentave dhe të rregullave të luftës, ndërkaq për shkeljen flagrante të tyre, duhet të parashohin ndëshkime, t'i gjejnë fajtorët, t'i ndjekin penalisht dhe t'u shqiptojnë dënime të merituara. Po kështu, me Konventën e Gjenevës për personat e marrë peng, janë paraparë masat mbrojtëse. Vendi që ka marrë peng, ka obligim ndaj tyre, pavarësisht nga përgjegjësia e tyre individuale. Me personat e marrë peng, duhet patur qëndrim të njerëzishëm dhe ata të mbrohen në çfarëdo manifestimi dhune apo frikësimi, madje edhe fyrosje dhe nënçmime. Sidomos janë të ndaluara dëmtimi fizik i tyre, sakatosja dhe eksperimentimet medicinale. Një tretman të veçantë në këtë aspekt, kanë gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Fatkeqësisht, të gjitha këto konventa janë shkelur brutalisht gjatë luftës në Kosovë. Të gjitha këto shpiejnë në përfundim se Beogradi ka obligim ndërkombëtar për zbardhjen e fatit të të zhdukurve si dhe për marrjen e masave ndaj akteve të krimeve si dhe dorëzimin në Hagë të personave të inkriminuar në gjenocid në Kosovë.

Kujtoj se burgosja e anëtarëve të grupit të Zemunit do të zbardhë diçka edhe sa u përket krimeve në Kosovë, por kjo varet nga vullneti i pushtetarëve të atjeshëm, e sidomos besoj se do të ndihmojë edhe në zbardhjen e shumë e shumë të të zhdukurve në komunën e Gjakovës dhe posaçërisht të profesor Bardhyl Qaushit. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Berat Luzha, le të përgatitet Nafije Berisha.

BERAT LUZHA:

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari nuk mund të mos shfaq pakënaqësinë time që shqyrtimi i kësaj teme shumë të rëndësishme në Kuvend po bëhet me një vonesë kaq të madhe. Të gjithë dijmë se çështja e të rrëmbyerve gjatë luftës ende të pagjetur, paraqet njërin nga problemet më të mëdha politike me të cilin po përballet shoqëria kosovare dhe me siguri problemin më të dhembshëm tonin. Shqyrtimi i këtij problemi dhe diskutimi për të në këtë Kuvend do të duhej të ishte shumë më i hershëm, shumë më i shpesht, në mos i rregullt.

Të gjithë dijmë rrethanat në të cilat u arrestuan afër 7.000 kosovarë gjatë luftës në Kosovë. Asgjë e rastit nuk ndodhi. Ata u rrëmbyen në rrugë, në shtëpi, në punë. Ata nuk u zhdukën gjatë luftës, por u arrestuan nga forcat policore, ushtarake dhe paraushtarake serbe. Pra, u arrestuan nga organet e shtetit që po bënte agresion në Kosovë. Nga ky numër i kosovarëve të arrestuar, organet e shtetit të Serbisë pas luftës pranuan vetëm se në burgjet e saj ndodhen vetëm afër 2.000 duke fshehur 5.000 të tjerë. Vallë, çka u bë me të tjerët? U vranë, u fshehën apo ...? Forcat shtetërore serbe, pos arrestimit të të gjallëve gjithandej nëpër Kosovë, kishin zhvarrosur edhe viktimat e tyre, kufomat e të cilëve i morën dhe bartën në Serbi, duke u munduar ta fshehin krimin.

Tash shteti serb i mban ato viktima ende atje, të fshehura, ndoshta për llogari politike, duke mos i zbuluar varrezat masive në Serbi, duke i mbajtur viktima të paidentifikuara, si të burgosura dhe duke shantazhuar në këtë mënyrë tërë shoqërinë kosovare dhe bashkësinë ndërkombëtare. Madje, Qeveria e tashme në Beograd, thuhet se është e gatshme të marrë pjesë në ndriçimin e fatit të të zhdukurve, por ajo kërkon të bëjë pazar, do të thotë kërkon njëfarë balancimi të krimit. Nëse ajo qeveri është vërtetë e gatshme të ndriçojë fatin e të gjitha rasteve, pse nuk e bën menjëherë këtë hap, por e kushtëzon? Kjo tregon se Qeveria Serbe, edhe pse di për të gjitha rastet, nuk don t'i ndriçojë ato pa patur përfitim politik prej tyre, sikur ndodhi edhe me të burgosurit që ishin në burgjet e Serbisë. Kurse përfitimi politik, në fatkeqësinë e mijëra viktimave, është një nonsens i paparë kriminel. Do të mjaftonte ndoshta që të kthehen në Kosovë dhe të hapen dosjet e SPB-ëve, të gjykatave të cilat ende në Serbi veprojnë si gjykata të Kosovës, të prokurorive, të burgjeve dhe jam i sigurt se do të ndriçoheshin të gjitha rastet.
Familjet kanë të drejtë të dijnë për fatin e më të dashurve të tyre, madje ato kanë një kërkesë të vetme dhe shumë të arsyeshme: Na i ktheni më të dashurit tanë çfarëdoqoftë fati i tyre, thonë ata. Këtë kthim ua kemi borxh familjeve të viktimave. Ato kanë plotësisht të drejtë të dijnë se çka u bë me të dashurit e tyre. Ato kanë të drejtë së paku të dijnë varrin e më të dashurit të tyre. Deklarata e Konferencës Ndërkombëtare të Ekspertëve Qeveritar dhe Joqeveritar, e lëshuar para dy muajve në Gjenevë, saktëson parimin se çdonjëri ka të drejtë të dijë për fatin, për vendin dhe për shkakun e vdekjes së më të afërmit të zhdukur. Por njëkohësisht askush nuk ka të drejtë t'u komunikojë atyre lajme pa pasur fakte përpara, pa i pasur viktimat përpara, pa ditur për fatin e tyre, pa u dhënë familjarëve çertifikatat përkatëse, kurse faktet, siç dihet mungojnë, ato fshehen siç fshehen në velin e errësirës edhe viktimat.
Është një fakt i pamohueshëm se strukturat e UNMIK-ut e kanë neglizhuar këtë problem. Madje këtë në një masë e kanë bërë edhe institucionet vendore, të cilat mund të jusitifikohen vetëm me mungesë të kompetencave dhe në pamundësi të qasjes më serioze të këtij problemi. Kurse, ky problem shumë delikat, qe katër vjet po prodhon vazhdimisht dhembje, po e tensionon situatën edhe ashtu të rëndë, po krijon ankth në shoqëri, po kërkon shërim. Kërkon madje që me Serbinë tash për tash të bisedohet vetëm për këtë problem madhor dhe që bisedimet në këtë aspekt të fillojnë menjëherë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përkrah nxjerrjen e një rezolute për çështjen e personave të rrëmbyer gjatë luftës, e cila do të na obligonte të gjithëve dhe sidomos institucionet vendore. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Nafije Berisha, le të përgatitet Ibush Jonuzi.

NAFIJE BERISHA:

E nderuara Kryesi, të nderuar deputetë,

Fati i personave të humbur dhe të kidnapuar është i dhembshëm dhe shqetësues jo vetëm për ne dhe familjet e tyre por edhe për të gjithë popullin e Kosovës. Në vazhdën e përpjekjeve të zgjidhjes dhe zbardhjes së fatit të të zhdukurve, çështjen duhet ta kanalizojmë jo vetëm në diskutime të tilla por edhe në institucionet tjera të cilat funksionojnë në Kosovë. Ne shumëmirë e dijmë të gjithë dhe jemi dëshmitarë të asaj se lufta në Kosovë nuk ka pasur rregulla. Serbia i ka shkelur konventat e Gjenevës dhe protokolet plotësuese të saj, sepse në Kosovë ka patur ushtri të armatosur, polici të armatosur, grupe paramilitare të armatosura dhe do të thotë se çdo serb ka qenë i armatosur. Ka pasur të atillë të armatosur edhe jashtë këtyre formacioneve të cilat i përmenda, gjë që është fakt se vështirëson gjetjen e të zhdukurve.

Ne, si Kryq i Kuq i Kosovës, para pak kohe kemi evidentuar një të gjetur që ka qenë në listën e të zhdukurve dhe që është gjetur nga informatat e një qytetari i cili momentalisht edhe sot jeton në Kosovë. Do të thotë, e ka treguar vendin se ku ai gjendet, familja e ka kërkuar dhe është gjetur me duar lidhur.

Serbia, jo vetëm që ka shkelur konventat e Gjenevës me armatimin e gjithë popullatës së saj, por ajo ka shkelë konventën e Gjenevës qysh më herët, do të thotë ka vërë masa diskriminuese në Kryqin e Kuq të Kosovës qysh në vitin 91 dhe formon një të ashtuquajturin kryq të kuq njënacinal këtu në Kosovë dhe kështu Kryqit të Kuq të Kosovës ia pamundëson qasjen në evidentimin e gjërave, në kontrollimin e gjërave dhe në përkujdesjen e familjeve të tyre gjatë kohës së luftës.

Komisioni parlamentar dhe Qeveria, duhet ta kenë parasysh edhe çështjen e të zhdukurve ta drejtëjnë kah Kryqi i Kuq i Kosovës. Me Kryqin e Kuq të Kosovës është bërë një lloj politike edhe më herët por edhe pas luftës. Pas mbylljes dhe diskriminit të Kryqit të Kuq para luftës, ne i jemi drejtuar Gjenevës dhe Gjeneva na përgjigjet me një letër shumë shkurt – se ne si organizatë humanitare, në bazë të parimeve të cilave iu

përmbahemi, nuk mund të punojmë me dy kryqe të kuqe paralel në një vend. Çka ndodhë? Pas luftës, ajo bëhet dhe në Kosovë qe katër vite me radhë, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq punon me dy kryqe të kuqe të Kosovës paralel. Me Kryqin e Kuq gjëja të regjistruar në UNMIK dhe me të ashtuquajturin Kryqin e Kuq të Kosovës dhe të metohisë gjëja të pranuar në Federatën Ndërkombëtare nga lidhmëria me Kryqin e Kuq të Serbisë, që do të thotë se bëhet shumë qartë një shkelje e të rejtave. Nga kjo shkelje, atëherë pamundësohet që të krijohet shërbimi i kërkimeve pranë kryqit të kuq që është një shërbim shumë me rëndësi dhe i cili do të mundësonte edhe sot kanalizimin e bisedave me çdokënd me të zhdukurit. Sepse, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq sot posedon një libër të cilin e ka me siguri edhe zoja Flora Brovina me emër e mbiemër, datëlindje dhe vend për të zhdukurit. Kurse, për të mund me bërë gjetjen e të zhdukurve nevojiten edhe shumë e shumë të dhëna të cilat janë të nevojshme në krijimin e bazës së shënimeve pranë shërbimit të kërkimeve në Kryqin e Kuq si në çdo kryq të kuq tjetër në botë.

Në atë bazë të shënimeve do të hynin atje mbi njëqind pyetje: e disa prej tyre që janë shumë me rëndësi se ku është pa për herë të fundit, kush e ka marrë të zhdukurin kështu që në këtë drejtim ne edhe me këto të dhëna ne do të kërkonim nga shteti i Serbisë të zhdukurit tanë dhe do të dilej në pah se nga cilat formacione janë marrë ata të zhdukur.
Gjithashtu Qeveria jonë duhet të ketë kujdes që në të ardhmen shumë të afërt të shtrojë në këtë Parlament edhe ligjin mbi Kryqin e Kuq të Kosovës, pikërisht për të pamundësuar paralelizmin në këtë organizatë humanitare dhe shumë të rëndësishme. Atëher, kjo Qeveri edhe ky Parlament do të deklaroheshin se cili kryq i kuq është i Kosovës, a është kryqi i kuq i Kosovës apo ai i ashtuquajturi i Kosovës e metohisë dhe cili është zyrtar.
(Ndërhyn kryesuesi: Po më vjen keq, por mos të flasim për kryqin e kuq, rreth raportit jemi duke diskutuar).

... Unë mendoj se Qeveria duhet të ketë parasysh se kryqi i kuq është një segment qeveritar dhe nuk kishte guxuar të bëjë gabime sikur që ka bërë, të çojë delegacionin e vet në Gjenevë pa përfaqësuesit e kryqit të kuq, sepse ata janë të armatosur me të gjitha të dhënat e nevojshme për hulumtimin e të zhdukurve në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Ibush Jonuzi, le të përgatitet Blerim Baruti. Ju kisha lutur, sa më shkurt, aq më mirë sepse kemi diskutua mjaft dhe është mirë që kemi diskutua të gjithë. Përkthimi, ju lutem!

IBUSH JONUZI:

Kryesi e punës, deputetë të nderuar,

Ky Parlament prej fillimit të punës e deri më sot prej të gjitha seancave të mbajtura për të gjitha çështjet e shtruara, sot ka përballë çështjen më të ndieshme për të cilën po diskutohet. Si parlamentarë kemi obligim që me qasje shumëserioze dhe me përkushtim të bëjmë atë çka lypset nga ne për ta ndriçuar fatin e të humburve dhe të kidnapuarve, duke liruar nga ankthi i pritjes familjet që kërkojnë të dijnë për më të dashurit e tyre. Për ta ndie peshën e rëndë të këtij problemi shumë të madh, çdo njëri prej nesh, duhet ta vëjë veten në pozicionin e atyre prindërve, vëllezërve, motrave të cilët për katër vite ende nuk kanë të dhëna për fatin e atyre që u rrëmbyen, u keq trajtuan dhe çmos tjetër. Nga ne dhe institucionet kosovare lypset që të ngritet zëri te faktori ndërkombëtar ku nëpërmjet tij të bëhet presion por edhe të kushtëzohet Qeveria e Beogradit të përgjigjet se ç'bëri me të gjithë ata shqiptarë që i morën. Pyetja është shumë e rëndë por përgjigja për Beogradin është shumë e qartë se ata i dijnë të gjitha aktet e shëmtuara kriminele që i kanë bërë këtu me plane të paramentuara dhe me qëllim shfarosjeje ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Nga komuna e Vushtrrisë kemi 84 vetë të rrëmbyer, prej tyre 75 vetë u rrëmbyen më 22 maj të vitit 99, në qytetin e Vushtrrisë dhe atë: 5 vetë të mitur, ndërsa 5 janë femra. Mosha e të rrëmbyerve është prej 15 deri 82 vjeç. Të gjitha rastet janë të rënda, sepse krime pati shumë e bile edhe nga ata serbë që kishin dhënë beteimin e Hipokratit, kur dihet se dy të rinj nga komuna e Vushtrrisë, të cilët kanë qenë për shërim në spitalin e Mitrovicës, trupat e tyre të ekzekutuar janë zbuluar në Mitrovicë. Njëri i zbuluar u zbulua në muajin shkurt e tjetri këtë muaj të këtij viti.

Fakte ekzistojnë rreth çdo krimi. Unë po ndalem te masakra e Studimës, ku më 2 maj të vitit 99 u ekzekutuan 114 vetë. Ata që i shpëtuan masakrës kanë dëshmuar se policia komunikonte nëpërmjet radio-lidhjes me urdhërdhënsit e tyre dhe se i kanë dëgjaur kur raportonin: i vranë 50 veta; dhe tek i pranonin urdhërat për të vazhduar më tutje ekzekutimet.Prandaj, ju lutem ne duhet të nxjerrim përgjigjen prej Beogradit: prej nga u urdhëruan të vriten, të rrëmbehen e të përdhunohen shqiptarët në Kosovë. Atëherë do ta kuptojmë të vërtetën për ata që u zhdukën pa gjurmë por edhe për ata që dijnë se ku ekzekutuan dhe atëherë nuk dijnë për eshtrat e tyre.

Përveç faktorit shqiptar, këtu në Parlament e në institucionet tjera të Kosovës, edhe faktori ndërkombëtar do të na ndihmonte shumë në këtë çështje e po ashtu edhe faktori serb, deputetët e Koalicionit «Kthimi» që i kanë ulëset në këtë Parlament duke iu bashkëngjitur në emër të arsyes dhe njerëzores por edhe për përgjegjësitë që kemi t'i bëjmë thirrje Serbisë që të japë dëshmi për të zhdukurit, por nëse ka atje edhe burgje të fshehta apo kampe ku mbahen shqiptarët.

Në fund do të doja të nxjerrja e rezolutës siç u propozua nga Komisioni për zbardhjen e fatit të të humburve dhe të kidnapuarve të bëhet sa më parë në të mirë të avancimit të hapave konkret për zgjidhjen e kësaj çështjeje sepse para familjarëve që vuajnë të mos dalim vetëm me fjalë por me punë duhet t'u tregojmë atyre që së bashku me ta ndajmë brengën dhe shqetësimin për më të dashurit e tyre dhe tanët. Ju falemnderit.

NË VAZHDIM, SEANCËN E KRYESOI KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Blerim Baruti, le të bëhet gati Vujiçiq Cveta.

BLERIM BARUTI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Plaga që vazhdon ta rëndojë Kosovën dhe popullatën e saj, është fati i të zhdukurve i pandriçuar edhe pas afër 4 viteve të përfundimit të saj. Kosova gjatë viteve 1998-1999 ka përjetuar tragjedinë më të madhe në ekzistencën e saj, por megjithatë mbijetoi. Qëllimi kryesor i kësaj lufte ishte pastrimi etnik. Fati i personave të rrëmbyer dhe të zhdukur, me... Në rregull...

(Ndërhyn kresuesi: Më ngadalë të lutem, për shkak të përkthimit)

...angazhimin e të gjithë faktorëve relevantë vendor dhe ndërkombëtar, nuk do të ishte zvarritur, ashtu që tani ne ta trajtojmë këtë temë shumë të ndieshme e të dhembshme të Kosovës dhe përgjithësisht të botës së civilizuar. Jemi të vetëdijshëm dhe shumica nga ne dëshmitarë të ngjarjeve famkeqe që Serbia i bëri në Kosovë dhe se disponon me mundësinë e i zgjidhjes së kësaj çështjeje. Qeveria dhe shoqëria aktuale serbe, në vend që të pranojë përgjegjësinë për atë që ka bërë, të pranojë se ka ndjekur rrugë të gabuar, të na kërkojë falje publike, ta pranojë realitetin e ri të krijuar në Kosovë, të angazhohet në zbardhjen e fatit të personave të rrëmbyer e të zhdukur, ajo drejtohet serish me tone kërcnuese e luftënxitëse. Të gjithë ne jemi dëshmitarë se i akuzuari për krime lufte, Millosheviq, që po gjykohet në Hagë, po furnizohet me informata të përpikta për të gjitha ngjarjet gjatë luftës në Kosovë. Ky argument dëshmon se Qeveria e Serbisë posedon me të dhëna për arrestimet dhe zhdukjen e personave dhe të kufomave.
Gjatë muajit të fundit, me rastin e vrasjes së Gjingjigjit dhe gjetjes së kufomës së Stamboliqit në Serbi u proceduan mëse 7.000, ndërsa për vrasjen e 12.000 vetave dhe për pasigurinë e fatit të afër 4.000 vetave nuk gjeti asnjë gatishmëri për hetimin, arrestimin dhe burgosjen e kryerësve të krimeve në Kosovë. Këtyre ditëve, Serbia hyri

në Këshillin e Evropës pa kurrfarë kushti. Mirëpo, megjithatë, shpresojmë se do të krijohen parakushtet që bashkësia ndërkombëtare tani të kërkojë zbatimin e të gjitha konventave ndërkombëtare e nga kjo rezulton edhe në kompensimin e dëmeve të luftës të bëra në Kosovë. Gjatë kohës së luftës, gjykatat serbe kanë zhvilluar procedurë gjyqësore... për raste të arrestimeve, të caktimit të paraburgimit, burgosjet, ekshumimet, vendimet për dislokimin e kufomave si dhe për varsjet tjera. Po ashtu janë dhënë urdhëra për varrimin e kufomave, ka patur regjistra të personave të vrarë. Këto akte janë dëshmi se Serbia disponon me informata mbi fatin e personave të rrëmbyer, të zhdukur, të vrarë dhe me lokacione mbi varrezat dhe kjo tregon domosdoshmërinë e hapjes së dosjeve dhe arkivave të shtetit të Serbisë. Në Mitrovicë gjatë luftës janë vrarë 670 persona dhe 232 janë të zhdukur. Deri më tani, nga ky numër janë identifikuar nëpër varreza masive 56 veta të cilët janë rivarrosur. Deri më tani janë gjetur 22 lokacione me varreza masive, ku në këto varreza kanë qenë me 3 e më tepër varre. Vetëm në Suhodoll janë gjetur 109 trupa të pajetë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Cveta Vujiçiq dhe le të bëhet gati i fundit Mehdi Bardhi.

CVETA VUJIČIĆ:

Poštovano Predsedništvo, kolegenice i kolege poslanici,

Ne mogu da odem iz ove Skupštine danas a da ne pregovorim nekoliko reči o kidnapovanih i nestalih. Danas raspravljamo o jednom veoma važnom, veoma osetljivom bolnom pitanju, pitanje koje je trebalo mnogo ranije da se nadje ovde za ovom govornicom odnosno u ovoj Skupštinskoj sali.

Izveštaj koji sam dobila tek danas neposredno pred početak sednice, nisam bila u prilici da ga ranije dobijem, pažljivo pročitala, mislim da je dosta jednostran, jednonacionalan i sam Izveštaj a i diskusije mojih kolega i kolegenica koje su bile, trudili su se da sve vreme regularnu vojsku jugoslavije i Vladu Republike Srbije okrive kao najodgovornijom za sve ovo što se dešavalo u poslednjih godina, a Srpski narod prikažu, po ne znam koji put za ovom govornicom, kao genocidan narod.

Osećam posebnu obavezu da ovde spomenem svog profesora, učitelja, koji je na radnom mestu po dolasku Misije medjunarodne zajednice kidnapovan. Kolegu Zlatibora, pedijatra, kojeg su na radnom mestu, ubila ga je majka dobro se zna, pedijatar je bio, lečio, pomagao kao i profesor Tomanović. Dan danas se ne zna gde su ti ljudi. Šta je sa njima? Kao i 12 univerzitetskih nastavnika. Nije to malo. To su

intelektualci, ljudi koji itekako su radili, pomagali svima kojima je bila potrebna pomoć. I u nizu još drugih, možemo spominjati, pričati i reći jednom rečju da ovde treba da svi jednostavno pomognemo onima kojima je pomoć potrebna. To su porodice nestalih, koje vape, koje žive u nadi i u bezdan i beznadje očekuju milost onih što milosti itekako znaju, osluškuju njene zamrle zvuke i prizivaju kao dodole kišu, ali tiho u sebi da ih niko ne čuje. Moćnici su ih ostavili pa zaboravili.

Potrudimo se još jednom, pre svega Komisija, mi poslanici a onda Medjunarodni crveni krst i svi oni koji se bave i koji hoće da se pozabave ovim veoma važnim pitanjem pomognemo. Hvala vam.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Mehdi Bardhi e ka fjalën, dhe Gani Prekopuca. Ramadan jeni të paraqitur një herë. Nese e ke replikë, mundesh. Në rregull.

MEHDI BARDHI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Kur flasim sot për këtë pikë mjaft të rëndësishme, edhe mua m'u dha të mundohem t'i jap kontribut pakashumë këtij debati. Nuk duhet të flas histori se Serbia apo prej kralit e këndej, si shtet ka pasë një platformë kundër popullzimit të Kosovës me shqiptarë dhe për atë çdoherë ka përdorur metodat e veta gjenocidale që edhe në këtë luftë të fundit, e dijnë mirë zotërinjt se serbët gjatë luftës apo policia gjatë luftës bijnë nën komandën ushtarake.
Unë nuk them grup, ai apo ky, por unë e dij që ushtria serbe, me një platformë që ka patur, dhe pushteti serb dhe qeveria serbe ka vepruar këtu në Kosovë e cila ka bërë një masakër të paparë kurrë. Në Drenicë, edhe në komunën e Skenderajt, edhe në komunën e Drenasit, mund të them edhe gjatë luftave ballkanike, po edhe gjatë Luftës së dytë botërore, e edhe gjatë kësaj lufte është pjesa më e shkatërruar, pjesa më e djegur, pjesa më e vrarë me fëmijë e me gra dhe kjo është Drenica. Unë nuk dola sot të them dhe vajtoj për atë, por thash se organet tona të bëjnë punën dhe atë që mund ta bëjnë, të përpiqen për arsye se, mirë e tha Meta që këtu janë Kombet e Bashkuara, këtu është Amerika, këtu është Amerika dhe këtu janë të gjithë. Ta bëjmë atë çka mund ta bëjmë. Nuk jemi në dakord që të thuihet tani për tani se afër 4.000, afër 6.000, afër 900, por janë do të thotë kaq të zhdukur, kaq janë këtu, kaq janë këtu. Unë kam vërejtje edhe në atë se jo që ka vetëm të vrarë e të masakruar, dhe jo që ka vetëm në Beograd varreza masive, por ka edhe në Kosovë që ende nuk janë të zbuluara. Parafolësi i "Povratakut" tha më parë – se nuk kemi mund me ardhë në komisione, nuk mundemi të arrijmë këtu. Unë për çdo ditë shoh tabelat me veturat e tyre që u shkruajnë të Serbisë, fare nuk i mëshehin ato. Qarkullojnë lirshëm, shkojnë kah të donë lirshëm. Unë nuk po dij tash, a janë këta të Beogradit, avokatët e Beogradit, apo janë të Kosovës, apo kokan të Kosovës por kokan në Beograd. Unë kisha kërkuar prej këtyre që le ta ndihmojnë veten, le ta ndihmojnë veten përndryshe nuk do të mundet askush t'i këta në qoftë se këta nuk e ndihmojnë veten. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Gani Prekopuca, le të bëhet gati Ismajl Kurteshi, shkurt, në formë të replikës.

GANI PREKOPUCA:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Unë nuk kam dalur t'i numëroj vajtimet këtu që i numëroi deri tash Komisioni që, vërtetë e përkrahu. Por, kujtoj se prej sotit, familjet e viktimizuara do të kenë më lehtë, mos për kurgjo, barem nuk do të kenë shansa partitë politike, individët e caktuar, t'i ftojnë, të bëjnë greva se do t'ua gjejnë më të afërmit e tyre. Dakord jam me mendimin e profesorit Alush Gashi se as institucionet ndërkombëtare, as kërkush nuk do t'i gjejë ata. Serbia nuk i ka marrë për me i kthye. Do t'i gjejmë vetëm atëherë kur bëhemi shtet. Në mënyrë reciproke, edhe për këta zotërinjt të nacionalitetit serb kjo le të jetë mësim për ta. Vetëm atëherë – shteti me shtetin, sigurisht ka mundësi t'i kthejë. Por një e mirë do të jetë, që kush mu thirrë në emër të viktimave, mosni më, se po bëhet një cirkus i madh, me nga një javë ditë duke i mbajtur plakat, pleqtë e fëmijët e vegjël, se unë filan fisheku do t'ua gjejë. Ditën e mirë!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ismajl Kurteshi, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.

ISMAJL KURTESHI:

Ju falemnderit zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Unë në diskutimet e gjertanishme vërejta dy tendenca të cilat janë të papranueshme e që u thanë nga një numër i deputetëve.

Një tendencë është që krimi që është ushtruar mbi shqiptarët nga ana e Qeverisë Serbe, e cila mbështet mbi fakte, mbi varrezat masive, mbi të zhdukurit, mbi viktimat mundohet të barazohet me dhunën kinse të shqiptarëve e cila kryesisht mbështetet në insinuata, pasi që në Kosovë ende nuk ka asnjë varrezë masive, nuk ka patur asnjë burg privat që është zbuluar dhe nëse ka të tilla do të duhej që këtu të thuhet, por tendenca e barazisë është vërtetë e papranueshme.

Dhe, tendenca tjetër është tendenca e lirimit nga përgjegjësia e Qeverisë aktuale të Serbisë. Ne jemi të vetëdijshëm se për viktimat, për kidnapimet ka qenë përgjegjëse qeveria e Millosheviqit, mirëpo Qeveria aktuale e Serbisë është përgjegjëse për zvarritjen e identifikimit dhe kthimit të kufomave të zbuluara në varrezat masive në

Serbi e të cilat po mbahen me vite të tëra për përfitime të caktuara dhe e njëjta Qeveri, pra kjo aktualja, edhe tani po shkakton viktima. Vetëm para disa javësh, në Luginën e Preshevës, në kufirin në mes Kosovës dhe Serbisë ka vrarë 2 të rinj dhe po vazhdon me represione mbi shqiptarët e kësaj Lugine.

Dhe, një çështje krejt në fund, sot u kërkua përgjegjësia edhe nga Qeveria e Kosovës, e cila patjetër që duhet të jepë përgjegjësi për atë që është edhe kompetente. Për çështjen e sigurisë kompetent është UNMIK-u dhe është interesant se kur ne angazhohemi që Qeveria e Kosovës të ketë kompetenca, atëherë një pjesë e deputetëve e kundërshton këtë, kurse kur është fjala për përgjegjësi kërkohet nga ta kjo përgjegjësi. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ramadan Kelmendi dhe Hilmo bëru gati.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryetar, falemnderit sepse kam drejtë për çdo pikë të rendit të ditës ta marr fjalën.
E para, shtruarja dhe paraqitja sot e Raportit mbi të zhdukurit dhe të të rëmbyerit është një ndër çështjet më të ndieshme dhe më të rënda. Mendoj se nuk është arritur të thuhet e tërë ajo që ka bërë gjenocidi serb mbi shqiptarët.

E dyta, për para luftës për të gjithë të kidnapuarit duhet të bisedohet me Qeverinë e Beogradit sepse ajo i ka patur të gjtiha kompetencat dhe ingjerencat dhe ka ushtruar represion mbi shqiptarët. Pas luftës enklavat kanë qenë të ruajtura nga KFOR-i dhe s'ka patur shancë të merret askush dhe as të kidnapohet. Rastet konkrete: në Mitrovicë, përsëris, janë paraqitur 8.626 denoncime, në mesin e tyre, i theksoj vetëm ato më karakteristike:

1. Denoncimi mbi Millan Ivanoviqin, Petar Jakshiqin dhe Mllagjoviqin, punëtorë të spitalit dhe atje ka ndodhur krim;

2. Në Lagjen e Boshnjakëve, më 14 prill, nën udhëheqjen e Oliver Ivanoviqit, i cili tani është anëtar i Kryesisë së këtij Kuvendi; Xhavit Dervishoviqit, i cili vijon shkollën policore; Dushko – i ashtuquajturit Cakan që është inkoorporuar në administratën komunale të UNMIK-ut, në pjesën veriore, dhe djali... që jeton në Nish janë të implikuar në 16 vrasje dhe vjedhje je plaçkitje në Lagjën e Boshnjakëve, ndër ato edhe dy shtëpitë e mija dhe dy dhënduart e ekzekutuar në atë vend, e dijnë mirë.
3. Është rasti i Rrugës së Kovaçëve, 26 për të cilën Oliver Ivanoviqi ka të gjitha të dhënat dhe implikacionet në të; 5 djemë të familjes Halili dhe 4 të Ujkanëve në Vinarc, po ashtu të njëjtit persona dhe grupi i 22 të zhdukurve të intelektualve të Mitrovicës në Zubin-Potok.

Dhe, po e përfundoj. Kisha ortodokse e Sokolicës, është përgjegjëse, sepse nga ajo kanë kaluar militarët në fshatin tim të lindjes Kelmend dhe kanë ekzekutuar 5 bashkëfshatarë. Të gjitha këto i kemi paraqitur në denoncione dhe unë përkrah tërësisht Raportin që është i paraqitur nga ky Komision. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Hilmo Kandiq, le të bëhet gati Xhevdet Neziraj dhe Dragisha Kërstoviq, replikë.

HILMO KANDIĆ:

Gospodine predsedniče, poštovani kolege,

Bez sumnje da danas razgovaramo o jednom veoma važnom i da kažem sigurno najbitnijim pitanjem i problemom koji po meni ne da je trebalo nego je moralo doći daleko prije.
Hoću da kažem samo nekoliko riječi, ne bih ponavljao stvari koje su moji prethodnici kazali. Ali, prije svega hoću da uputim kritiku, gospodjo Brovina ne vama lično, nego sigurno Komisiji za nestala i kidnapovana lica, Radnoj grupi a prije svega članu ove Komisije, dakle koji predstavlja pollitičku radnu grupu ispred nesrpskih i nealbanskih političkih grupa ovde, koji sigurno po meni ni u jednoj riječi kazao i zato, zato sam izašao ovoga puta da kažem gde se ne pominje jednostavno naziv ili ime zajednice kojoj ja pripadam.
Vi sigurno ovdje znate da zajednica kojom ja pripadam je treća zajednica na Kosovu, zajednica isto koja je posle Albanskoga naroda i Srpskoga naroda, sigurno, kada je u pitanju ovo pitanje, najoštećenija zajednica a da se ovdje ne pominje i naziv, jednostavno ili ime moje zajednice, dakle kojoj ja pripadam a radi se o nemalom broju nestalih ili kidnapovanih Bošnjaka.

Kada sam pogledao ovaj dokumenat, razmišljao sam da li ću glaslati. Ja to iskreno govorim. Medjutim, od samog govora vašeg i svih diskutanata ovdje koje sam sigurno primjetio svojom iskrenošću ja za ovom govornicom hoću da kažem da ću ja podržati Izvještaj koji ste vi danas ovdje nama predočili. Medjutim, htio bih samo da napomenem da ne bi smijeli da dozvolimo sebi, da li je ovde greška štamparska uradjena ili namjerno, da kada se ovakvi izveštaji daju ili pak donose rezolucije da se ispuštu neke zajednice koje imaju veliki udio sigurno za ono danas ovde gdje mi sjedimo. Hvala vam najlepše.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Hilmo, ju falemnderit shumë. Xhevdet Neziraj, e besoj shumë shkurt edhe Dragisha, replikë.

XHEVDET NEZIRAJ:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar kolegë,

Do t'i përmbahem parimit që ju e thatë. Do të jam shumë i shkurtër dhe i falënderohem këtij Komisioni për një punë vërtetë shumë të ndieshme që ka bërë. Mirëpo, do të kisha cekur se ky Komision ndoshta është dashur shumë herët ta bëjë këtë punë dhe me këto të dhëna të paraqitet në Hagë ku edhe është duke u dënuar kryeprotagonisti i të gjitha këtyre gjërave të cilat kanë ndodhë në Kosovë. Është edhe një dëshmi tjetër, do të kisha me kërkuar që të kërkohet se në atë kohë ka ekzistuar hierarkia ushtarake dhe është ditur që këto forcat paramilitare dhe militare që nga gjenerali Pavkoviq edhe deri te ushtari i thjeshtë është ditur se kush i ka udhëhequr. Prandaj ai i di edhe viktimat ku janë. Popullata serbe nuk guxon të preket në këto çështje dhe të mendojë që këta akuzohen. Akuzohen ai sistem, ajo qeveri e cila ka bërë këto gjëra. Dhe, to të them se Qeveria e re e Serbisë, duhet të kërkojë një falje, sepse do të kishte me qenë një rrugë shumë më e lehtë e pajtimit në mes këtyre komuniteteve. Unë do ta marr një shembull, kur Vili Branti, kancelari gjerman edhe pse ka qenë kundër Hitlerit, ka kërkuar falje para të gjithë qytetarëve të botës për atë që ka bërë nazizmi gjerman. Prandaj, edhe po të kërkojë këtë populli serb e kishim patur shumë më lehtë... Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të falemnderit shumë. Dragisha Kërstoviq, i fundit.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Pa ja u stvari ne želim da dajem nikakvu repliku. Jednostavno hoću da konstatujem da je pitanje o kojem raspravljamo zaista ozbiljno. I pitanje ozbiljnosti tog pitanja uopšte ne postavljam. Ali mislim da su mnogi, i veliki broj poslanika, izašao iz teme o kojoj se priča i mislim da su predsedavajući imali obavezu da po pravilu 18. tačka 8. pod c) skrenu pažnju svakom poslaniku da ne pokreću pitanja koja nisu predmet rasprave i u buduće ja zaista molim da se o Poslovniku vodi računa i da se Poslovnik poštuje.

Posle svega, mislim da smo ipak dalje umesto da smo bliže. Hvala lepo!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë.

Unë do të doja para se të marrim një vendim, ta jap një konstatim përfundimtar. Debat numerikisht shumë i madh. Për çdo lavdratë. Asnjë diskutant nuk ka akuzuar një etni ose grup etnik dhe kjo nuk mund t'i ndajmbathet asnjë diskutuesi. Të gjithë jemi deputetë të Parlamentit të Kosovës dhe të gjithë do të vazhdojmë bashkërisht. Por, i kam thën sekretarit, prej soti, shënimi i pranisë së deputetëve në Parlament, të bëhet në fund të seancave plenare. Sepse, në tema k aq serioze, në debate k aq serioze, duhet të jemi këtu. Unë e kuptoj se mund të jemi me probleme shëndetësore, edhe me probleme tjera, por duhet të gjejmë momentin sepse e rrezikojmë punën e Parlamentit.

Duke përfunduar me këtë, falënderoj Komisionin që një kohë shumë të gjatë, shumë të gjatë është angazhuar, ka punuar, ka biseduar në Kosovë dhe jashtë Kosove, prandaj atë që e propozon Komisioni, si dokument valid, ju lutem ta votojmë.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.

Kush është kundër?

Numëroni mirë votat, ju lutem, sepse bëhen edhe numërimet tjera. Ju falemnderit shumë.
A ka që abstenojnë nga votimi? Asnjë abstenim.

Të konstatoj së pari se të pranishëm janë 62 deputetë. Do të thotë, ka kuorum dhe vendimi është i plotëfuqishëm.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....Të gjithë – Svi – All
Kundër – Protiv – Against..... 00
Abstenuan – Uzdržanih – Abastaned..... 00

Kalojmë në pikën e pestë – **Shqyrtimi i Propozimit për emërimin e disa anëtarëve të komisioneve parlamentare.**

Grupet parlamentare dijnë çka kanë propozuar, Kryesia i ka aprovuar.

Kush është për, me propozimet për zëvendësime? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një votë kundër.

A abstenon ndokush? Asnjë abstenim. Ju falemnderit.

Dhe pika e fundit e rendit të ditës – **Mendimi i Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë kushtetuese lidhur me mocionin e deputetit Arsim Bajrami.**

Unë mendoj se demokracia është në veprim. Shpejtësia është raketore dhe që kjo na japë optimizëm sepse të premtën është kërkuar, të martën është shqyrtuar dhe besoj se gjysma e Komisionit ka qenë e painformuar, megjithatë ju lutem, është bërë krejt në mënyrë demokratike dhe sipas rregullave të punës, prandaj më lejoni ta lexoj atë çfarë është përfundim i kësaj.

Mendimi nga ana e Komisionit legjislativ, është i papranueshëm sepse nga 6 anëtarë të pranishëm në Komision, për kanë votuar vetëm 3 dhe kjo nuk do asnjë koment, sipas Rregullës 37.3.

Prandaj, ju falemnderit për pjesëmarrje. Urdhëroni, doni replikë.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuari kryetar,

Ne po ndërtojmë demokracinë parlamentare. Pjesë e demokracisë që po ndërtojmë është edhe procedura demokratike. Unë ju përgëzoj sot për udhëheqje të mirë të mbledhjes dhe do të doja që kjo mënyrë e udhëheqjes të vazhdojë. Megjithatë, më lejonli, në pajtim me Rregulloren e punës, kam 10 minuta në dispozicion, si kryetar i Komisionit dhe më lejoni që ta vazhdoj fjalën. A mundem, zoti kryetar? Jo, jo, nuk do të mbaj ligjerata për shkak se nuk kam nevojë të mbaj ligjerata.

Natyrisht, ju e dini se Parlamenti është krijuar si një trup ku lejohet liria e fjalës, liria e debatit. Vetë parlamenti është i tillë. Në mbledhjen e kaluar, është futur një pikë e rendit të ditës – shqyrtimi i gjendjes së krijuar lidhur me zbatimin e Ligjit për arsimin e lartë. Është futur në procedurë të rregulltë. Është proceduar sipas kësaj. Unë jam paraqitur publikisht, e kjo ka qenë e regjistruar edhe para kamerave për ta marrë fjalën dhe për të diskutuar. Mua m'u ka mohuar kjo e drejtë.

Një e drejtë elementare. Më është mohuar për ta shprehur mendimin rreth kësaj fjale. Rregulla 18, në mënyrë shprehimore i garanton të drejtën çdo deputeti për ta shprehur fjalën dhe e ndalon për ta përdorur gjuhën parlamentare. Ju e dini se unë asnjëherë në

këtë foltore s'kam përdorur gjuhën parlamentare. Ju e dini se asnjëherë nuk kam dalur me qasje jokonstruktive. Ju e dini se asnjëherë nuk kam ra pre e qëndrimeve për të cilat s'kam qenë i bindur që janë të drejta.

Qëllimi i daljes sime në foltore ka qenë që në vend të asaj mënyre si përfundoi, propozoj instrumentin ligjor çfarë duhet ta ndjekë Parlamenti për ta deblokuar situatën me Ligjn për arsimin e lartë dhe me ligjet tjera të cilat padrejtësisht dhe arbitrarisht po mbahen të pezulluara nga Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm.

Unë kam dashur që ta propozoj pikërisht atë instrument ligjor që Parlamenti të deblokohet. Më vonë është krijuar përshtypja që dikush është për apo kundër këtij Ligji. Mos harroni, unë jam autor i atij ligji, bashkëautor i atij ligji. Kush është më shumë se unë, që ka punuar 6 muaj, më i interesuar që ai ligj të hypë në fuqi? Edhe ju e dini që unë dy herë kam ngrit këtu interpelancë dhe mocion – pse Përfaqësuesi Special nuk po nënshkruan ligjet. Por unë kam propozuar dhe këtu do ta përkrah gjithmonë kryetarin e Parlamentit që ta sfidojmë Përfaqësuesin Special në këto kompetenca mbretërore, por ky sfidim të bëhet si i ka hije Parlamentit, jo me deklarata politike, siç u veprua, por me instrumente ligjore dhe kam shprehur gatishmërinë që si kryetar i Komisionit për çështje legjislative dhe kushtetuese, t'i propozoj këtij Parlamenti amendamentet adekuate në Kornizën kushtetuese që ne të deblokojmë këtë situatë jo vetëm me Ligjin për arsimin e lartë por edhe për shumë ligje tjera të cilat po presin dhe të cilat janë blokuar padrejtësisht dhe me shumë ligje që mund të vijnë.
Për fat të keq nuk kam patur hapësirë për ta prezentuar këtë koncept institucional që duhet ta ndjekë Parlamenti i Kosovës, si organ ligjdhënës. Parlamenti nuk demonstron autoritetin e vet me deklarata që nënshkruhen nganjëherë edhe me dorë por demonstron autoritetin e vet duke proceduar me instrumente legjislative.

Ne me Kornizë kushtetuese kemi të drejtë, kemi të drejtë të nisim procedurën për ta ndërruar kornizën dhe për ta detyruar Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm që të deblokojë situatën me Ligjin për arsimin e lartë dhe me ligjet tjera, për shkak se edhe në monarkitë absolute, të cilat kanë përfunduar absolutisht, nuk ka asnkund të drejtë as mbreti ta mbajë ligjin pezull qysh mbahen ligjet e Kuvendit të Kosovës.
Fatkeqësisht, nuk m'u ka krijuar kjo hapësirë për ta shprehur këtë qëndrim institucional, në mënyrë arbitrare mua m'u ka marr e drejta për ta shprehur këtë mendim edhe si kryetar i Komisionit për çështje legjislative, edhe si prorektor i Universitetit për ta shprehur edhe qëndrimin e Universitetit, i cili është i interesuar që sa më shpejt ky Ligj të hyjë në fuqi dhe në mënyrë arbitrare është mbyllë debati, është mbyllë debati me një deklaratë politike, e cila, unë përsëri po e them, nuk e zgjidhë problemin. Problemi duhet të zgjidhet në mënyrë institucionale. Përfaqësuesi Special duhet të sfidohet në mënyrë institucionale me autoritetin e këtij Kuvendi. Dhe, unë apeloj që ne ta ruajmë autoritetin e Kuvendit, duke procedurë në mënyrë institucionale, për shkak se tani jemi edhe në një monitorim shumë të fuqishëm ndërkombëtar. Ne duhet, me veprimet tona, të mbrojmë konceptin institucional dhe shtetformues. Jo të mos kemi guxim t'i zgjidhim problemet dhe me deklarata siç është vepruar të shtyjmë vetëm problemin, jo ta zgjidhim.

Këtu ka shumë juristë në këtë sallë. Juristët të cilët rezonojnë drejtë dhe të cilët para qëndrimit partiak vëjnë profesionin, këtë fakt nuk ka nevojë as ta interpretojnë. Ky është një fakt notor që nuk kërkon interpretim. Kjo është shumë e qartë, është bërë shkelja e Rregullores, por në qoftë se ju doni, thuani që s'është bërë, unë nuk do të kundërshtoj, por ku po mbetet autoriteti ynë.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Profesor ju falemnderit. Sa mirë ju kam vlerësuar. Unë e kam ditur si prorektor i Universitetit, si profesor i të drejtës konstitucionale, si prorektor që keni ardhur 2-3 ditë përpara, në kërkesë të Universitetit, për të biseduar për atë çështje. E kam ditur që ju e mbështetni pastaj ke ardhur, prandaj kjo edhe më tepër më gëzon se edhe atë ditë keni qenë për atë vendim.

Dhe, në fund t'ju informoj se rendi i ditës, të cilin e kemi të propozuar për seancën e ardhshme është:

1. **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lëndën arkivore dhe arkivat;**
2. **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme në Kosovë.**

Dhe, ta përfundoj. Nuk do të thotë të nënçvlerësohen ata të cilët janë të paguar që t'i interpretojnë rregulloret dhe të japin mendimet e caktuara. Mund të ketë ndonjëherë lëshime të paqëllimshme. Po e them një çështje, renditja në debat bëhet mbi parimin e përfaqësimit politiko-partiak, do të thotë një herë grupet parlamentare, mbi parimin e etnive në Parlament, mbi parimin gjinor dhe brenda këtyre rregullave, ndonjëherë mund të jetë ndokush – para apo pas.

Ju falemnderit. Shihemi pas një jave.

Seanca përfundoi në orën 16,00.